

Tetor 2022
Numri: 175
E përmuajshme

Revistë edukative-kulturore - www.progresibotime.com

ETIKA

Shqipëri: 200 Lekë
Kosovë: 1.5 Euro
Maqedoni: 90 Den
Evropë: 7 Euro

FAMILJA DHE EDUKIMI



revistaetika



progresibotime

Fjala më e bukur është Libri i Allahut. Rruga më e mirë është sunneti profetik. Streha më e sigurt është devotshmëria. Të folurit më me virtyt është përmendja e Allahut.

Tregimet më të bukura gjenden në Kuran. Rrugët më të ndritura janë rrugët udhëzuese të profetëve.

Dija më e mirë dhe më e dobishme, është ajo që kthehet në kulturë. Justifikimi më i keq është ai që bëhet në momentin e vdekjes. Pendimi më i keq, është ai në ditën e kiametit. Pasuria më e mirë, është ajo e zemrës.



Besimtarët janë në trupa të ndryshëm, ata janë të detyruar ta konsiderojnë njëri-tjetrin si organet e një trupi që jetojnë me një zemër të vetme. Ashtu siç i gjithë trupi e ndjen dhimbjen e një organi, edhe perceptimi i vuajtjeve të vëllezërve të fesë, është një sprovë ndërgjegjeje për të gjithë besimtarët.

Allahu i Lartëmadhëruar i ka krijuar njerëzit nevojtarë ndaj njeri-tjetrit. Shoqëria, ashtu si ka klasën e pasur dhe të fortë, ka e do të ketë gjithmonë edhe klasën e të dobtëve, të njerëzve me probleme shëndetësore dhe të nevojtarëve. Ne duhet të pyesim veten: "Pse i krijoi Allahu i Lartëmadhëruar nevojtarët?" Përgjigjja dihet: "Nevojtarët janë amanet i Allahut (xh.sh.), që ua ka lënë jonevojtarëve." Këtë përgjegjësi e ka dhënë Vetë Allahu.



Ndryshe nga fetë e tjera, Islami i kushton rëndësi të madhe familjes. Ajo zbatimin e fesë në familje, jo në mënyrë individuale si beqar, e pranon si bazë. Megjithatë, në shumë fe si krishterimi dhe budizmi, devotshmëria e vërtetë përjetohet individualisht. Libri ynë i Shenjtë dhe Profeti (a.s.), na tregojnë se si duhet zbatuar feja në familje. Allahu i Plotfuqishëm urdhëron që shtëpitë tona të jenë si shkolla shpirtërore me ajetin e mëposhtëm: **“Urdhëroji njerëzit e tu të falin namazin dhe ji i vazhdueshëm edhe vetë në të. Ne nuk kërkojmë furnizim prej teje, Ne jemi ata që të furnizojmë ty.”** (Taha, 132)

Në dritën e këtij urdhri, çdo shtëpi myslimane është një shkollë, mësuesit e kësaj shkolle janë prindërit dhe tavolinat e tyre janë përqaftimet e tyre plot dashuri. Programi mësimor i shkollës sonë familjare është përcaktuar me ajetin e mësipërm: Të jesh rob i Allahut, të falësh namazin, të jesh i durueshëm në adhurime dhe të largohesh nga shqetësimi për furnizimin. Ajeti fisnik trajton psikologjinë e prindërve të sotëm dhe korrigjon keqkuptimet e tyre për furnizimin.

Si prindër, ndonjëherë shqetësohemi vetëm për edukimin material të fëmijëve tanë për shkak të shqetësimit të tepruar për rrëskun dhe në radhë të parë e vendosim suksesin e tyre në matematikë, fizikë dhe gjuhë të huaj. Mirëpo, Libri ynë i Madhërishtëm na urdhëron që anëtarëve të familjes dhe veçanërisht fëmijëve tanë t’u mësojmë Islamit, moralin e lartë dhe namazin. Meqenëse ajeti e vendos namazin në fillim të jetës së adhurimit, është e nevojshme të fillohet me namazin. Me një politikë të zgjuar, duhet t’i bëjmë fëmijët tanë ta duan namazin. Për shembull, mund të vendosim ushqime të tilla si akullore dhe ëmbëlsira si shpërblime nxitëse pas namazeve, në mënyrë që adhurimet të sjellin gjithmonë gjëra të mira në mendje.

Një gjë tjetër që duhet të bëjmë në këto ditë epidemie është t’u mësojmë fëmijëve tanë Librin e Shenjtë, Kuranin. Për fëmijët që dinë ta lexojnë, duhet bërë zakon të lexojnë çdo ditë një faqe të caktuar të Kuranit. Përveç kësaj, hadithet nga librat e hadithit mund të lexohen duke i përzgjedhur ato të përshtatshme për moshën e tyre dhe të gjitha këto duhet të bëhen në një atmosferë dashurie, jo me imponim. Imam Rabbani këshillon në lidhje me këtë: “Jini të mëshirshëm ndaj fëmijëve dhe inkurajojini ata të lexojnë Kuran.”

Tetor 2022

VITI: XVI

NUMRI: 175

BOTUESI

Shtëpia botuese "Progresi"

DREJTOR

Albert Halili

KRYEREDAKTOR

Alban Kali

PËRKTHYES

Albert Halili

Fatmir Sulaj

Ilir Hoxha

DIZAJN

Bledar Xama

ADRESA

Rr: Studenti; Sheshi "2 Prilli"

Shkodër; Shqipëri

MOBILE

+355 67 340 6182

E-MAIL

rev.etika@gmail.com

WEBSITE

www.progresibotime.com

KOSOVË

Rr: Ardian Zurnaxhiu; pn. Ralin

Prizren; Kosovë

Mob: +377 45 639 143

Prishtinë; Kosovë

Mob: +377 44 566 577

MAQEDONI

Drvarska 2B; Stara Carsija

Skopje; Makedonija

Mob: +389 7145 6003

ABONIMI VIETOR

Shqipëri: 2000 lekë

Kosovë: 15 Euro

Maqedoni: 900 Denar

Evropë: 80 Euro

Ju bëjmë të ditur

se materialet e sjella në redaksi pavarësisht nëse botohen apo jo nuk i kthehen autorit. Koha e botimit të një materiali përcaktohet nga redaksia. Honoraret e shkrimeve autoriale ose përkthimeve duhet të vini t'i tërhiqni pranë Shtëpisë Botuese "Progresi" ose pranë zyrave të përfaqësimit në Kosovë dhe Maqedoni.

Përmbajtja




8

Shtëpitë tona le të bëhen
vatra, faltore dhe shkolla
Dr. Adem Ergyl



Edukimi i familjes
Munir Arëkan

16



32



Imam Azami Ebu Hanife (r.a.)
Osman Nuri Topbash

5 Shkolla familjare për disiplinën
e përkushtimit ndaj Zotit

Mehmet Lutfi Arslan

10 Familja është një shkollë

Prof. dr. Sulejman Derin

12 Familja, bashkëpunimi në adhurim
Ahmet Hamdi Jëlldërëm

14 Edukimi i bazuar në urtësi

Ali Riza Temel

24 Mbulesa është kërkesa e besimit
M. Sami Ramazaollu

25 Këmbëngulja në mëkat
është luftë me Allahun

Osman Alltas

26 Feja dhe njeriu
në kohët moderne

Ahmet Tashgetiren



29

- Rruga dhe ideali ynë 29
Saxhid Türker
- Mënyra për të kaluar frikën dhe shqetësimet 30
A. Jasin Demirxhi
- Vështirësitë dhe shkaqet e tyre 43
Sadik Dana
- Puna më e mirë 44
Semih Jollaçan
- Kënaqësia kundrejt durimit në vuajtje 46
- Cilat firma duhet të zgjedhim 48
për veshjet tona?
Shefika K. Meriç
- Lumturia në familje 50
Zahide Topçu
- Këmisha prej zjarri 53
Fatma Allada

40

Mbajtja e amanetit
Ali Riza Temel



Fëmijë të sëmurë pas blerjeve
Psig. Tuba Sokmen

50

SHKOLLA FAMILJARE PËR DISIPLINËN E PËRKUSHTIMIT NDAJ ZOTIT

— Mehmet Lutfi Arslan —

Zoti ynë i ka krijuar të gjithë si një dhe të vetëm. Identiteti ynë është ndryshimi ynë, përgjegjësia jonë për të arritur të njëjtin horizont madhështie është partneriteti ynë. Adhurimi është horizonti i lartësimit që të gjithë jemi të detyruar ta arrijmë. Zoti (xh.xh.), na ka nderuar me prestigjin që t'i drejtohem Atij drejtpërdrejt. Ky nder në të njëjtën kohë është edhe përgjegjësia jonë më e madhe. Sekretet e të qenët individ është në ekuilibrin e artë të nderit dhe përgjegjesisë. Ai ekuilibër i artë arrihet duke mos harruar se ne do të jemi vetëm me Zotin tonë në fund siç ishte në fillim. Ashtu siç na krijoi në fillim si individë, Ai do të na marrë në llogari vetë kur të vijë koha: **“Me siguri, ju do të na vini një nga një, ashtu siç ju krijuam për herë të parë dhe do t'i lini pas ato që ua kemi dhënë (në dynja).”** (En'am, 94)

Sekretet e të qenët individ është privilegji dhe përgjegjësia më e madhe. Arsimit dhe edukimi nuk mund të kenë qëllim më të madh sesa të na bëjnë ta kuptojmë këtë. Të mësosh vlerën që na ka dhënë Zoti (xh.xh.) dhe më pas detyrën e përkushtimit ndaj Tij që e kërkon kjo vlerë, është shërbimi më i madh që duhet t'i bëhet njeriut. Nuk ka mirësi më të madhe se të njohësh veten dhe kështu të gjesh drejtimin në të cilin të kthehesh drejt së mirës. Ky është sekretet i tefridit (të qenët individ). Suksesi i një sistemi arsimor matet nga shkalla sesa mund ta bëjë të suksesshëm njeriun. Edukimi është një udhëtim përsosmërie drejt sekretit të krijimit. Gjëja e parë që pritet nga ky udhëtim është përkushtimi i trupit, mendjes dhe zemrës për të njëjtin qëllim të lartë, domethënë për përkushtimin dhe adhurimin ndaj Zotit (xh. xh.). Nuk po flasim për një objektiv të lehtë. Ecja drejt këtij qëllimi, që kërkon synim, përpjekje dhe mjedis, fillon që në momentin kur

njeriu hap sytë në këtë botë. Prandaj, familja është institucioni arsimor më me ndikim që ne të marrim trajnimin e përkushtimit ndaj Zotit. Shkolla më e rëndësishme ndër shkollat që ndjekim është familja. Aty hidhet themeli i rrënjës së shpirtit tonë dhe aty ngrihen fillimisht shtyllat e ndërtimit të vullnetit tonë.

Shkolla familjare është shkollë e natyrshme, sepse është themeluar mbi bazën e natyrshmërisë. Ky është një institucion edukimi që Zoti e ka dëshiruar për llojin njerëzor. Fakti që ai i cili martohet plotëson gjysmën e fesë së tij tregon se edhe familja është thelbësore për përsosjen e fesë. Familja fillon me vendimin e martesës së dy personave të lirë dhe bazohet në tri kontrata për përmbushjen e nderit të lartësimit për adhurimin ndaj Zotit. E para nga tri kontratat e ndryshme, e cila hyn në funksion me dy marrëveshje të nënshkruara reciprokisht, është misaku, e dyta është ahdi dhe e treta është akti. Misaku shpreh fjalën e dhënë ndaj Zotit, ahti shpreh fjalën që i japin njëri-tjetrit dy individët e lirë dhe akti shpreh fjalën e dhënë para drejtësisë dhe ligjeve. Prandaj, martesë është një kontratë “e rëndë”, siç thotë Kurani. Kjo është një tjetër pikë që e bën familjen një shkollë të natyrshme. Në familje ka të drejta dhe detyra dhe është çështje edukimi e trajnimi që secili ta rregullojë jetën sipas tyre.





Pika tjetër që e bën familjen një shkollë të natyrshe është atmosfera që shfaqet me tri mirësitë që u jepen dy individëve që martohen. Tri mirësitë janë prehja, dashuria dhe mëshira. Nga kjo atmosferë del cilësia e edukimit dhe formimit të familjes. Prehja është qetësia, besimi dhe siguria që rrjedhin nga plotësimi i nevojave materiale; dashuria është tërheqja midis dy individëve të huaj; mëshira, nga ana tjetër, është dhembshuria, toleranca dhe mirësia që duhen treguar në kohë të vështira. Dy individë që e kanë treguar vullnetin e tyre për të qenë bashkë edhe ndaj Zotit, edhe ndaj njëri-tjetrit, edhe ndaj të tjerëve, regjistrohen në një shkollë e cila ka Mëshirën e Mëshirëplotit, në të cilën do të mësojnë udhëtimin e tyre të adhurimit dhe përkushtimit ndaj Krijuesit.

Familja është një shkollë përkushtimi ndaj Zotit (xh.xh.). Fakti që ajo bazohet në dashuri, e bën atë mjetin më efektiv në formimin e vullnetit. Një bashkim i bazuar në dashuri është thelbësor, në mënyrë që një njeri të rritet, të piqet dhe të shndërron në një njeri të përsosur. I Dërguari i Allahut, paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të, rriti brezin më të nderuar dhe madhështor të njerëzimit me një bashkim kaq të përqendruar te dashuria. Ky bashkim e ka kthyer çdo moment të vëllazërisë së një xhemati, fytyrat e të cilit janë të orientuara drejt Zotit, në një udhëtim përsosmërie, i cili ua mundëson atyre t'i shtojnë mirësitë ndaj njëri-tjetrit dhe t'i plotësojnë të metat e tyre.

Përderisa të jetë një degë e edukimit profetik, familja është institucioni më i suksesshëm në edukimin e njerëzve sipas standardeve islame. Çdo moment i lumtur dhe i qetë atje mund të konsiderohet si një proces i natyrshtë edukimi. Nuk është e rëndësishme që të mos ketë një program trajnimi të

dukshëm, të mos respektohet një plan mësimor apo të mos përmendet emri i mësuesit ose studentit të tij. Çdo bisedë fetare, çdo çështje që diskutohet, çdo përvojë e përfutur, madje edhe heshtja e përbashkët në familjet e themeluara për Allahun dhe të bazuara në të drejta e dashuri, është një mjet edukimi që e përjetëson përkushtimin ndaj Zotit (xh.xh.). Mësimet e dhëna në shkollën familjare depërtojnë drejtpërdrejt në zemër dhe zhvillojnë personalitetin. Nuk ka rëndësi kush e jep mësimin, kush e merr atë, kush është mësuesi apo kush është studenti. E rëndësishme është të mos cenohet cilësia e familjes për të qenë një qendër edukimi e vazhdueshme duke ruajtur dashurinë dhe standardet.

Si shkollë adhurimi, sugjerimi i parë që duhet t'i bëhet familjes është vetëdija se jemi individë të përgjegjshëm para Zotit tonë. Kjo ndërgjegje kërkon prioritizimin e detyrës sonë në një mjedis ku secili kërkon të drejtat e tij. Nëse e kryejmë detyrën, mund të shpresojmë të marrim të drejtën tonë. Duke qenë se detyra kryesore është ndaj Zotit (xh.sh.), Ai është që do të na e japë të drejtën tonë. Ai i cili mendon se i është shkelur e drejta, duhet të kontrollojë nëse e ka lënë pas dore detyrën. Ai që mendon se nuk i ka shkelur të drejtat dhe rregullat, duhet ta dijë se është Zoti Ai që do ta shpërblejë për detyrën e tij. Ai që mendon se e drejta e tij dhe rregulli respektohen, le ta lavdërojë dhe falënderojë Zotin. Gjithashtu duhet t'i falënderojë edhe njerëzit. Falënderimi ndaj Zotit i shton mirësitë, kurse falënderimi ndaj njerëzve i afron zemrat.

Atmosfera e shkollës familjare, e cila natyralizon edukimin dhe formimin, është në fakt një atmosferë lirie. Liria është të çlirohesh nga robëria e çdo gjëje, veçanërisht e tekave dhe pasioneve, përveç robërisë ndaj Allahut. Liria është mirësia më e madhe që i është dhënë njeriut. Familja është vendi ku shijohet për herë të parë mirësia e lirisë. Ata që nuk e ka shijuar lirinë, nuk mund t'i edukojë të tjerët në lidhje me lirinë, sepse vetëdija e lirisë nuk mund të fitohet me një sugjerim didaktik. Vetëdija e lirisë është një kënaqësi shpirtërore që mund të shijohet vetëm me tevhid. Prandaj, është atmosfera e tevhidit ajo që ia jep familjes cilësinë e shkollës. Atmosfera e tevhidit është një atmosferë në të cilën të gjitha hyjnitë dhe vullnetet e tjera përveç Zotit konsiderohen të pavlefshme. Mëmësia, atësia, vëllazëria etj. të gjitha rolet janë nën hijen e nderit të robërisë ndaj Zotit (xh.xh.).

Edukuesi i vërtetë i shkollës familjare është Zoti (xh.xh.). Është Ai që ruan dashurinë dhe qetësinë

në familje, që i bën familjarët dritën e syve të njëri-tjetrit dhe që e siguron furnizimin e familjes: **“Urdhëro familjarët të falin namazin dhe ji i vendosur edhe vetë në këtë. Ne nuk duam furnizim prej teje. Në fakt, Ne të furnizojmë ty. E ardhmja e lumtur do t’u takojë atyre që përmbahen nga mëkatet.”** (Taha, 132) Ky urdhër i dhënë Pejgamberit, është gjithashtu një temë për të cilën shumica e profetëve janë shqetësuar për pasardhësit e tyre. Andaj kjo e bën namazin axhendën numër një të shkollës familjare. Detyra e parë e shkollës së familjes është namazi. Organizimi i jetës me axhendën e namazit është detyrë e anëtarëve të familjes. Edhe sugjerimi i të drejtës dhe durimit ndaj njëri-tjetrit është përgjegjësi e tyre.

Përderisa të ruhen kriteret e Kuranit dhe Sunetit, familja vazhdon të edukojë. Atmosfera e qetësisë, dashurisë dhe dhembshurisë së shkollës familjare e shndërron çdo punë të bërë së bashku në një kurs përsosmërie. Ky kurs, i cili edukon secilin sipas aftësisë së tij, bashkon familjen me lumturinë e paqen dhe individin me mundësitë për të zbuluar të vërtetën e tij. Mirë, por kur e humbet familja cilësinë e të qenët shkollë? Humbja e cilësisë së shkollës nga familja është në fakt humbje e origjinalitetit të saj. Të humbasësh origjinalitetin do të thotë të largohesh nga shpirti i bashkimit. Është vetëvrasje e familjes që të gjithë të mbeten vetëm dhe të kthehen në lumenj që rrjedhin në të njëjtin vend pa u përzier me njëri-tjetrin. Të mos jesh në gjendje të ulësh së bashku, të hash së bashku, të bisedosh, të qeshësh dhe të qash së bashku do të thotë fundi i përfuturit të ndërsjellë. Aty ku përfundon dobia është pika ku secili fillon të jetojë jetën e vet. Kjo do të thotë kthim i shpinës ndaj mëshirës, bekimeve dhe urtësisë së dhuruar për të qenë një familje.

Një tjetër shenjë e humbjes së cilësisë shkollë nga familja është largimi prej traditës profetike si mënyrë jetese. Sa më shumë që i Dërguari i Allahut (a.s.) të kujtohet, të flitet për të dhe të bëhet axhendë në raste të ndryshme në një shtëpi, aq më e dobishme është ajo familje. Një shtëpi në të cilën nuk përmendet i Dërguari i Allahut (a.s.), është një vend fatkeq. Aty mund të duket sikur ka lumturi, por vlera e saj është po aq sa kjo botë e përkohshme. Shtëpitë ku tradita profetike (suneti) kurorëzohet si një mënyrë jetese janë vende shembullore të lumturisë së përjetshme. Çdo sjellje atje, nga pirja e ujit te prerja e thonjve, nga ngrënia e ushqimit te mënyra se si buzëqeshet, bëhet me referencë te njeriu më i mirë (Pejgamberi). Kalendar i këtyre shtëpive të

Çdo familje që përpiqet të jetojë në përputhje me urdhrat dhe ndalesat e Allahut dhe të Dërguarit të Tij është një shkollë. Asnjë institucion arsimor nuk ka mundur të arrijë cilësinë e edukimit të bazuar në dashuri që jepet në këtë shkollë.



lumtura është kalendar i islam, gëzimet e tyre janë gëzimet e myslimanëve dhe hidhërimet e tyre janë hidhërimet e myslimanëve. Aty dridhen zemrat për fatin e umetit dhe kombit. Të jetosh për Allahun, të jesh i dobishëm dhe të njihesh si i tillë është një qëllim jetësor. Kurani është libri kryesor me synimin për t’u lexuar, kuptuar dhe jetuar. Kibla e shtëpisë është e gjallë; Namazi i falur me xhemat të paktën një herë në ditë është një tregues i këtij vitaliteti me ikametin dhe këndimin e Kuranit në namaz.

Çdo familje që përpiqet të jetojë në përputhje me urdhrat dhe ndalesat e Allahut dhe të Dërguarit të Tij është një shkollë. Asnjë institucion arsimor nuk ka mundur të arrijë cilësinë e edukimit të bazuar në dashuri që jepet në këtë shkollë. Prandaj, prezantimi i familjes si shkollë dhe ruajtja e saj si e tillë është ruajtja e cilësisë sonë njerëzore. Kur Nuhu, alejhi’s-salam, e humbi shpresën nga populli i tij dhe hapi duart për t’u lutur, përdori këtë shprehje: “Zoti im, tha Nuhu. Mos li të gjallë asnjë jobesimtar në tokë! Nëse i le, ata do t’i devijojnë robërit e Tu. Ata nuk rritin gjenerata të tjera, veçse mëkatore dhe mosmirënjohëse.» (Nuh, 26-27)

Nëse jobesimtarët nuk rritin dikë tjetër përveç brezave mëkatore dhe mosmirënjohëse, atëherë është punë e besimtarëve të edukojnë të devotshmit, të mirët dhe të sinqertët që do të trashëgojnë tokën. Familja është mundësia jonë më e madhe në këtë drejtim. Rruga për të përfituar maksimalisht nga institucioni i familjes, e cila është një shkollë e natyrshme në një atmosferë qetësie, vdekjeje dhe mëshire, do të bëhet e mundur duke shtuar të përbashkëtat me frymën e tevhidit dhe duke mos bërë lëshime nga stili i jetës profetike. Zoti (xh.xh), na dhëntë suksese!

SHTËPITË TONA LE TË BËHEN VATRA, FALTORE DHE SHKOLLA



— Dr. Adem Ergyl —

Të gjitha qeniet e gjalla janë krijuar për të ndërë nevojën e një vatre. Ajo vatër është, në një farë mënyre, djepi i ekzistencës së tyre, një qendër edukatore ku ato rriten dhe përgatiten për jetën, streha e tyre, vendi ku shfaqen brezat e tyre dhe së fundi, vendi i paqes dhe qetësisë. Kur bëhet fjalë për qeniet njerëzore, vatra e tyre përveç këtyre funksioneve mbart edhe tiparet e një faltoreje dhe një shkolle. Në këtë artikull, do të përqendrohemi në faktin se shtëpitë tona janë veçanërisht faltore dhe shkolla. Sepse në ditët e sotme në këto funksione të vatrave tona duket se kanë ndodhur konsumime, lëshime dhe humbje. Akoma më keq, shtëpia/familja është zhvendosur në rrugë ose është zhvendosur rruga në shtëpi. Atraktiviteti i rrugës dhe mbështjellja e shumëanshme e teknologjive të komunikimit duke krijuar një botë virtuale, shkatërruan qetësinë në familje dhe si rrjedhojë, shtëpitë tona kanë pushuar së qenëri banesa në të cilat arrihet paqja, ndjehet kënaqësia e adhurimit dhe mësohen dituria, urtësia e mirësjellja.

Nëse procesi i pandemisë mund të jetë i dobishëm për kthimin në shtëpi dhe zbulimin e vatrave tona, do të thotë se do të kemi arritur një manifestim të bukurisë, me fjalë të tjera, një mirësi brenda kohës së fatkeqësisë. Prandaj, do të konsiderohet si një nga të mirat më të rëndësishme për veten dhe shoqërinë tonë që të synojmë dhe të përpiqemi që këtë periudhë në të cilën jetojmë ta kthejmë në një mundësi, në mënyrë që shtëpitë tona të kthehen sërish në vendbanime, faltore dhe shkolla. Nëse shtëpia është shkatërruar, kjo do të thotë se familja është prishur dhe të gjitha llojet e herezive janë bërë të lehta për t'u kryer. Në këtë aspekt, hapi i parë për të shpëtuar brezat duhet të jetë marrëdhëniet e shëndetshme me shtëpinë.

Thuhet se njeriu është fëmija i mjedisit të tij. Në planin e tij material, mjedisi i tij më i afërt është familja e tij dhe në fund shtëpia e tij. Siç shprehet Elmallëllë Muhamed Hamdi Jazëri: “Jetën e përshtatja me mjedisin. Atëherë, jeta më e lartë nënkupton përshtatjen me mjedisin më të lartë.” Nisur nga ky fakt mund të thuhet se atmosfera e mjedisit familjar ka një rëndësi jashtëzakonisht aktive në formimin, lartësimin apo dobësimin e personalitetit tonë.

Në rindërtimin e shtëpive, themelet e të cilave janë lëkundur, para së gjithash, është e nevojshme të vendosemi për t'u bërë një bashkësi familjare myslimane që i dorëzohet vetëm Allahut, duke iu drejtuar Zotit me një zemër plot lutje e përgjërëm si Ibrahim dhe Ismail, alejhime's-selam.¹ Sepse, siç ka thënë edhe Ibn Ataullah el-Iskenderi: «Kushdo që niset për rrugë me Zotin, nuk mbetet në rrugë dhe as nuk i ndërpritet puna. Vetëm puna e atyre që nisen për rrugë duke u mbështetur te vetja do të jetë e vështirë dhe e rrëshqitshme. Së fundi, shenja e suksesit është t'i drejtohesh Zotit në fillim.»

Shndërrimi i shtëpive në faltore dhe shkolla është drejtpërdrejt proporcional me shkallën e devotshmërisë së bashkëshortëve, sepse nderi i vendit është po aq sa nderi i atyre që banojnë aty. Atëherë, harmonia e bashkëshortëve, niveli i pjekurisë së tyre dhe vizionet për të ardhmen janë të rëndësishme për krijimin dhe vazhdimin e familjes. Nuk ka kufi të sipërm për zhvillimin dhe edukimin. Bashkëshortët duhet të besojnë në rëndësinë e zhvillimit një hap më tej çdo ditë. Qëllimi i përmirësimit të vazhdueshëm të diturisë, urtësisë, shkathtësisë, mirësjelljes dhe moralit do të rrisë vazhdimisht cilësinë e shkollës familjare

1. Shik. Bekare, 127-128.

dhe secili do të ndihet rehat në një vatër të tillë. Prandaj, do të jetë e nevojshme të merret në konsideratë ushqyerja e vazhdueshme e prindërve në këtë aspekt, të cilët janë shtylla kurrizore e atmosferës së shtëpisë. Krijimi i “Qendrave/Akademive të Zhvillimit të Familjes” krahas shërbimeve ekzistuese të shumë fondacioneve dhe shoqatave në vendin tonë do të jetë një shërbim jashtëzakonisht jetik për brezat tonë dhe për të ardhmen tonë. Prindërit do të mund t’i kapërcejnë mangësitë e tyre në dituri, njohuri, aftësi dhe komunikim në këto qendra. Këto qendra në të njëjtën kohë do të jenë në gjendje të udhëheqin edhe krijimin e familjes dhe të ofrojnë konsulencë orientuese në zgjidhjen e problemeve. Familjet e vogla, të cilat kanë zëvendësuar familjet e mëdha, do të mund të ruajnë ekzistencën e tyre në mënyrë të shëndetshme vetëm me mbështetje të tilla. Përndryshe, divorcet do të shtohen, familjet do të prishen dhe brezat e pambrojtur do të jenë viktima të lëvizjeve perverse.

Mësimi më i rëndësishëm i shkollës sonë duhet të jetë padyshim edhe përfaqësimi dhe trajnimi i misionit tonë të krijimit “për të qenë rob i mirë i Allahut”. Në këtë aspekt, shtëpitë tona janë një faltore. Këto faltore duhet të rregullohen si vende të pastra, themelet e të cilave janë hedhur mbi devotshmëri. Sepse, siç shprehet një evlia i Allahut, «një jetë familjare në prehje është gjithashtu një formë adhurimi». Nëse në këto shtëpi i kushtohet vëmendje hallallit dhe haramit, emri i Allahut përmendet shumë, fjalët e Tij lexohen dhe dëgjohen ditë e natë, dhe disa qoshe të tyre janë shndërruar në vend sexhdeje, sigurisht që këto shtëpi do të konsiderohen faltore. Përsëri, nëse këtu shfaqen dashuria për Allahun, manifestimet e mëshirës dhe respektit të ndërsjellë dhe sjelljet e mira, atëherë virtytet e tilla janë padyshim një parajsë paqeje ku zbret mëshira dhe qetësia hyjnore. Nuk ka vend

tjetër që mund të zëvendësohet për një vend të tillë trajnimi. Siç shprehet një mendimtar: «Detyra jonë është të krijojmë një atmosferë të bukur në të cilën njerëzit mund të edukohen.»

Një mësim tjetër i rëndësishëm i shkollimit në shtëpi janë edhe “mësimet e jetës”, që të moshuarit i quajnë “adab muasheret”, të cilat duhet të fitohen brenda rrjetit të marrëdhënieve. Njerëzit shpesh mësojnë duke imituar. Familja është një vatër e rëndësishme ku transferohen traditat dhe zakonet. Fatkeqësisht, nuk mund të themi se shkollat tona e plotësojnë totalisht këtë nevojë. Tashmë janë të dukshme shenjat e një brezi që nuk e njeh apo kujdeset fare për mjeshtërinë, mirësjelljen, hirin e delikatesën dhe që vrazhdësinë dhe rrëmujën e ngatërron me lirinë dhe origjinalitetin. Si anëtarë të një feje që urdhëron marrjen e lejes në kohë të caktuara në shtëpi, edhe kur kalojmë mes dhomave, ne kemi përgjegjësinë të mbajmë mend dhe të zbatojmë «listën e rregullave të shkollës në shtëpi».

Shkollimi në shtëpi duhet të jetë gjithashtu në gjendje të shërbejë si një seminar për ndërtimin e aftësive. Faji i brezave që nuk riparojnë as një rubinet të vogël, nuk dinë të ndërrojnë një prizë dhe nuk kanë përvojë se çfarë dhe ku të blejnë pavarësisht moshës së shtyrë, u takon prindërve, mësuesve të shkollës së shtëpisë. Rritja e brezit do të bëhet e mundur jo vetëm duke i shërbyer, por edhe duke i mësuar me shërbimin dhe duke i përfshirë në shërbim. Vendi i edukimit për këtë janë shpesh shkollat tona të shtëpisë.

Shkolla në shtëpi duhet të jetë institucioni më i rëndësishëm mbështetës i suksesit akademik të fëmijëve tanë. Për këtë arsye, krijimi i ambienteve të shëndetshme të studimit në shtëpi, përdorimi i kohë pas kohe i këshillimeve jashtë shkollës dhe orientimi i natyrshëm në pikën e krijimit të rrethit të duhur të miqve janë hapa të rëndësishëm që duhen ndërmarrë për suksesin e brezit tonë.

Sërish, shkolla e shtëpisë duhet të ketë edhe veçorinë e një spitali ku të trajtohen sa më shumë lëndimet mendore dhe emocionale të marra nga jashtë. Detyra për të mbrojtur emocionet dhe për të qetësuar mendjet që turbullohen është shpesh përgjegjësi e prindërve. Prindërit, të cilët janë mësues dhe drejtues të shkollave shtëpiake, kanë për detyrë të marrin seriozisht ndihmën e nevojshme të huaj, edhe nëse nuk mund t’i kryejnë vetë këto funksione. Takimi me mjekët përkatës për shërimin e sëmundjeve shpirtërore është ndër përgjegjësitë e domosdoshme të shkollimit në shtëpi, po aq sa, e ndoshta edhe më shumë se sa rendim për trajtimin e sëmundjeve fizike.

Takimi me mjekët përkatës për shërimin e sëmundjeve shpirtërore është ndër përgjegjësitë e domosdoshme të shkollimit në shtëpi, po aq sa, e ndoshta edhe më shumë se sa rendim për trajtimin e sëmundjeve fizike.



FAMILJA ËSHTË NJË SHKOLLË

— Prof. dr. Sulejman Derin —



Ndryshe nga fetë e tjera, Islami i kushton rëndësi të madhe familjes. Ajo zbatimin e fesë në familje, jo në mënyrë individuale si beqar, e pranon si bazë. Megjithatë, në shumë fe si krishterimi dhe budizmi, devotshmëria e vërtetë përjetohet individualisht. Libri ynë i Shenjtë dhe Profeti (a.s.), na tregojnë se si duhet zbatuar feja në familje. Allahu i Plotfuqishëm urdhëron që shtëpitë tona të jenë si shkolla shpirtërore me ajetin e mëposhtëm: **“Urdhëroji njerëzit e tu të falin namazin dhe ji i vazhdueshëm edhe vetë në të. Ne nuk kërkojmë furnizim prej teje, Ne jemi ata që të furnizojmë ty.”** (Taha, 132)

Në dritën e këtij urdhri, çdo shtëpi myslimane është një shkollë, mësuesit e kësaj shkolle janë prindërit dhe tavolinat e tyre janë përfaqimet e tyre plot dashuri. Programi mësimor i shkollës sonë familjare është përcaktuar me ajetin e mësipërm: Të jesh rob i Allahut, të falësh namazin, të jesh i durueshëm në adhurime dhe të largohesh nga shqetësimi për furnizimin. Ajeti fisnik trajton psikologjinë e prindërve të sotëm dhe korrigjon keqkuptimet e tyre për furnizimin.

Si prindër, ndonjëherë shqetësohemi vetëm për edukimin material të fëmijëve tanë për shkak të shqetësimit të tepruar për rrëskun dhe në radhë të parë e vendosim suksesin e tyre në matematikë, fizikë dhe gjuhë të huaj. Mirëpo, Libri ynë i Madhërishtëm na urdhëron që anëtarëve të familjes dhe veçanërisht fëmijëve tanë t’u mësojmë Islamin, moralin e lartë dhe namazin. Meqenëse ajeti e vendos namazin në fillim të jetës së adhurimit, është e nevojshme të fillohet me namazin. Me një politikë të zgjuar, duhet t’i bëjmë fëmijët tanë ta duan namazin. Për shembull, mund të vendosim ushqime të tilla si akullore dhe ëmbëlsira si shpërblime nxitëse pas namazeve, në mënyrë që adhurimet të sjellin gjithmonë gjëra të mira në mendje.

Një gjë tjetër që duhet të bëjmë në këto ditë epidemie është t’u mësojmë fëmijëve tanë Librin e Shenjtë, Kuranin. Për fëmijët që dinë ta lexojnë, duhet bërë zakon të lexojnë çdo ditë një faqe të caktuar të Kuranit. Përveç kësaj, hadithet nga librat e hadithit mund të lexohen duke i përzgjedhur ato të përshtatshme për moshën e tyre dhe të gjitha këto duhet të bëhen në një atmosferë dashurie, jo me imponim. Imam Rabbani këshillon në lidhje me këtë: “Jini të mëshirshëm ndaj fëmijëve dhe inkurajojini ata të lexojnë Kuran.” (Mektubat, vëll. 3, Letra e 3-të.)

Periodat epidemike kanë një rëndësi të veçantë për sa i përket infakut (dhënies për hir të Zotit), sepse në perioda të tilla, njerëzit shpesh bëhen më egoistë dhe duan t’i shpenzojnë burimet e tyre vetëm për veten dhe familjet e tyre. Megjithatë, shumë nga vëllezërit dhe motrat tona kalojnë perioda të vështira gjatë fatkeqësive dhe kanë nevojë për më shumë ndihmë. Shumë njerëz humbasin punën dhe nuk janë në gjendje të çojnë bukë në shtëpi. Për këtë arsye, ne duhet ta mësojmë familjen tonë të bëjë infak e të bëjë sakrificë dhe t’i bëjmë fëmijët tanë pjesë në dhurimet tona dhe të ndajmë me ta gëzimin e infakut.

Natyrisht, për t’u zbatuar programi që kemi paraqitur më sipër, para së gjithash është e nevojshme që prindërit të rishikojnë statusin e tyre arsimor dhe të përpiqen t’i plotësojnë mangësitë e tyre. Për këtë arsye, ditët e karantinës janë një mundësi edhe për edukimin tonë fetar. Sepse modeli më efektiv i edukimit është ai në të cilin prindërit japin një shembull të gjallë për fëmijët e tyre.

Disa prej nesh mendojnë se perceptimet e fëmijëve janë të dobëta dhe ndoshta ata mund të hyjnë në përshtetshmëri në moshat e mëvon-

Disa familje marrin rrugën e lehtë dhe i lënë fëmijët e tyre në vorbullat e dëmshme të internetit në vend që të merren me edukimin e tyre. Me keqardhje vërejmë se abonimet në kanalet televizive me bazë argëtimi janë rritur shumë herë për të mbushur kohën e lirë që u shfaq gjatë periudhës së epidemisë.



shme, gjë që nuk është e vërtetë sipas sufive. Përkundrazi, natyra e tyre e pastër është shumë e përshtatshme për të pranuar Zotin dhe të vërtetën, mjafton që ne të dimë sesi të hyjmë në zemrat e tyre të pastra. Në këtë aspekt, shprehjet si: “Ende është fëmijë, le ta jetojë rininë e tij.”, që janë të përhapura në popullin tonë, janë jashtëzakonisht të gabuara. Imam Rabbani e shpjegon kështu kapacitetin shpirtëror të të rinjve, madje edhe të fëmijëve:

“Për sa i përket çështjes së takimit me Zotin, të rinjtë dhe të moshuarit janë të barabartë. Edhe të vdekurit duan ta marrin pjesë nga kjo mirësi.” (Vëll 1, letra e 200-të.)

Në fakt, sukcesi i fëmijëve në këtë drejtim përshkruhet shpesh në veprat tona mistike. Imam Gazaliu e përshkruan edukimin e Sehl b. Abdullah Tusterit në fëmijëri nga daja i tij në rrugën e spiritualitetit si më poshtë:

Sehl ibn Abdullahu thotë: Isha vetëm tre vjeç dhe ngrihesha natën. Shikoja namazin e natës që e falte daja im, Muhamed ibn Suvari. Një ditë më pyeti: «A nuk dëshiron t’i bësh dhikër Allahut që të krijoi?» Unë iu përgjigja: «Si mund t’i bëj dhikër?» Nisur nga kjo më tha:

«Sa herë që të shkosh në shtrat thuaj tri herë me zemër pa e lëvizur gjuhën: “Allahu është me mua, Allahu më sheh, Allahu e di gjithçka që bëj.” Këto thuaji me zemër.” Unë i thashë këto për disa net dhe e lajmërova atë që po i vazhdoja. Këtë herë më këshilloi t’i them njëzet e një herë. Edhe unë i thashë njëzet e një herë dhe kënaqësinë e këtyre fjalëve e ndjeva në zemër. Kur e pashë dajën tim një vit më vonë, ai më tha:

“Bir, vazhdoji ato që t’i kam mësuar deri sa të vdesësh. Sepse ato do të të bëjnë dobi në këtë botë dhe në ahiret.» Edhe unë vazhdova t’i thosha këto fjalë për vite me radhë dhe e arrita kënaqësinë e tyre. Përsëri një ditë tjetër daja më tha:

- «O Sehl, kushdo që beson se Allahu është me të, se ai e sheh atë dhe se di gjithçka që ai bën, a mund të bëjë ky njeri keq dhe të rebelohet kundër Krijuesit të tij? Pa të të shohim! Mos iu afro mëkatit dhe mos u rebelo kundër Zotit!” (Ihja, Botimet Erkam, vëll. 5, fq. 255.) Si rezultat i këtij edukimi, Sehl ibn Abdullahu u bë një yll i madh i botës sonë shpirtërore.

Disa familje marrin rrugën e lehtë dhe i lënë fëmijët e tyre në vorbullat e dëmshme të internetit në vend që të merren me edukimin e tyre. Me keqardhje vërejmë se abonimet në kanalet televizive me bazë argëtimi janë rritur shumë herë për të mbushur kohën e lirë që u shfaq gjatë periudhës së epidemisë. Dëmi kryesor i filmave-serialeve dhe lojërave në internet, dëm i cili nuk vihej re kur ishin fëmijë, shfaqet kur ata bëhen adoleshentë. Por ja që tashmë është tepër vonë, mendjet e freskëta të fëmijëve janë formatuar nga duart e liga të së keqes. Zoti na e bëftë të lehtë punën dhe mundimin derisa ta sjellim anijen tonë familjare në portin e xhenetit dhe ajeti vijues na mbajttë gjithmonë të zgjuar: **“O ju që keni besuar! Ruani veten dhe familjet tuaja nga zjarri, lënda djegëse e të cilit janë njerëzit dhe gurët. Atë e mbikëqyrin engjëjt të fuqishëm e të ashpër, të cilët kurrë nuk i kundërshtojnë urdhrat e Allahut, por i zbatojnë menjëherë ato.”** (Tahrim, 6)

FAMILJA

BASHKËPUNIMI NË ADHURIM

— Ahmet Hamdi Jëlldërëm —

ASHTU SIÇ JEMI TË DETYRUAR T'I DREJTOHEMI ALLAHUT SI INDIVIDË, DUHET T'I DREJTOHEMI ATIJ EDHE SI FAMILJE. QËLLIMI I TË QENËT FAMILJE ËSHTË KRIJIMI I NJË PARTNERITETI NË TË CILIN MUND TË BASHKËPUNOJMË NË ADHURIMIN E ALLAHUT (XH.XH.). PRANDAJ, SHIHET SE NJË FAMILJE E THEMELUAR NË BESIM ËSHTË NËN MBROJTJE NGA ÇDO ASPEKT.

“Është Ai që ju krijoi nga një njeri i vetëm (Adem-it), prej të cilit krijoi edhe bashkëshorten e tij (Havanë), që të gjente qetësi tek ajo. Kur njeriu bashkohet me gruan e vet, e ngarkon atë me një barrë të lehtë, që ajo e kalon pa e ndier për ca kohë. Dhe, kur ajo rëndohet, ata të dy i luten Allahut, Zotit të tyre: “Nëse na dhuron pasardhës të shëndoshë, do të të jemi vërtet mirënjohës!” (A'raf, 189)

Allahu i Madhëruar e krijoi Ademin (a.s.). Pas kësaj, Ai krijoi bashkëshorten e tij, në mënyrë që ai të gjente prehje. Kështu, u krijua familja e parë në tokë, e përbërë nga babai ynë, Ademi dhe bashkëshortja e tij, nëna jonë, Havaja. Në ajetin fisnik, urtësia e krijimit të Havasë shprehet si gjetja e prehjes nga Ademi. Gjaku i të riut që vlon qetësohet nga martesa. Prehje do të thotë paqe dhe stabilitet, siguri dhe vatër.

Ndërsa Kurani Fisnik e lavdëron gruan, deklaron se ajo është një vatër për t'u strehuar. Nisur nga ky aspekt, gruaja është një port i qetë ku burri i

cili ikën nga dallgët e errëta të oqeanëve të tërbuara mund të ndihet i sigurt. Edhe pse një burrë mund të zotërojë qindra shtëpi, këto shtëpi nuk e kanë veçorinë e të qenët vatër nëse nuk kanë një grua në to. Sepse gruaja fut në dhomë me dhjetëra energji emocionale që janë si qendra energjie. Ndër to mund të përmendim: Mëshirën, dhembshurinë, dashurinë, besimin, etj. Këto janë burim i shumë emocioneve.

Ndërsa burri siguron banesën e nevojshme për banim familjar, gruaja padyshim përfaqëson qetësinë e asaj banese. Nisur nga ky aspekt, dy përbërësit e familjes janë; elementi material dhe ai shpirtëror të cilët formohen nëpërmjet burrit dhe gruas. Ndërsa burri është fytyra e dukshme e familjes dhe shtylla mbajtëse e saj, gruaja është shpirti dhe energjia e shtëpisë.

Ndërsa burrat e umetit kanë rendur nëpër kontinente me shekuj për të përhapur Islamit në botë, e vetmja arsye pse familja ka mbijetuar është shpirti dhe energjia e shtëpisë. Sipas shprehjeve të Mevlanës, nëse njëra nga dy këmbët qëndron brenda rrethit të sheriatit, nuk është problem që këmba tjetër të udhëtojë nëpër të gjitha botët. Andaj, përderisa shpirti dhe energjia e familjes janë të qëndrueshme në shtëpi, nuk ka ndonjë problem që pala tjetër të jetë e preokupuar në botën materiale.

Problemi më themelor që përjetojmë sot është se shtëpitë tona i kanë humbur shpirtin dhe energjinë e tyre. Me fjalë të tjera, është tjetërsimi i gruas ndaj shtëpisë së saj duke u përpjekur të krijojë një hapësirë për veten jashtë shtëpisë. Si e tillë, familja, e cila me energjinë e saj e siguronte motivimin e vet, është larguar dhe vendin e saj e kanë zënë hallet.



Partneriteti brenda familjes ka marrë fund dhe ka lindur rivaliteti shkatërrues. Vjedhja reciproke e roleve përfundimisht i ka mbytur të dyja palët në një vorbull.

PO NËSE NUK E GJEJ ATË QË PRES NË MARTESË!

Një nga gabimet më të mëdha është të ndërtohet një martesë mbi pritshmëritë. Njeriu që vendos pritshmëri është dikush që ia ka lënë iniciativën dikujt tjetër dhe është shndërruar në një element joefektiv. Ndërkohë, martesat janë mision, një ideal. Kurani Fisnik i përmbledh qëllimet e martesës me tri pikat e mëposhtme:

“Dhe një prej shenjave të Tij është që prej jush krijoi për ju bashkëshortet tuaja, që të qetësoheni pranë tyre, duke vënë ndërmjet jush dashuri dhe mëshirë. Me të vërtetë, në këtë ka shenja, për njerëzit që mendojnë.”

(Rum, 21)

- a) Qetësia,
- b) Dashuria,
- c) Mëshira.

Martesa është një port ku bashkëshortët do të gjejnë paqen dhe stabilitetin tek njëri-tjetri. Ky port është një vend ku mbaron lëvizja dhe mbizotëron qetësia e prehja.

Nëse ka harmoni dhe përputhshmëri mes bashkëshortëve në të gjitha aspektet, do të thotë se është dhuruar një jetë në atmosferë dashurie.

Mëshira është thelbësore në problemet që mund të lindin në martesë. Me fjalë të tjera, palët duhet të tregojnë mëshirë për njëra-tjetrën dhe të jenë ilaç për njëra-tjetrën. Këto probleme mund të jenë financiare dhe shpirtërore. Mënyra për t'i kapërcyer problemet që mund të ndodhin me kalimin e kohës është aplikimi i motos së mëshirës. Bashkëshortët janë të detyruar ta mëshirojnë njëri-tjetrin për hir të Allahut edhe në situatat më të pafavorshme. Që nga momenti kur e kanë shteruar hatrin për njëri-tjetrin, ata i përmbushin obligimet ndaj njëri-tjetrit për hatër të Allahut.

Ashtu siç jemi të detyruar t'i drejtohem Allahut si individë, duhet t'i drejtohem Atij edhe si familje. Qëllimi i të qenët familje është krijimi i një partneriteti në të cilin mund të bashkëpunojmë në

adhurimin e Allahut (xh.xh.). Prandaj, shihet se një familje e themeluar në besim është nën mbrojtje nga çdo aspekt.

Krahas të gjitha këtyre mirësive, sot kur vjen puna te martesat/familja, të vijnë në mendje një mijë e një halle. Martesat po bëhen gjithnjë e më të vështira dhe gjithnjë e më shumë po perceptohen si të pamundura. Ndërkohë, Pejgamberi ka thënë: **“Martesa më e mirë është ajo më e lehtë.”** (Ebu Davud, Nikah, 32.)

Ky hadith profetik, siç mund të kuptohet si thjeshtim i kostove të martesës në vetvete, mund të kuptohet edhe si proces i lehtë për divorcet që do t'ua hapin rrugën martesave të reja. Përndryshe, martesat mund të shtyhen për shkak të shqetësimeve të tilla, ose palët mund të durojnë me sforco njëra-tjetrën, duke rezultuar në ngjarje të padëshirueshme.

Edhe pse divorci është një ngjarje që e zemëron Allahun aq sa e dridh Arshin e Tij, është një rrugëdalje nëse martesat bëhen e padurueshme. Por kjo nuk do të thotë të ikësh nga martesat. Për fat të keq, po shihet se vëllezërit dhe motrat tona, të cilët kanë përjetuar disa kujtime të këqija në shoqërinë tonë sot, ikin nga martesat. Ky është një qëndrim jashtëzakonisht i gabuar.

Martesa është thelbësore në shoqërinë islame. Martesa e secilit që ka mbushur moshën e martesës është suneti i të Dërguarit të Allahut (a.s.). Nuk është qëndrim i myslimanëve shmangia e këtij suneti. Prandaj, çdo mysliman/e, bashkëshorti/ja e të cilit ka vdekur ose është divorcuar, duhet të jetë në kërkim dhe të jetë i/e hapur ndaj ofertave. Megjithatë, një grua që ka fëmijë jetimë dhe ka frikë nga presioni i njerikut të tyre (bashkëshortit tjetër të saj), ka leje të qëndrojë larg martesës derisa të rrisë fëmijët e saj.

Nuk duhet harruar se me martesë njeriu ka garantuar gjysmën e fesë së tij. Në hadithet për gjysmën tjetër, rekomandohet të «jemi të devotshëm ndaj Allahut». Kjo tregon se të qenët beqar, domethënë të jesh i pamartuar për çfarëdo arsye, do të thotë të jesh plotësisht i pambrojtur/i vetëm ndaj rreziqeve demonike.



EDUKIMI I BAZUAR NË URTËSI



— Ali Riza Temel —

Dihet se njeriu përbëhet nga shpirti dhe trupi. Programet e edukimit dhe trajnimit të zbatuara pa marrë parasysh këto dy aspekte të qenieve njerëzore nuk mund të krijojnë llojin e dëshiruar dhe të nevojshëm njerëzor. Të trajtosh një njeri vetëm ekonomikisht, vetëm teknikisht dhe vetëm në aspekte mistike do të thotë të prishësh integritetin e tij. Nëse nuk merren parasysh së bashku karakteristikat materiale dhe shpirtërore që përbëjnë qenien njerëzore, nuk mund të edukohen qenie njerëzore ideale dhe shembullore.

Gjendja e të rinjve tanë të rritur nga sistemi ynë arsimor bazuar në modelet perëndimore është e dukshme. Brezat që rriten të pavetëdijshëm për identitetin e tyre, besimin, vlerat historike, burimet e dashurisë dhe emocioneve përbëjnë një problem si për veten e tyre ashtu edhe për kombin tonë, pasi janë të privuar nga integriteti i personalitetit.

Përgjithësisht dy janë elementet që mbizotërojnë te njeriu, njëri është mendja dhe tjetri është zemra. Nëse mendja është objektive, ajo bën dallimin midis të drejtës dhe të gabuarës, të dobishmes dhe të dëmshmes. Ajo ofron mundësi të reja dhe zhvillime teknologjike që do ta bëjnë jetën tonë më të lehtë. Ofron shërbime të sakta dhe të dobishme për sa kohë që qëndron larg obsesioneve ideologjike. Kështu, bëjmë një jetë më të rehatshme dhe më komode financiarisht.

Megjithatë, një botëkuptim i bazuar vetëm në rehati dhe komfort material, nuk mund të sigurojë paqe mendore dhe një jetë pa stres. Është e dukshme që sot kemi shumë probleme psikologjike, edhe pse kemi shumë mundësi financiare.

Zgjidhja e problemeve mbarëbotërore duke mos u neglizhuar e vërteta e zemrës si dhe e mendjes; është të përpiqesh për shfaqjen e vlerave thelbësore

njerëzore si dhembshuria, sakrifica, ndarja, heroizmi dhe bujaria. Zemra e njeriut është si një arë. Ajo e ka të nevojshme të përgatitet për të mbjella, të hidhen në të fara të mira dhe të mbillen fidanë të dobishëm. Sa e bukur është thënia e stërgjyshërve tanë: “Atë që mbjell, do të korrësh.” Në zemrat mbillen edhe farat e inatit, urrejtjes, armiqësisë, xhelozisë dhe grindjes, gjithashtu mbillen edhe farat e dashurisë, dhembshurisë, vetëflijimit dhe bashkëpunimit.

Zemra është burimi i ndjenjave të mira dhe të këqija. Emocionet shpesh dominojnë mendjen, dashuria e tepruar dhe urrejtja e tepruar pengojnë të menduarit korrekt dhe të paanshëm. Një jetë e ekuilibruar dhe paqësore mund të ndërtohet me mendje të shëndoshë, zemër të shëndoshë dhe shije të mirë. Të gjitha këto i përfaqëson fitrati selim, domethënë të jetuarit në përputhje me krijimin, me fjalë të tjera, mosprishja e parametrave të fabrikës.

Një jetë e rehatshme mund të arrihet me arsye dhe shkencë pozitive. Por këto nuk mjaftojnë për të siguruar paqen. Rehatia dhe paqja janë dy gjëra të ndryshme. Nëse një njeri ka probleme në botën e tij të brendshme, nuk është e mundur të ndiejë paqe në botën e jashtme. Ka pak ndryshim nëse një njeriu që i merret fryma është në një kabinë apo në një hotel me shtatë yje. Për një njeri që ia vret këmbën këpuca, nuk ka rëndësi nëse ecën në një zonë të gjerë apo në një rrugë të ngushtë.

Për të përjetuar një lumturi të qëndrueshme dhe një paqe të pafundme mendore, është e nevojshme të mbillni gjëra që do t'i freskojnë zemrat tuaja dhe të kultivohen gjëra që do t'ju bëjnë të lumtur ndërsa i kujtoni ato.

Diturinë dhe urtësinë është e nevojshme t'i japim së bashku. Të jesh i urtë është më e rëndësishme

se të jesh i ditur. Mbartësit e urtësisë janë njerëz shembullorë. Dituria është produkt i mendjes, kurse urtësia është produkt i zemrës. Ka shumë njerëz analfabetë që nuk kanë shkuar as në shkollën fillore, të cilët kanë sjellje shembullore që tërheqin admirimin edhe të atyre që kanë mbaruar universitetin. Le të paraqesim disa shembuj në lidhje me këtë çështje.

Kur babai im i ndjerë hidhte fara në arë, thoshte: "Le të kenë furnizim edhe krimbat dhe zogjtë." Ai dëshironte që edhe ata të përfitonin. Ndërsa kur piqeshin të korrat dhe bëheshin për t'i prerë, disa prej tyre liheshin në një rënë anë të arës, në mënyrë që të hanin edhe zogjtë. Kur binte shi dhe ishte baltë, kur kalonte nga ara e dikujt në arën e tij, fshinte çizmet që të mos përzihej dheu i tjetrit me tokën e tij. Kjo ndjeshmëri ndaj të drejtës të tjetrit është shenjë besimi dhe urtësie të thellë. Urtësia anadollake, e cila e merrte qumështin e një kafshe që kishte kullotur në arën apo kopshtin e dikujt tjetër dhe ia çonte pronarit të këtij të fundit, nuk mund të përfitohet duke studiuar fizikë, kimi, filozofi dhe matematikë.

Nëse edukimi i dhënë nuk e pengon njeriun nga vjedhja, gënjeshtria, pandershmëria dhe uzurpimi i të drejtave të të tjerëve, kjo do të thotë se mundi dhe shpenzimet kanë shkuar dëm.

Sigurisht, është kusht të bëhen investime për të nxitur njohuritë, përvojën dhe eksperimentimin që lehtësojnë jetën dhe mundësojnë zhvillimin teknologjik dhe për të hapur horizonte të reja për njerëzimin. Është e pashmangshme të konkurrosh me botën në këtë drejtim. Përndryshe, nuk do të kishte pavarësi politike dhe ekonomike. Megjithatë, duhet të ketë një bazë morale dhe të ndërgjegjshme mbi të cilën të bazohen këto zhvillime shkencore dhe teknologjike. Është e pamoralshme dhe e paskrupullt të përhapësh sëmundje për të shitur ilaçe, të përgatitësh një mjedis lufte dhe terrori për të shitur armë. Çdo zbulim dhe shpikje duhet të jetë për të mirën e njerëzimit përpara fitimit. Fitimi duhet të vijë gjithmonë në plan të dytë.

Në arsimin formal dhe joformal, objektivi humanitar dhe moral duhet të ketë gjithmonë prioritet. Çfarë dobie ka njohuria e një studenti të arsimuar, universitar që nuk u lë vend të moshuarve, të mëdhenjve apo grave shtatzëna në autobus apo metro?

Në edukim, rëndësi duhet t'i kushtohet shfaqjes së ndjenjave njerëzore në zemra. Për t'i mbajtur gjallë këto ndjenja, duhen paraqitur modele vitale dhe shembullore. Në jetën tonë fetare e kombëtare ka shumë shembuj që i bëjnë njerëzit t'u dridhen zemrat dhe t'u përlohen sytë.

Paraardhësit tanë, Perandoria Osmane, që udhë-

hoqën botën për gjashtëqind vjet, kishin shumë institucione dhe praktika humanitare që përbënin shembull për tërë botën. Kasapët shpërndanin mish dhe të brendshme për macet dhe qentë çdo ditë, ndërtimi i strehëve për zogjtë, vendosja e gurëve të lëmshës, ndërtimi i shatërvanëve, puseve të ujit, shtëpive të jetimëve, azileve, spitaleve për të çmendurit dhe karvan sarajeve janë tablo krenaria për ne. Është jashtëzakonisht e rëndësishme t'ua prezantojmë ato brezave tanë dhe t'i mbajmë të gjalla ndjenjat humanitare dhe ndërgjegjen e tyre.

Baza dhe tharmi i qytetërimit tonë është drejtësia, morali dhe mëshira. Kjo ndjenjë drejtësie dhe dhembshurie është baza e shërbimit tonë ndaj të gjithëve, pa diskriminim fetar dhe racor, në vend që të jemi grabitqarë dhe kolonialistë si perëndimorët.

Por mendoni për njeriun që agjëron duke i dhënë bukën e gojës së vet qenit të uritur. Mendoni për njerëzit që janë të trishtuar ngaqë nuk mund t'ua plotësojnë nevojat nevojtarëve dhe që e ndjejnë dhimbjen e njerëzve që vuanin më shumë se këta të fundit në zemrat e tyre. Mendoni për njerëzit e mëshirshëm që fshijnë borxhet e debitorëve, që paguajnë borxhet e atyre që janë burgosur për shkak të borxhit duke u dhënë kështu lirinë atyre. Kujtoni ata që i ndihmojnë të varfrit në mënyrë indirekte, në mënyrë që të mos cenohet nderi i tyre.

Këto janë vlerat dhe sjelljet e vërteta që i bëjnë njerëzit humanë. Ata që nuk janë të informuar për fqinjët e tyre lart, edhe pse vetë janë ngjitur deri në hënë, nuk kanë asnjë vlerë për njerëzimin.

Këtë brez duhet ta prezantojmë me Mevlanën, i cili ka thënë se, «nëse një njeri në botë ka të ftohtë, të tjerët nuk kanë të drejtë të ngrohen». Këtë brez duhet ta prezantojmë me Bishri Hafiuin, i cili kur e pyetën se pse nuk hynte në shtëpi ngaqë po dridhej në të ftohtë, tha: «Tani po më kujtohen ata që kanë të ftohtë. Por edhe për t'u dhënë nuk kam se çfarë t'u jap, të paktën më lejoni ta ndjej edhe unë të ftohtin e tyre.» Ky brez duhet ta njohë Pejgamberin, i cili ka thënë: «*Ai që fle i ngopur ndërsa fqinji i tij është i uritur, nuk është prej nesh.*» Ky brez duhet ta njohë sahabin e Profetit, i cili u plagosën në fushën e betejës dhe i plasën buzët nga etja, por që prapë se prapë tundi kokën duke bërë me shenjë që uji t'i jepet atij që kishte më shumë nevojë se ai vetë. Vetëm kështu mund të kultivohen ndjenjat njerëzore në zemra. Filizat e mëshirës shfaqen vetëm kështu. Shumë nga ato që mësohen, harrohen, por këto vepra fisnike që prekin zemrën, nuk harrohen kurrë. Ky informacion bëhet farë. Kur vjen koha, zhvillohet në zemra të reja.

EDUKIMI I FAMILJES

— Munir Arëkan —

Familja është e vetmja strehë ku ne përfundimisht do të qëndrojmë me njëri-tjetrin. Varka jonë e paqes që na përqafton, na mbron dhe kujdeset për ne. Në këtë kontekst, faktikisht atë që nuk mundën ta bënin përgjatë shekujve të gjithë mësuesit, studiuesit, dijetarët tanë, miliona libra të shkruar dhe miliarda predikime e këshilla, Zoti ynë bëri të mundur mesazhin, pra “Kthimin në Familje”, në kohën më të shkurtër duke shkaktuar një virus.

Mevlana Xhelaledin Rumi ka një fjalë të mrekullueshme që ia ka thënë djalit të tij, Sulltan Veledit. Ai thotë: “O biri im, Sulltan Veledi! Shkaku që kam ardhur në këtë botë është që të vije edhe ti në këtë botë!”

Ka shumë pak shprehje që përshkruajnë rëndësinë e familjes, përgjegjësinë për të qenë prindër, vendin e fëmijëve tanë në jetën tonë dhe, në një farë kuptimi, arsyen tonë të ekzistencës në këtë botë. Ai Sulltan i zemrës nuk e shihte arsyen e lindjes së tij si vendosjen e rendit mevlevit, hyrjen

në zemrat e njerëzve dhe islamizimin e Anadollit duke bashkëpunuar me Shems et-Tebrizin. Si një punë më e rëndësishme, më urgjente dhe madje më parësore, ai e shihte edukimin e fëmijëve. Sepse ai ishte i vetëdijshëm se nëse nuk mund t’i edukonte fëmijët e tij, nëse nuk i kthente në lëmoshë rrjedhëse, libri i tij i veprave nuk do të ishte i hapur deri në Ditën e Gjykimit. Ai ishte i vetëdijshëm se, nëse brezi i tij nuk do të vazhdonte në Islam dhe nëse pasardhësit e tij nuk do të ishin Kurratu’l-A’jun (drita e syve), atëherë ai nuk do të mbetej si një zë i këndshëm nën këtë kupolë të qiellit.

Sepse, udhërrëfyesi i jetës së përjetshme, i Dërguari i Allahut (a.s.), siç është shembull dhe udhërrëfyës për jetën tonë, ishte shembull dhe udhërrëfyës edhe për jetën e tij. Ai që kur mori shpalljen e parë në malin Nur, në shpellën Hira, kur u takua për herë të parë me Xhibril el-Eminin, kur iu dha urdhri «lexo» pas shtrëngimit të tij, (pas kësaj ngjarjeje të tmerrshme dhe të frikshme), u kthye menjëherë në shtëpinë e tij dhe ra në gjumë të thellë duke thënë: “Më mbuloni,





më mbuloni!” - dhe pasi u zgjua, ia tregoi atë që i kishte ndodhur për herë të parë bashkëshortes së tij, nënës sonë, Hatixhesë. Kjo do të thotë se kur diçka na ndodh, ndalesa jonë e parë, qendra jonë e parë e rehabilitimit, prehja jonë e parë shpirtërore dhe burimi i qetësisë sonë spirituale me të cilën ndajmë situatën duhet të jetë familja jonë! Pa konfirmim nga familja, pa aprovim nga atje dhe pa dëshmitarë nga atje, imazhi ynë i jashtëm do të jetë vetëm një pamje e thatë.

Djali nuk ka mundësi që të mos e dijë këtë. Armiku ynë i madh, shejtani, i cili ishte një nga ata që nuk iu bindën Zotit, nuk iu bind urdhrave dhe u dëbua ngaqë nuk mundi t’i bënte sexhde Ademit për shkak të mendjemadhësisë dhe egos së tij, sigurisht që e di këtë, apo jo? Shejtani i cili ka thënë: “(O Zot) Meqenëse më dëbove, unë me siguri do të qëndroj kundër tyre në rrugën Tënde të drejtë dhe do t’u bëj pritë duke u futur tinëz nga para, prapa, nga e djathta dhe nga e majta, kështu që shumica prej tyre nuk do të të falënderojnë Ty.», pritën më të madhe po e bën në shtëpitë, familjet, bashkëshortët/et, fëmijët tanë dhe te ne.

Të vjetrit na thoshin se detyra më e madhe e djallit të quajtur Hannas është të fusë përçarje mes bashkëshortëve. Shejtani i lëshon mbështetësit e tij për të bërë keq. Pas një kohe, ata kthehen dhe fillojnë të raportojnë. Njëri thotë: “I ngatërrova në namazet e tyre.”, tjetri thotë: “Ua prisha agjërimin.” - dhe tjetri thotë: “I kam bërë të marrin abdest 30 herë.” Iblisi u thotë këtyre një e nga një: «Mirë, kaloni!» Njëri prej tyre vjen dhe thotë: «Kam futur përçarja midis burrit dhe gruas. Së pari futa ndërmyet tyre xhelozit dhe mosbesim. Pas kësaj, i bëja të grindeshin çdo ditë për çështjen më të

vogël. Tani ata të dy u ndanë dhe janë bërë armiq të njëri-tjetrit.” Edhe Iblisit i pëlqen shumë kjo. Andaj e puth atë në ballë dhe i thotë: «Bravo, ke kryer punën më të madhe. Këtej e tutje punët e tjera do t’u prishen gjithsesi.» Ja pra, pikërisht kështu! Sepse asnjë sukses nuk mund ta zëvendësojë dështimin në shtëpi. Nuk mund ta bëjë dot.

Në ditët e sotme, mësoni më të shkollonjë fëmijët kundër armikut tonë të përhershëm, akoma jemi shumë larg nga paralajmërimi në formën: “Mos e harroni shejtanin! Kini kujdes!» Ne madje blejmë mjetet më të mëdha dhe më efektive të edukimit të djallit dhe i fusim në shtëpitë tona. Për më tepër, ne i paguajmë vetë. Tani në çdo shtëpi, në çdo dhomë të shtëpisë sonë, në duart e çdo gruaje dhe fëmije ka televizor, kompjuterë, tableta dhe celularë, të cilët janë armët më efektive të shejtanit. Meqenëse nuk mundëm t’i identifikonim mjetet, materialet dhe metodologjinë e edukimit dhe trajnimit të Qytetërimit të Lashtë Islam, dhe nuk mundëm të zhvillonim mjete dhe metoda të reja dhe efektive edukative të përshtatshme për epokën tonë, po kërkojmë një zgjidhje për problemet tona me zgjidhjet e tyre. Edhe kjo nuk është efektive.

Një nga parimet më të mëdha shoqërore dhe personale të jetës islame është rregulli që def’i mefasid duhet të ketë përparësi ndaj xhelbi menafi. Me fjalë të tjera, në çdo vend apo punë, largimi i së keqes vjen para sigurimit të fitimit. Në këtë aspekt, edukimi familjar nuk mund të bëhet kur të gjitha kështjellat dhe kullat e familjes janë zaptuar nga shejtani. Para së gjithash, është e nevojshme të largojmë të keqen në familjet tona.

I Dërguari i Allahut, paqja dhe mëshira e Allahut

qofshin mbi të, ka thënë «Unë jam dërguar për të plotësuar moralin e lartë.» Sigurisht, një i Dërguar i Moralit pritet t'i nënshtrohet një edukimi moral. Në fakt i është nënshtuar. Prandaj ka thënë: "Zoti im më edukoi dhe sa mirë më mësoi." Një nga emrat më të bukur të Allahut Teala, të vetmit Posedues dhe Krijues të universit, është Zot.

Në fjalor, fjala Rabb/Zot do të thotë «ndërtim dhe zhvillim të diçkaje gradualisht derisa të arrijë pikën e kompetencës», gjithashtu ka edhe kuptime të tilla si «i adhurar, posedues, i nderuar, administrues, edukues, udhëzues, ndihmës, mbrojtës, kujdestar, dhënës i mirësive, përmirësues dhe zhvillues». Rabb është fjala më e përdorur pas fjalës Allah si emër hyjnor në Kuranin Fisnik. Dhembshuria, mëshira dhe veçanërisht funksionet e mbajtjes gjallë duke zhvilluar (rububijet) që përmban ky

emër, përfshin të gjithë botën e ekzistencës. Kështu është krijuar sistemi hyjnor. Dhe në këtë kuptim është shembull edhe për ne.

Allahu është Krijuesi dhe Poseduesi i Gjithësisë. Por Ai është edhe Kryemësuesi në sistemin që ka krijuar! Ai është burimi dhe poseduesi i vetëm i dijes. Ai na mëson ne atë që nuk e dimë. Ai i mësoi Ademit, alejhi's-selam, të gjithë emrat e gjërave - fjalët. Për ata prej nesh që tani do ta modelojnë këtë sistem hyjnor, në këto fjalitë e fundit, ka detyra të mëdha.

Kjo do të thotë që ne duhet të jemi mësues në vendin, rajonin, gjeografinë, kompaninë, institucionin dhe familjen tonë dhe t'i trajnojmë njerëzit për të cilët jemi përgjegjës. Duke qenë se tema jonë është edukimi në familje, më lejoni të ndalem te familja dhe të shpjegoj konkretisht familjen, sepse

Si ta kthejmë familjen në një qendër mësimi?

Para Koronës i dërgonim fëmijët në shkollë dhe shkonim në punë. Kurse tani, disa prej nesh janë të detyruar ta bëjnë punën nga distanca. Edhe pse vendet e punës po përpiqen të kthehen në normalitet, frika nga korona vazhdon të jetë makthi ynë. Në periudhën e koronës nuk kemi mundur ta festojmë dhe përjetojmë as Fitër Bajramin, as festën e Kurbanit, siç jemi mësuar. Edhe nëse shkollat hapen, duket se do të bëjmë një jetë më të përqendruar te familja se kurrë më parë, këtë dhe periudhën e ardhshme. Pra, si do ta kryejmë edukimin familjar në familjet tona në këtë periudhë të veçantë, në këto ditë të koronës?

Kthejeni familjen në një qendër mësimi. Mirë, por si do ta bëjmë këtë? Për ta bërë këtë do t'ju duhen këto tri gjëra:

BIBLIOTEKA FAMILJARE

Familjet janë njësoj si vendet. Ashtu si shkrimleximi, njohuritë e letërsisë dhe qytetërimi në një vend janë në përpjesëtim të drejtë me numrin e bibliotekave dhe shkallën e përfitimit nga biblioteka, kjo vlen edhe për familjet. Biblioteka familjare apo thjeshtë biblioteka është qendra e edukimit familjar. Qytetërimi nuk mund të krijohet pa libra dhe biblioteka. Librat që i blejmë dhe i grumbullojmë në

shtëpitë tona dhe me të cilët formojmë bibliotekën tonë familjare, deklarojnë se sipas cilit sistem moral dhe sistem besimi jetojmë. Kjo është vendimtare për ne. Është e detyrueshme dhe na ngarkon me përgjegjësi. Çdo moto e mirë që lexojmë prej tyre bëhet një element që na mundëson t'i kalojmë kohët tona të vështira.

Mund të fillojmë duke e organizuar bibliotekën familjare gjatë periudhës së koronës. Ne mund ta bëjmë bibliotekën tonë më të rregullt, më sistematike (duke krijuar një sistem që e bën më të lehtë për ta kërkuar dhe gjetur atë që duam). Ne mund të kemi një stuhi mendimesh familjare për mënyrën se si mund ta organizojmë bibliotekën tonë familjare dhe si mund ta bëjmë atë më të bukur. Kështu mund të marrim idetë e mira të të gjithëve. Mund të porosisim libra të rinj dhe t'i vendosim librat që vijnë së bashku. Mund t'u kërkojmë fëmijëve tanë të sjellin libra nga biblioteka dhe t'i bëjmë ata më të njohur me bibliotekën tonë familjare. Në veçanti, mund ta bëjmë më të njohur faktin se cilët libra lexojmë dhe si përfitojmë nga këta libra. Për këtë arsye, kur të na duhet mund ta kërkojmë atë libër, ta hapim, ta lexojmë atë pjesë dhe ta rrisim kështu njohje tonë. Mund të shkruajmë shënime të veçanta familjare në vendet që i lexojmë.

edukimi më bazik dhe efektiv është në familje.

Para së gjithash, një njeri që vendos të bëhet familje duhet të pastrojë injorancën e tij (në kuptimin personal). Ai duhet të përmirësohet në çështje si familja, bashkëshorti/ja, fëmijët, jetesa e tyre, të afërmit dhe komunikimi me ta. Ai duhet ta kuptojë natyrshmërinë e gruas dhe t'i njohë elementet kryesore të psikologjisë njerëzore. Ai duhet të jetë në gjendje t'i ushqejë, t'i rrisë e t'i edukojë fëmijët dhe të jetë një mësues shembullor për ta.

Tani në Pandeminë e Koronës, kemi nevojë ta bëjmë këtë më shumë se kurrë. Sepse pamë që familja është kalaja më e fortë në < Ditët e Itika-fit Vullnetar', ngaqë i kaluam 3-4 muajt e parë të bllokuar dhe të dëshpëruar në shtëpi. Familja është pozicioni më i rëndësishëm. Familja është institucioni më i vlefshëm. Familja është e vetmja

strehë ku ne përfundimisht do të qëndrojmë me njëri-tjetrin. Varka jonë e paqes që na përqafoi, na mbron dhe kujdeset për ne. Në këtë kontekst, faktikisht atë që nuk mundën ta bënin përgjatë shekujve të gjithë mësuesit, studiuesit, dijetarët tanë, miliona libra të shkruar dhe miliarda predikime e këshilla, Zoti ynë bëri të mundur mesazhin, pra "Kthimin në Familje", në kohën më të shkurtër duke shkaktuar një virus. Po, ndoshta nuk kemi mundur të bëjmë një festë si dikur, por cilin Ramazan e kemi kaluar familjarisht, në shtëpi, me bashkëshortin dhe fëmijët tanë deri më sot?

Në çdo të keqe ka një të mirë. Në çdo vështirësi ka një lehtësi. Në çdo fatkeqësi ka një arsye dhe detyrë të veçantë që duhet të na hapë sytë. Zoti na bëftë prej atyre që mund të shohin dhe që bëjnë atë që është e nevojshme!

TABLOJA FAMILJARE

Kjo është një tablo me përmasa afërsisht 100 cm x 60 cm, në hyrje të shtëpisë ose në një vend më të përshtatshëm. Kjo tablo tregon se çfarë mësuam, si e ndamë me të tjerët atë që e mësuam, çfarë - kur e vendosëm në axhendën tonë dhe sa e mbajtëm në axhendë. Ajo është tabloja e ndarjes së përbashkët. Mbajtja e kësaj e përditësuar është thelbësore. Në këtë aspekt mund të ndahet në kategori si fjala e ditës, ajeti fisnik i ditës, hadithi fisnik i ditës, fotografia e ditës, ngjarja, lajmi, anekdota, etj. Nëse aty nuk bëhen ndërhyrje dhe ajo mbetet një qendër e lirë e ndarjes me të tjerët, të gjithë në familje mund të kuptojnë se në çfarë humori janë të gjithë në atë moment. Nëse ky vend vihet nën presion, gjendja e vërtetë e anëtarëve të familjes do të jetë e vështirë të kuptohet. Për shembull, fëmijët mund të shkruajnë pyetjen e ditës aty. Përgjigja mund të jetë me shpërblim. Të mëdhenjtë e familjes mund t'u bëjnë të vegjëlve pyetje me shpërblim. Edhe të vegjlit mund t'u bëjnë pyetje me shpërblime të mëdhenjve. (Siç e dini, për sa i përket efektivitetit, i Dërguari i Allahut, paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të, ka thënë: «*Vepra më e vlefshme është ajo që është e vazhdueshme edhe nëse është e pakët.*» Nëse nuk mund të bëhet ditore, të paktën një herë në javë le të shtjellohet një ajet, një hadith... Edhe kjo madje do të thotë shumë gjë. Kjo për dhjetë vjet bën 520 ajete kuranore dhe 520 hadithe fisnike. Është e mahnitshme! Cilin ajet do të sjellin fëmijët në tablo, cilin hadith do të zgjedhin, edhe kjo është shumë...


DËRRASA FAMILJARE

Ashtu si në klasa, ju sugjeroj të blini një tabelë për shtëpinë tuaj, në varësi të hapësirës dhe buxhetit tuaj. Fakti që anëtarët e familjes ngrihen dhe bëjnë shpjegime në atë tabelë, ka një efekt shumë të rëndësishëm në zhvillimin e personalitetit dhe karakterit. Kjo zhvillon vetëbesimin e fëmijëve dhe u rrit atyre aftësitë e prezantimit. Si rrjedhojë, fjalimet e tyre bëhen më të bukura. Mësimdhënia në dërrasë është një nga format më efektive të të mësuarit. Nga njëra anë, të mëson edhe edukatën e dëgjimit. Kështu ndarja me të tjerët bëhet më e zakonshme.

Të shpjegosh duke shkruar dhe skicuar në tabelë, kërkon njëfarë përgatitjeje. Pjesëtarët e familjes vijnë të përgatitur. Kjo e zhvillon ndjenjën e tyre të përgjegjësisë. Gjatë kryerjes së kësaj, përgatitjet bëhen sipas një axhende familjare. Tregohen temat. Gjithashtu, rrëfimet me temë të lirë, sipas interesave të veçanta të secilit, diversifikojnë dhe pasurojnë njohuritë tona.

Kur thoni ta bëni punën argëtuese, kjo është pjesa më e rëndësishme e punës. Pse fëmijët tanë kanë ikur nga gjyshërit dhe ne? Sepse i kemi mbërthyer. Çdo gjë ua kemi bërë të detyrueshme. Andaj u jemi nxehur, i kemi rrahur dhe jemi zemëruar me ta. Nga ky realitet i hidhur i jetës së tyre, ata iu drejtuan ekraneve të ëmbla (!) të jetës virtuale.

Nuk ka zemërim, bërtitje, rrahje në lojën kompjuterike. Është qejf. Bastardët i kanë bërë argëtuese



edhe lojërat e bazuara në vrasjen e njerëzve! Ata e dinë shumë mirë se si t'i shtënë në dorë fëmijët tanë. Edhe lojëra ka shumë. Niveli i vështirësisë rritet gradualisht. Aty ka emocion. Në sfond ka muzikë të këndshme. Ndërsa kaloni çdo nivel, ka fitime dhe shpërblime. Ka ndarje. Aktualisht, lojërat në internet, lojërat e luajtura me miqtë kolektivisht janë të njohura. Pse? Sepse puna e vetëm nuk ka më kënaqësi!

Edukimi në familje duhet të nxjerrë mësim nga ato që kam thënë më lart. Aktivitetet pa argëtim dhe konkurrencë nuk i tërheqin fëmijët tanë. Nuk mund t'i tërheqë. Edhe Kurani Famëllartë tashmë jepet në ekranet e TRT-së në një format konkursi. A nuk është gjithashtu një garë rendi rregull i vendosur në sistemin hyjnor? A nuk është një garë mirësie me çmime, grada dhe nivele në fund? Ja pra, ky sistem duhet të krijohet. Kuran, Tefsir, Hadith, Sijer... Amenna. Por duhet të ketë edhe një orë të veçantë barcoletash për fëmijët. Një orë filmi. Duhet të ketë kohë për të parë një mini video qesharake. Fatkeqësisht, ne e kemi harruar hadithin: *"Fol me njerëzit aq sa ua pret mendja."* Ne i mësojmë fëmijët në mënyrën e ulemave (dijetarëve) që mësojnë mësuesit e medreseve. Andaj edhe ata po ikin, natyrisht...

Ndërkohë, në kulturën tonë ekziston koncepti më i vlefshëm i teatrit për fëmijë në botë, i quajtur Haxhivat - Karagëz. Çmimi i Haxhivat - Karagëzit, së bashku me disa figura të tjera loje, nuk kushton shumë, nëse e porositni online, do të kushtojë 50-100 TL (lira) në total. Në shtëpi, ju mund t'u fusni shkopinjtë të vegjël nëpër vrimat e tyre dhe të luani Haxhivat - Karagëz me duart tuaja. Temën mund ta zgjidhni si familje dhe mesazhin mund ta jepni me një material edukativ shumë efektiv, sidomos në edukimin e vlerave dhe karakterit të fëmijëve. Kur fëmijët kalojnë para jush ndërsa jeni duke u falur, është e kotë të bërtisni dhe të ngrini zërin. Por nëse këtë ai thotë Haxhivati Karagëzit me humor, do të

ishite e paharrueshme. Gjithashtu, nëse kërkoni në internet për kukulla prej druri, do të shihni shumë kukulla prej druri. Është shumë e rëndësishme për zhvillimin e imagjinatës së fëmijëve.

PROVONI TË ZBULONI TALENTIN DHE KARAKTERIN E FËMIJËVE TUAJ


Periudha e koronës është koha kur jemi pak më ballë për ballë si familje. Disa teste të personalitetit të marra nga interneti dhe aktivitetet për të njohur personalitetin e karakterin duhet të jenë aktivitetet më të rëndësishme të kësaj periudhe të veçantë. Sipas ajetit: "Secili vepron sipas karakterit të vet.", ne sillemi në përputhje me personalitetin dhe karakterin tonë. Atëherë, a nuk duhet të kërkohet zbulimi dhe përcaktimi i personalitetit dhe sjelljes sonë?

Ne duhet të zbulojmë se cilat tipare superiore kanë fëmijët tanë dhe duhet të bëjmë aktivitete që do t'ua mundësojnë ta kuptojnë këtë. Kjo është shtylla e jetës. Është shtylla kurrizore e saj. Nëse fëmijët tanë, të cilët nuk e dinë arsyen e ekzistencës, nuk zbulojnë veten e tyre, do të jenë të pakënaqur, të pasuksesshëm dhe të paqëndrueshëm.

Meqë jemi të gjithë bashkë në shtëpi, mund të luajmë lojëra të formës: «Gjeje po munde se kush jam unë!» Të gjithë shënojnë tiparet që dinë për njëri-tjetrin. Shkruajtësit i lexojnë ato veçori dhe të tjerët përpiqen të zbulojnë se kush është dhe kush i ka këto veçori. Kjo është edhe argëtuese.

GJENI FUSHAT E INTERESIT PËR FËMIJËT TUAJ, BASHKËSHORTIN/EN TUAJ DHE VETEN TUAJ. ORGANIZONI AKTIVITETE TË VEÇANTA PËR TA.

Allahu i ka krijuar njerëzit me personalitete, identitete dhe prirje të ndryshme. Kjo është arsyeja e rendit dhe stabilitetit botëror. Mendoni kështu. Ka bibliotekarë që i duan librat si fëmijët e tyre, që gati i puthin, i fshijnë, u heqin pluhurin dhe kujdesen për ta, pavarësisht se ne nuk do të uleshim dhe të punonim edhe po të na



jepnin një milion dollarë. Unë jam krijuar për botën e jashtme. Më duhet të eci, të shëtis përreth dhe të jem në lëvizje. Përndryshe vdes. Nuk duroj dot. Prandaj, secili prej nesh në familje ka interesa të ndryshme të veçanta. Me metoda demokratike, të zbulosh se kush dhe çfarë aktiviteti dëshiron të bëjë dhe t'i bësh ato aktivitete në mënyrë të barabartë do të thotë që secili të bëjë aktivitete të veçanta në të cilat gjen veten dhe është i lumtur.

MËSONI FAMILJARISHT

Fëmijët tanë shkojnë në shkollë dhe mësojnë diçka. Dhe ajo që mësojnë mbetet në trurin e tyre. Sigurisht, nëse u mbetet. Por nëse i mësojmë dhe i përdorim gjërat si familje, bashkë me fëmijët tanë, ato do të mbahen mend dhe do t'i japin kuptim dhe vlerë jetës sonë. Informacioni që nuk përdoret në familje është i destinuar të kalbet në tru si plehurat e mbetura. Kur kalben, fshihen nga truri. Por informacioni i përdorur familjarisht nuk vjetërsohet. Gjithashtu nuk bëhet plehra.

NDANI KOHË DHE KALONI NË PRAKTIKIMIN E ORËS FAMILJARE

Allahu i do robërit e Tij të rregullt dhe sistematikë. Në edukimin dhe jetën tonë të përbashkët, logjika "gjithsesi jemi në shtëpi, jemi me të tanët, e bëjmë kur të na teket, kur të na e dojë qejfi", është e gabuar. Çdo aktivitet që duhet bërë, duhet të ketë të paktën plane javore, plane fundjave dhe nëse është e mundur edhe plane ditore. Dhe ky plan duhet ndjekur.

Ndjekja e këtij plani ju detyron të jeni më sistematikë dhe të veproni. E bën jetën më të rregullt. Mos e banalizoni atë që bëni duke neglizhuar të jeni sistematikë. Nëse ajo që bëni është sistematike, do të ketë perceptim dhe ndikim të madh në botën e fëmijëve tuaj. Ata do të fillojnë të jenë shumë më të kujdesshëm.

MJETET DJALLËZORE TË EDUKIMIT SHNDËRROJINI NE MJETET MËSHIRE TË EDUKIMIT

Si t'i kthejmë mjetet demonike në mjete të mëshirës? Do të ndalemi dhe do t'i vëzhgojmë. Ne do t'i vëzhgojmë duke ua shpjeguar vazhdimisht fëmijëve tanë. Nëse do të shohim ndonjë gabim, do t'i paralajmërojmë. Nëse nuk përfundoi mirë dhe nëse situata është e keqe për ne, do të shohim se si mund ta ndryshonim nëse do të ishim skenaristë. Në një farë kuptimi, kjo do të jetë gjithashtu e dobishme në fitimin e vetëdijes. Ne

do ta tregojmë vetë rrezikun. Kështu do t'i bëjmë së bashku analizat.

Kurse elementi më i rëndësishëm i kthimit të këtyre instrumenteve djallëzore në një instrument të mëshirës është që nënat të cilat përpiqen t'i ushqejnë foshnjat e tyre me telefonat dhe tabletat duke ua dhënë t'i shikojnë, të mësojnë «si t'i ushqejnë fëmijët» sa më shpejt të jetë e mundur dhe të heqin dorë nga ky bullizëm. Vallë, a janë të vetëdijshme nënat që i njohin foshnjat e tyre me filmat vizatimorë për fëmijë duke i hipnotizuar ata, se çfarë masakre mendore po bëjnë? Foshnjat dhe fëmijët nuk duhet të ushqehen duke parë filma dhe reklama. Tre vitet e para janë vitet në të cilat formohet 70-80% e karakterit dhe kur sinjalet e marra gdhenden drejtpërdrejt në hard diskun kryesor. Sugjerimet subkoshiente që janë të vështira për t'u rikuperuar në të ardhmen merren në moshën 3 vjeçare. Ju lutem, hiqni dorë nga kjo masakër dhe vrasje mendore.

Me dëshirën për t'u bërë një familjeje që është e vetëdijshme se e kemi kthyer familjen në një qendër trajnimi, se jemi edukatorë për fëmijët tanë, jo dado dhe kujdestarë, se t'i edukojmë së bashku me bashkëshorti/en, se mëmësia është detyra më e vlefshme femërore dhe atësia është detyra më e rëndësishme e mashkullit!..





PËR ATA NUK DO TË KETË AS FRIKË, AS PIKËLLIM

— Dr. Murat Kaja —

Telashet, brengat dhe frika e kiametit dhe e ditës së gjykimit janë përshkruar në Kuranin Famëlar-të dhe në hadithet fisnike. Aty jepen peizazhe të tmerrshme. I është fryrë Surit, qiejt dhe toka janë bërë pluhur dhe janë shndërruar në tokë e qiej të tjerë. Duke dëgjuar një tjetër zhurmë të tmerrshme të Surit, të gjithë njerëzit janë ngritur nga varret me një frikë të paparë dhe po vrapojnë drejt vendit të mahsherit (tubimit të madh). Dielli është afruar me një milje dhe njerëzit janë të zhytur në djersë aq sa veprat e tyre të këqija në këtë botë. Disa janë të mbuluar në djersë deri te thembra, disa deri në gjunjë dhe disa deri në brez. Kurse disa të tjerëve prej tyre djersa sikur ua ka mbyllur gojën.¹ I Dërguari i Allahut (a.s.), na lajmëron për këtë siç vijon: «Ditën e kiametit njerëzit do të djersitin në vendin e mahsherit. Aq shumë (do të djersitin) sa që djersa e derdhur do të bjerë në tokë në një thellësi prej shtatëdhjetë krahësh, pastaj do të ngrihet për të mbyllur gojën e tyre dhe madje do të arrijë deri te veshët e tyre.»² Jo vetëm kaq, njerëzit do të përjetojnë një ankth tjetër kur t'u jepen librat e veprave, zemrat e tyre do të dridhen në krye të Mizanit (peshores së veprave) dhe frika që do të ndiejnë kur do të kalojnë Siratin, do të jetë ndryshe nga çdo gjë tjetër. Shkurtimisht, fillimi i ahiretit do të jetë i mbushur me frikë, trishtim, ankth dhe pikëllim për shumicën

e njerëzve. Aq sa do t'i kthejë fëmijët e vegjël në pleq me flokë të thinjura. Ndërsa kjo është gjendja për shumicën e njerëzve, ka disa njerëz të tjerë që nuk i përjetojnë kurrë këto frikëra dhe nuk e dinë se çfarë është trishtimi e pikëllimi. Allahu Teala do t'i nderojë ata nën hijen e Arshit të Tij. Ata nuk do të kenë as vapë, as djersë. Ata nuk do të kenë frikë nga e ardhmja dhe as nuk do të shqetësohen për të kaluarën. Ata do të jenë në një lumturi të papërshkrueshme në kënaqësinë e mirësive hyjnore. Zoti i Plotfuqishëm ka thënë se kush do ta marrë këtë mirësi që në fillim dhe i ka thirrur të gjithë robërit e Tij në paqe. Tani le të shohim se çfarë duhet të bëjmë për të qenë një nga këta njerëz të lumtur:

1) Kur Allahu i Lartësuar e zbriti familjen njerëzore nga xheneti në këtë botë, u dha atyre udhëzimin e mëposhtëm: “Prej Meje patjetër do t’ju vijë një udhërrëfyes. Kushdo që ndjek udhëzuesin që kam për të dërguar, ata nuk do të kenë as frikë, as pikëllim.”³ Domethënë, ata që ndjekin profetin dhe librin e dërguar nga Allahu nuk do të kenë frikë në botën tjetër, gjithashtu nuk do të jenë të pikëlluar në këtë botë ngaqë “do të vdesin» apo në botën tjetër ngaqë «kanë vdekur». Ata nuk do të pikëllohen për të kaluarën, as nuk do të kenë frikë për të ardhmen.

2) Ata që besojnë Allahun dhe Ditën e Fundit

1. Shik. Muslim, Xhenet, 62; Tirmidhi, Kijamet, 2/2421.

2. Buhari, Rikak, 47.

3. Shik. Bekare, 38.

dhe bëjnë vepra të mira, kanë shpërblimin e tyre te Zoti (xh.xh.) dhe as nuk do të kenë frikë, as nuk do të pikëllohen.⁴

3) Ata që i dorëzohen Allahut me tërë qenien e tyre si robër dashamirës,⁵ të sigurtë në fenë e tyre, që e zbatojnë fenë vetëm për Allahun dhe që i bëjnë veprat e tyre me dashamirësi, kanë shpërblimin e tyre te Allahu. Ata nuk do të kenë frikë në botën tjetër dhe nuk do të pikëllohen ngaqë do të vdesin.⁶

4) I tillë është rasti me ata që e shpenzojnë pasurinë e tyre në rrugën e Allahut dhe pastaj nuk qortojnë dhe ofendojnë pas asaj që kanë shpenzuar. Sepse një fjalë e mirë dhe një falje janë më të mira se sadakaja e ndjekur nga lëndimi.⁷ Osmani dhe Abdurrahman ibn Aafi përfshihen në këtë grup ngaqë ata e pajisën ushtrinë islame duke shpenzuar në kohë të vështira.⁸

5) Ata që shpenzojnë pasurinë e tyre në rrugë të Allahut ditë e natë, fshehurazi dhe haptazi,⁹ për shembull, ata që mbajnë kalë për të luftuar në rrugën e Allahut dhe që vazhdimisht mbulojnë shpenzimet e tyre, hyjnë në këtë grup. Duke e krahasuar me këtë, mund të përcaktojmë se çfarë duhet të bëjmë sot. E rëndësishme është që ditë e natë, fshehurazi dhe haptazi, të mbështeten përpjekjet që lartësojnë Islamin dhe të bëhen kontribute materiale e shpirtërore për këtë kauzë.

6) Ata që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, e falin namazin në kohë dhe japin zekatin e pasurisë së tyre.¹⁰

7) Ata që bien dëshmorë në rrugën e Allahut.¹¹

8) Ata që besojnë në peygamberët që Allahu i ka dërguar si përgëzues dhe paralajmërues dhe e përmirësojnë gjendjen e tyre.¹² Këta ruhen nga e keqja duke i dëgjuar nga i Dërguari i Allahut (a.s.), ajetet, farzet dhe dispozitat e Zotit (xh.xh.).¹³ Ata i zbatojnë të drejtat ndërmjet tyre dhe Allahut¹⁴ dhe i bëjnë me devotshmëri veprat e tyre.¹⁵

9) Besimtarët që meritojnë të hyjnë në xhenet.¹⁶

4. Shik. Bekare, 62; Maide, 69.

5. Shik. Bekare, 112.

6. Shik. Ibn Ebi Hatim, I, 208.

7. Shik. Bekare, 262-263.

8. Shik. Taberi, XI, 589.

9. Shik. Bekare, 274.

10. Shik. Bekare, 277.

11. Shik. Alu Imran, 170.

12. Shik. En'am, 48.

13. Shik. A'raf, 35.

14. Shik. Ibn Ebi Hatim, IV, 1295.

15. Shik. Mukatil, I, 561.

16. Shik. A'raf, 49.

10) Ata që janë miq të Allahut me besim dhe devotshmëri.¹⁷ Këta duan për hir të Allahut dhe urrejnë për hir të Allahut. Ata gjithashtu i duan vëllezërit e tyre besimtarë për hir të Allahut. Ata që bëhen miq me Allahun në këtë mënyrë nuk do të kenë kurrë frikë apo brengosje se do të dëbohen nga xheneti.¹⁸ Faktikisht, në një hadith kudsij thuhet: *“Në Ditën e Gjykimit Allahu Teala do të thotë: Ku janë ata që e duan njëri-tjetrin për hir të madhështisë sime dhe bindjes ndaj Meje? Sot, kur nuk ka asnjë hije, Unë do t'i fus ata nën hijen e Arshit Tim dhe do t'i mbroj.”*¹⁹

11) Ata që janë trashëgimtarët e librit.²⁰ Këta njerëz fatlumë shpëtojnë nga mundimi i sigurimit të bukës në këtë botë, nga Iblisi dhe iluzionet e tij, nga trishtimi i mëkateve dhe i të këqijave, nga shqetësimi për humbjen e mirësisë dhe ndryshimit të zemrës nga frika e refuzimit të bindjes, përfundimit të keq dhe mos'hyrjes në xhenet. Megjithatë, ata që i bëjnë zullum vetes së tyre, do të vuajnë për një periudhë të caktuar kohore në botën tjetër.

12) Ata që e arrijnë shpëtimin duke u mbrojtur nga mohimi i Allahut (me devotshmëri), nuk do t'i prekë e keqja dhe as nuk do të vuajnë.²¹ Allahu do t'i shpëtojë ata falë virtyteve dhe veprave të tyre të mira.

13) Atyre që thonë: *“Zoti ynë është Allahu.”* - dhe jetojnë në rrugën e drejtë, u zbresin engjëj dhe i përgëzojnë duke u thënë: *“Mos u frikësoni, mos u pikëlloni dhe gëzohuni me xhenetin që ju është premtuar!”*²² Engjëjt u shkojnë (njerëzve) në kohën e vdekjes, në varret e tyre dhe kur ringjallen dhe i përgëzojnë ata që besojnë, që nuk bëjnë shirk, që i kryejnë obligimet, që i bëjnë veprat e tyre vetëm për Allahun dhe që vazhdojnë në këtë gjendje derisa të takohen me Allahun duke u dhënë këtë përgëzim: *“Mos kini frikë nga ahireti, mos u shqetësoni për fëmijët, bashkëshortet apo gjëra si borxhet që i keni lënë në dynja, sepse Allahu është garantues për ta. As mos kini frikë nga gjërat që do të hasni në të ardhmen, as mos u trishtoni për gjërat që keni lënë pas!”*

14) Ata që besojnë në ajetet e Allahut dhe i nënshtrohen urdhrave të Tij do të jenë gjithashtu të mbrojtur nga frika dhe trishtimi.²³

17. Shik. Junus, 62-63.

18. Shik. Mukatil, II, 243.

19. Muslim, Birr, 37.

20. Shik. Fatir, 32-34.

21. Shik. Zamer, 61.

22. Shik. Fussilet, 30; Ahkaf, 13.

23. Shik. Zuhuf, 68-69.



MBULESA ËSHTE KËRKESA E BESIMIT

— M. Sami Ramazanollu —

«O Profet, thuaju grave dhe vajzave të tua, si dhe grave të besimtarëve, që të lëshojnë mbulesën e tyre (të kokës) përreth trupit. Kjo është mënyra më e përshtatshme që ato të njihen e të mos ngacmohen nga të tjerët. Me të vërtetë, Allahu është Falës dhe Mëshirëplotë.» (Ahzab, 59)

Domethënë, o Pejgamber, i cili je dërguar si udhërrëfyes dhe udhëzues nga Allahu! Para së gjithash, këshilloji bashkëshortet e pastra dhe vajzat e ndershme të tua dhe së dyti besimtarët e tjera, në mënyrë që ata të veshin mbulesën e tyre. Sepse, veshja e këtyre petkave është gjëja më e afërt për të hequr qafe sulmin e të prishurve dhe për të shpëtuar nga mundimet që mund t'u shkaktojnë ata. Ndërkohë, Allahu i fshin gabimet që kanë ndodhur për shkak të faktit se ato ecnin pa mbulesë para zbritjes së këtij ajeti dhe tregon mëshirë ndaj tyre duke shpallur rregullat e duhura.

Në këtë rast, urtësia në ligjshmërinë e mbulesës është mbyllja e derës së përçarjes, mbrojtja e brezave nga humbja, shpëtimi i gruas nga sulmi i dikujt tjetër, vënia e rregullit në organizimin e familjes dhe puna për edukimin e fëmijëve dhe përmirësimin e botës nga jashtë prej burrave dhe nga brenda prej grave.

Allahu i Plotfuqishëm me këtë ajet fisnik, duke

i mbrojtur gratë nga paragjykimet dhe sulmet e të prishurve, ka deklaruar se kështu zemrat e tyre do të jenë të qeta.

Urdhri i Allahut të Madhëruar për mbulesën është një rregull dhe ligj i madh për rendin e botës, duke siguruar kështu rehatinë e zemrave të të gjithë njerëzve, bazën e harmonisë midis familjes, edukimin e fëmijëve të dëshpëruar dhe çlirimin e njerëzve nga armiqësia me njëri-tjetrin.

Mbulesa është mënyra e vetme për të mbrojtur lirinë e grave. Meqenëse gratë nuk mund ta sigurojnë jetesën në mënyrë adekuate pasi janë të zëna me rritjen e fëmijëve dhe vështirësitë e kujdestarisë, është e domosdoshme që të jenë nën mbrojtjen e burrit në çështjet e sigurimit të jetesës. Sipas natyrshmërisë njerëzore burrat janë dominues. Burri siç është i detyruar të sigurojë ushqimin, veshjen dhe vendbanimin e gruas së tij, gjithashtu është i detyruar për t'u bërë ballë çdo lloj shtypjeje për shkak të sigurimit të jetesës dhe për të menduar për rehatinë e tyre (pjesëtarëve të familjes) ditë e natë. Po ashtu ai është përgjegjës për vështirësitë e pashtershme, siç është ndërmarrja e mbrojtjes dhe e ruajtjes së tyre. Gjëja për të cilën një grua është përgjegjëse në Islam është të mos e cenojë dashurinë e burrit të saj dhe t'i kënaqë zemrën atij.

“Atje (në xhenet) do të ketë virgjëresha sy ulur, të cilat para tyre nuk i kanë prekur as njerëz, as xhindë. Atëherë, cilat dhunti të Zotit tuaj po i mohoni?!» (Rahman, 56-57)

Me fjalë të tjera, në xhenet ka gra të përgatitura për besimtarët dhe adhuruesit, të cilat i kanë shikimet vetëm për bashkëshortët e tyre dhe atyre nuk u vjen në mendje asgjë përveç këtyre bashkëshortëve. Ato gjithashtu nuk shohin askënd tjetër përveç bashkëshortëve të tyre. Nisur nga kjo, gratë e banorëve të xhenetit nuk i shikojnë të tjerët dhe nuk ndjejnë dashuri në zemrat e tyre përveçse ndaj bashkëshortëve të tyre. Kështu (në xhenet) zemrat e çdo burri dhe gruaje do të jenë gjithmonë e sigurta dhe të dashura ndaj njëra-tjetrës. Atëherë, cilën nga dhuntitë e Zotit tuaj do të guxoni ta mohoni? Në ajet tregohet se mbulesa e grave është e lavdëruar dhe vazhdimi i dashurisë së tyre (bashkëshortëve dhe bashkëshorteve) për njëri-tjetrin është vetëm në mbulesë.

KËMBËNGULJA NË MËKAT ËSHTË LUFTË ME ALLAHUN

— Osman Altas —

Dëgjo, o nefsi im... Allahu e krijon çdo qenie njerëzore në mënyrë të veçantë. Për këtë arsye, asnjë njeri nuk është i njëjtë me një tjetër. Mos mendo se virtytet që i posedon i ke nga vetja. Ato të janë dhënë amanet. Andaj mos i nënçmo ata që janë të dobët nga aspekti i aftësive të tyre. Allahu është Ai që jep, Allahu është Ai që merr, Allahu është Ai që bën. Ne kemi vetëm atë që na ka dhënë Ai. Zaten çfarë mund të kemi përveç kësaj?! Andaj kuptoje këtë, sepse nëse e kupton, të mjafton.

Dëgjo, o nefsi im... Nuk ke garanci për besimin në frymën tënde të fundit. A nuk mjafton kjo që të kesh frikë? Për këtë arsye, kthehu tek Allahu me gjithë zemër, kthehu tek Allahu me gjithë qenien tënde dhe lutju Atij me gjithë fuqinë tënde duke thënë: «O Allah, ktheje shikimin tim drejt qenies Tënde në atë mënyrë që të mos më duhet të shoh sy të tjerë. Madje, të mos e kem të mundur të shoh sy të tjerë.»

Dëgjo, o nefsi im... Ke jetuar kaq vite. Kur e kthen kokën pas dhe sheh, të duket një kohë e shkurtër. Pastaj thua: «Është sikur të ketë fryrë një erë.» Vitet e panjohura që i ke para dhe që ka gjasa t'i jetosh, i pandeh si shumë të gjata dhe sikur nuk do të mbarojnë kurrë. Kur do ta mbledhësh mendjen? Mos prit vdekjen për t'u zgjuar...

Dëgjo, o nefsi im... Një mëkat që e ke bërë në fshehtësi mos e dëshmo duke e zbuluar. Allahu me mirësinë e Tij mund të ta falë mëkatin që ke bërë. Por, nëse ua tregon hapur këtë mëkat të tjerëve, atëherë kjo do të thotë se je i kënaqur me mëkatin. Mendja e një njeriu të tillë do të thotë se është e vdekur. Mendo për ndëshkimin që do të vuash në botën e përtejme nëse Allahu nuk të fal...

Dëgjo, o nefsi im... Mëkatet që ke menduar se nuk i ke bërë kurrë, mund të të shkatërrojnë. Ndodh një vrasje, pajtohesh me vrasësin për shkak të paragjytimeve politike ose racore, apo je i kënaqur me vrasësin dhe krimin. Kështu mëkati shkruhet njëjtë

edhe për ty. Kjo do të thotë vetëvrasje për ty.

Dëgjo, o nefsi im... Të mos falësh namaz do të thotë vetëvrasje dhe krim kundër vetes. Gjëja e parë që Allahu do të na marrë në llogari është namazi. Çfarë do të bësh nëse Allahu nuk të fal? Fali namazet qoftë edhe me mangësi apo pa sinqeritet. Të paktën le të kesh namaz aq sa për të t'u përplasur në fytyrë...

Dëgjo, o nefsi im... Në këtë periudhë krimi është bërë aq shumë i larmishëm saqë pothuajse është e pamundur që një njeri të jetë i pafajshëm. Nëse zemra jote nuk ka vdekur, qëndro me robërit e devotshëm dhe evlia të Allahut dhe përpiku të marrësh lutjet e tyre. Një vështrim i evliave ndonjëherë vlen më shumë se e gjithë bota. Ti duhet ta dish këtë.

Dëgjo, o nefsi im... Të këmbëngulësh në mëkat dhe të vazhdosh në të do të thotë të luftosh me Allahun. Ai që lufton me Allahun, e përplas kokën në gur. Ai e hedh veten në zjarrin e xhehenemit. Nëse zemra jote nuk ka vdekur, largohu menjëherë nga ky gabim. Nëse do të ishte e mundur të shihej xhehenemi në tokë qoftë edhe për një sekondë, askush nuk do të mëkatonte kurrë, qoftë edhe me çmimin e vdekjes. Nëse mund të mëkatosh, do të thotë se je krejtësisht injorant.

Dëgjo, o nefsi im... Ka dy rrugë. E para është rruga për në xhehenem. Kjo është një rrugë argëtuese që e kënaq nefsin, është si mjaltë helmues, ka hijeshi të lartë, e zbukuruar me xhinë e demonë njerëzorë dhe e zbukuruar me gra gjysmë të zhveshura. Është plot telashe dhe fatkeqësi, por është joshëse për nefsin. E dyta është rruga për në xhenet. Kjo është rruga e Pejgamberit, evliave, dijetarëve dhe besimtarëve të drejtë. Në këtë rrugë ka namaz, ka Kuran, ka adhurim, është pak më e vështirë të shkosh. Andaj bëje vetë zgjedhjen tënde. Jeto sipas vendit ku dëshiro të shkosh.

FEJA DHE NJERIU NË KOHËT MODERNE

— Ahmet Tashgetiren —

Nga aspekti i “**vlerës**”, ajo që i nevojitet njeriut të parë në tokë ose e shprehur ndryshe, njeriut të parë që është krijuar, është përgjigjja e pyetjes se cilat do të jenë zgjedhjet e tij në lidhje me vetveten dhe botën që e rrethon.


Kur në mes futet edhe një njeri i dytë, përsëri nga aspekti i “**vlerës**”, lind pyetja se cili do të jetë kuadri i marrëdhënieve midis dy njerëzve. Kur rritet numri i njerëzve, tashmë nevojitet kërkimi i “**vlerës**” për një shoqëri të tërë. Islami dhe fetë hyjnore, në të gjitha këto raste, kësaj pyetjeje i përgjigjen me faktin se njeriu i parë ishte edhe profeti i parë. Ndërsa profeti është njeriu, që i ka sjellë njerëzimit lajme, dije dhe mesazhe prej Krijuesit ose e përmbledhur në një shprehje të vetme që i përmban të gjitha këto, një “**Hartë rrugore**”. Emri i përveçëm i mesazhit që vjen prej Krijuesit, është “**vahj/shpallje**” dhe gjithësia e vahjit, nënkupton “**fenë hyjnore**”.

Po të tjerët si e shpjegojnë? P.sh. të marrim shpjegimin e **Thomas Hobbes**. Sipas tij, njerëzit e fillojnë udhëtimin si ujçer të njëri-tjetrit. Parimi i tyre

është ngrënia e njëri-tjetrit, përplasia, goditja dhe eliminimi... Kështu kalojnë vitet. Më vonë, njeriu e kupton se nuk ecet duke ngrënë tjetrin dhe thotë: “*Ta ndalim përplasjen. Të formojmë një forcë që është mbi të gjithë ne dhe t’i japim të drejtën të zgjidhë mosmarrëveshjet midis nesh, duke pranuar çdo gjykim të tij.*” Hobbes mendon se kështu kanë lindur “**shteti**” dhe “**parimet e shtetit**”. Mirëpo, Hobbes nuk mjaftohet me kaq. Ai shprehet se në fazat e mëtejshme të “shtetit”, fuqia që i është dhënë atij, shndërrohet në një përbindësh. Ky përbindësh është një krijesë që e ka marrë emrin prej Teuratit/Torës dhe Inxhilit/Ungjillit dhe simbolizon të keqen. Emri i tij është “**Leviathan**”.

Thomas Hobbes e shpjegon këtë koncept në librin e tij “*Leviathan, brendësia, forma dhe fuqia e një shtetit fetar dhe botëror*”:

“**Mënyra për t’i mbrojtur ata (shtetasit) nga pushtimi i të huajve, për t’i penguar që të dëm-**



tojnë njëri-tjetrin dhe për të siguruar industrinë e tyre dhe frytet e tokës, është t'ia japësh të gjithë fuqinë dhe pushtetin një njeriu ose një këshilli (parlamenti) njerëzish... Njerëzit (që jetojnë në shoqëri), duhet t'i thonë njëri-tjetrit, *“Unë heq dorë prej të gjitha të drejtave të mia dhe ia jap ato këtij njeriu ose këtij këshilli njerëzish”*. Në këtë mënyrë, e gjithë fuqia dhe pushteti përqendrohet në një njeri të vetëm. Ky quhet shtet, ose latinisht *“civitas”*. Kjo është lindja e Leviathan-it të madh.”

Kjo mënyrë shpjegimi, *“Më parë sheh nevojën e një “vlere” të njerëzve që jetojnë në shoqëri. Pastaj, në kuadër të kësaj vlere, sheh të nevojshëm një autoritet, i cili do të menaxhojë marrëdhëniet njerëzore. Ndërsa në fazën e tretë, parashikon transferimin e përgjegjësisë së përfaqësimit tek ky autoritet dhe respektimin e vendimeve të tij. Mirëpo Hobbes, këtu nuk e anashkalon piketimin e rrezikut të kthimit në një përbindësh të këtij autoriteti, që i është dhënë përgjegjësia e përfaqësimit. Në fakt, ky është edhe problemi që ekziston së bashku me njeriun: Si do të mbahet nën kontroll kjo fuqi? Edhe një njeri i dobët ka një farë fuqie dhe, nëse ai e përdor atë pa kontroll, mund të bëhet i rrezikshëm për njerëzit. Por kur fuqia e njeriut të marrë dimensione të paimagjinueshme, përdorimi i saj sjell në rend të ditës një zhdukje/katastrofë në shkallë universale. Në analizën e Hobbes, shteti i cili del në skenë si një forcë rregullatore, është një institucion që do të menaxhohet nga njerëzit. Hobbes nuk e sheh të pamundur që një institucion njerëzor të kthehet në **“Leviathan, në një përbindësh”**. Prandaj lind nevoja e një **“vlere mbizotëruese”** dhe një **“përgjegjësie”**, e cila do ta kufizojë, si fuqinë e një njeriu të vetëm, ashtu edhe fuqinë e një njeriu të pajisur me vullnetin e shtetit. Pra, çështja është të zgjedhësh: Ose çdo gjë do të përcaktohet/kontrollohet nga fuqia e një njeriu apo e shtetit, ose të gjitha fuqitë do të lidhen pas një pushteti mbizotërues, ndaj të cilit do të mbajnë përgjegjësi... Në fakt, nëse zgjidhet që një person ose shteti të jetë përcaktues/kontrollues fuqie, gjithmonë ka rrezik që në një farë pike ata të kthehen në një **“përbindësh lufte”**.*

Kurani fisnik demaskon **“fuqinë brenda njeriut që me këmbëngulje nxit të keqen”**. Kjo do të thotë se edhe një njeri i vetëm edhe formacione të tjera, mund të bëhen provokatorë luftërash... Nëse i referohemi kohës sonë, vërejmë se bota është kthyer në shesh lufte të hapur apo të fshehtë, nga përbindësia të vegjël e të mëdhenj. Një gjë është e vërtetë, aq sa rritet fuqia, aq rritet edhe nevoja për ta kontrolluar atë. Kjo, sepse fuqia e pakontrolluar, në çdo moment është e gatshme të largohet nga të

qenit një forcë pozitive dhe të kthehet në një forcë **“shkatërruese”**. Dhe me të vërtetë që njeriu i kohës sonë ka arritur fuqi të jashtëzakonshme, në sajë të zhvillimeve shkencore dhe teknologjike. Nëse parimi, **“njeriu është ujë i njeriut”** vazhdon të rrjedhë ende në damarët e njeriut, ai tashmë është pajisur me fuqi të jashtëzakonshme për të zhdukur ekzistencën e vet dhe të universit. Tashmë, në sajë të një arme shkatërrimi në masë, mund të fshih nga faqja e dheut vende e popuj. Duke manipuluar gjenet njerëzore, mund të nxirrni genie krejt të ndryshme. Mund të vrisni fëmijët në barkun e nënës. Mund të bëni qitje mbi fëmijët. Mund të ndërtoni fusha të vdekjes, Gulaufe, Guantanamo, Ebu Garibë, Palestinë, Bosnjë, Çeçeni, Ruanda etj...

Çfarë do ta ndalojë njeriun? Ta supozojmë se Leviathani i kohës sonë është Amerika. Çfarë do ta ndalojë atë? Ta supozojmë se është Kina, Rusia apo Izraeli. Kush dhe si do t'i ndalojë këta kur të përdorin forcën?.. Thuhet: **“Mirë që ka një ekuilibër force, sepse në këtë mënyrë nuk mund të përdoren armët e shkatërrimit në masë. Nëse njëri prej tyre e përdor, duhet të marrë parasysh se do i vërë flakën gjithë botës.”**

Shikoni pra këtë dilemë pa rrugëdalje! Duhet të zotërosh fuqi vdekjeprurëse, që jeta e njerëzve të vazhdojë! Në fakt, nuk është se njeriu nuk po kërkon vlera që do ta kapin për dore. Për sa i përket të drejtave njerëzore dhe rregullit universal, disa **“Marrëveshje Universale”**, mund të shihen si reflektimi i kërkimit të një **“vlere mbizotëruese”** në planin universal.

Nevoja për **“vlera etike”**, e cila kohët e fundit po përmendet shumë, pa diskutim që shpreh domosdoshmërinë e një vlere obliguese mbizotëruese. Mirëpo edhe ndjenja e vlerës etike mund të ngelet e pakuptimtë përballë njeriut, i cili ka prirjen të gdhendë gjithçka sipas vetes së tij. Për shembull, Amerika dhe Turqia janë dy shtete të cilat nuk e nënshkruajnë marrëveshjen e Kjosos. Marrëveshja e Kjosos cakton parimet e ruajtjes së ambientit dhe të ekuilibrit ekologjik. Pra, që të shpëtojë ajri, uji dhe të mbjellat. Që njeriu të mos helmohet kur të marrë frymë. Por me pretekste të ndryshme, si Amerika, ashtu edhe Turqia nuk e firmosin atë.

Një shembull tjetër, klonimi... Për shkak të **“vlereve etike”**, rrethi shkencor ende nuk e konsideron të drejtë këtë çështje. Por dikush nga krahu tjetër, duke vënë në lëvizje vlerat etike personale, mund ta legalizojë manipulimin me fatin e njerëzimit.

Feja... Ajo i sjell të gjithë njerëzimit një vlerë mbizotëruese. Feja deklaron se përcaktuesi i këtyre vlerave, është **“Krijuesi”**. Feja ligjëron rregullin

se të gjithë të fuqishmit janë të lidhur pas këtyre vlerave. Pra, Ai është zotëruesi i fuqisë absolute. Pranë fuqisë së Tij, askush dhe asnjë forcë nuk mund të shndërrohet në një Leviathan. Askush nuk ka të drejtë të bëhet Leviathan, qoftë në emër të Tij, qoftë kundër Tij. Ai nuk do që në tokë të ndodhin ngatërresa. Nuk do që njerëzit t'i kalojnë kufijtë. Çdo njeri dhe çdo forcë duhet të qëndrojë brenda **"kufijve hyjnorë"**. Ai që i kalon kufijtë do të përballë me pushtetin hyjnor. Në këtë pikë, një pjesë e dënimit është lënë për në "botën tjetër". **"Ndjenja e përgjegjësive para Allahut"**, është kuadri i edukimit kryesor i të gjitha feve. Por kjo nuk është pengesë për zbatimin e dënimeve brenda kornizës së "kufijve hyjnorë" në këtë botë. Ndërsa, në rastet kur nuk merren fare parasysh kufijtë hyjnorë, formohet një fushë force plotësisht e pakontrolluar, e cila quhet **"tirani"**. Dhe aty ku nuk janë marrë parasysh kufijtë hyjnorë, në çdo kohë kanë ndodhur tirani të papara.

Por, a s'mund të kthehen në përbindështa njerëzit, duke përdorur "kufijtë hyjnorë"? Sigurisht që mund të kthehen në përbindështa. Por edhe lufta me ta, përsëri mund të bëhet duke kujtuar kufijtë hyjnorë. **"Allahu nuk e do tiranin dhe tiraninë!"**

Në fakt, kërkimi i **"vlerave etike"** është kërkimi i fesë.

Njeriu që iku prej shtëpisë së Allahut, pasi u përplas sa andej këndeje, e kuptoi se nuk mund ta vazhdojë jetën e tij kështu i vërvitur në vlera dosido dhe ndjeu nevojën për të disiplinuar vetveten. Dhe për të arritur këtë, në vend që t'u kthehet përsëri burimeve hyjnore, prirret t'i prodhojë vetë vlerat. Ajo të cilën e quajmë **"vlerë etike"**, nuk është gjë tjetër veçse një orientim kah vlerat e përbashkëta të prodhuara nga njeriu.

Në fakt, të ashtuquajturat **"vlera etike"** zënë vend brenda një kuadri më gjithëpërfshirës, p.sh. brenda kritereve hyjnore. Por me kusht që të qëndrojnë të lidhura me vetëdijen e përgjegjësive ndaj Allahut Teala...

Dijetarët islamë e kanë përkufizuar fenë me një shprehje shumë kuptimplote: **"et-Ta'dhim li emril-lah ue'sh - shefkatu ala halkil-lah"**, e cila do të thotë: **"Pranimi dhe respektimi i ligjeve/rregullave të Allahut, si vlerat më të larta dhe mëshirë ndaj krijesave të Allahut"**. Nga një anë, vërejmë një marrëdhënie që e sheh primare **"mëshirën"** ndaj të gjitha krijesave, një sistem shoqëror që ka për parim mëshirën dhe, nga ana tjetër, vërejmë dëshirën që kjo të arrihet me anë të besimit në Allahun, besnikërisë, lidhjes dhe respektit ndaj Tij... Që kontrolli i fuqisë të lidhet me **"pushtetin hyjnor"**... Në historinë islame, parimi që reflektonte rregullin shtetëror ishte ky: **"Mos u mburr o padishah, Allahu është më i madh se ti!"**

Ndërsa Allahu Teala i ka tërhequr vërejtje Pejgamberit tonë (a.s.), me këto fjalë:

"..Ti je vetëm këshillues dhe je i ngarkuar t'i detyrosh ata me forcë!" (Gashije, 21-22.)

Përderisa edhe Pejgamberi (a.s.), nuk mund të jetë **"detyruar"** në marrëdhëniet fe-njeri, as klerikët fetarë nuk mund ta bëjnë një gjë të tillë.

Nëse i referohemi Kuranit Kerim, na bëhet e qartë se **"kthimi në zot i klerikëve fetarë"**, është një devijim i madh nga rruga hyjnore. (shih. et-Teube, 31.) Feja islame u ka vënë kushte të gjitha fushave të forcës jashtë Allahut Teala dhe burimin e lejes së tyre e ka kufizuar me llogarinë që do t'i jepet Allahut Teala. Në bazë të kësaj, çdo forcë është e detyruar të përdoret në atë mënyrë, që të mund të jetë e justifikuar përballë vullnetit hyjnor...

Jemi në një kohë kur mendja e njeriut është shumë e turbullt. Pyetja: **Si do të pastrohet turbullira e mendjes së njeriut?**, ka vetëm një përgjigje:

Duke u mbështetur në hartën e rrugës, që Krijuesi e ka përpiluar për njeriun me anë të Islamit... Nëse do ta shprehim me gjuhën kompjuterike, duke formuar zemrën dhe mendjen... Duke u kapur përsëri pas dorës së Rasulallahut, Muhamed Mustafait sal-lallahu alejhi ue sel-lem...





RRUGA DHE IDEALI YNË

— Saxhid Turker —

Cilat janë qëllimet dhe idealet tona në jetë? Në çfarë gjendjeje jemi tani? Çfarë dëshirojmë të bëhemi në të ardhmen? Po punojmë për të fituar çfarë? Vallë, çfarë do të bëjmë, nëse i fitojmë ato dhe arrijmë qëllimet tona?

Të gjithë natyrisht kanë të drejtë të dëshirojnë të jenë të lumtur në jetë, por shumica e shikojnë paranë dhe pasurinë si mjet të vetëm të lumturisë dhe thonë: “Ah sikur të jemi të pasur...” Sikur të ishin të pasur, do të merrnin shumë gjëra! Vila, makina luksoze, rroba të bukura, unaza, vathë e byzylykë prej diamanti, shërbëtorë, ushqimet më të shijshme... Faktikisht edhe revistat e modës, programet e vipave në fundjavë dhe gazetatat ditore e njoftojnë dhe inkurajojnë popullin për këto.

Por problemet fillojnë të shfaqen që në çështjen e fitimit të parasë, sepse shumë njerëz nuk i japin rëndësi ligjshmërisë së formës së fitimit të parasë, për shkak të lakmisë që kanë ndaj pasurisë. Në këtë mënyrë, ata i shkelin ligjet fetare dhe njerëzore. Bëjnë dredhi, marrin ryshfet, mashtrojnë, vjedhin, uzurpojnë, brengosin të afërmit, lëndojnë, zihen me të tjerët, derdhin gjak, vrasin njerëz... Bëjnë shumë mëkate dhe bien pre e ligjit. Kërkojnë oriz, por humbin edhe bullgurin që kanë në shtëpi. Kërkojnë brirë, por u priten edhe veshët. Kërkojnë lumturinë, por futen në shumë halle.

Atëherë, kur të përpiqemi për të fituar para, duhet të jemi gjakftohtë, nuk duhet të lakmojmë, nuk duhet të adhurojmë materialen dhe duhet

të shfaqim kujdes të veçantë ndaj mënyrës së ligjshme të fitimit. Lumturia e dynjasë dhe e ahiretit, para së gjithash është e lidhur me këtë që thamë më sipër.

Tani le të supozojmë se paranë e kemi fituar në mënyrë të ligjshme dhe se kemi fituar shumë. Atëherë nuk duhet ta teprojmë në harxhim.

GARA E LUKSIT NUK KA FUND

Dihet se diamanti nuk prodhohet në vendin tonë. Ju e dini se gurët e çmuar të diamantit dhe të tjerë si ai, nxirren me padrejtësi shumë të mëdha nga vendet si Afrika e Jugut dhe Afganistani.

Ejani t’u dalim kundër këtyre zbukurimeve të tepërta, artikujve industrialë të kozmetikës, që importohen nga jashtë me një kundërvlerë të madhe, diamanteve, gjërave shtëpiake të ekzagjeruara, perdeve të panevojshme, rafteve të stërmëdha, vazove, kristaleve etj...

Në shtëpinë tonë le të gjenden vetëm gjëra që përputhen me mendjen dhe të dobishme. Maturia dhe modestia le të jetë stolja jonë. Të largohemi nga luksi. Sa të kemi mundësi, le të përdorim mallra dhe artikuj vendorë.

Me pjesën tjetër që na tepron nga paratë, le të fitojmë lumturinë e kësaj bote dhe të botës tjetër, duke ua ndalur lotët të varfërve dhe nevojtarëve, duke ua mbështjellë plagët dhe duke i ndihmuar ta marrin veten materialisht dhe fizikisht.



MËNYRA PËR TË KALUAR FRIKËN DHE SHQETËSIMET

— A. Jasin Demirxhi —

Në asnjë mënyrë s'po shpëtoj dot nga shqetësimet... Vazhdimisht ndjej ngushtim, tmerr dhe kapitje... Vetën e ndjej si një njeri që nuk ka aspak vlerë... Më duket se të gjithë më poshtërojnë dhe më urrejnë.

Këto janë ankesa që shumë prej nesh i dëgjojmë shpesh nga njerëzit që na rrethojnë. Madje, mund të jenë edhe ato që ndiejmë vetë. Edhe pse disa thonë të vërtetën, në shumicën e rasteve këto burojnë nga frika dhe shqetësime të pavend. A është shumë e vështirë për t'i kaluar këto ndjesi negative? Jo. Atëherë, nëse pyesni se cila është mënyra për të shpëtuar nga ato, përgjigja është:

-Së pari, dija mirë vlerën kësaj feje nga e cila ke arritur nderin. Mos iu bind epsheve të tua në çështjen e urdhrave dhe ndalesave të saj. Në këtë mënyrë, do të shohësh se lumturia dhe qetësia do të trokasin vetveti në derën e zemrës tënde dhe Allahu i Madhëruar do të të pëshpërisë këto ajete:

“Sa për atë që jep (për hir të Allahut), ka frikë (nga Ai) dhe dëshmon për vërtetësinë e më të bukurës (besimit), Ne do t’ia lehtësojmë atij rrugën drejt shpëtimit.” (Lejl, 5-7.)

Në marrëdhëniet që ke me arsimimin, punën, familjen dhe shokët e tu, pra, në lidhjet me të gjitha çështjet, do të të hapet dera e lehtësive, të jesh i sigurt për këtë. Sa më shumë t’i afrosh Allahut Teala me ibadet dhe bindje, aq më shumë do të të rregullohen marrëdhëniet me njerëzit. Në këtë mënyrë, do të fitosh këtë botë dhe botën tjetër.

Pastaj duhet të kesh sukses në harmoninë me veten. Duhet t’i besosh vetes. Dhuratën që ta ka paraqitur Allahu i Madhëruar, duhet ta pranosh ashtu siç është. Domethënë, duhet të jesh i kënaqur me formën, natyrën, përmasën dhe familjen tënde. Shkurtimisht, duhet të jesh i kënaqur me çdo gjë që të është dhuruar nga Zoti (xh.xh.), qoftë materiale apo qoftë shpirtërore. Vetën duhet ta pranosh siç je.

Duhet të jesh i singertë në ndjenjat kundrejt të tjerëve. Sillu kundrejt tyre siç dëshiron të sillen ata kundrejt teje. Nuk duhet të harrosh se edhe ata janë njerëz. Mos poshtëro dhe mos nënvlerëso askënd. Përpiqu t'i shohësh të gjithë njerëzit me dashuri. Mos prit që njerëzit të të duan. Përkundrazi, shfaq sjellje që për ta të jenë përktim i dashurisë tënde. Përpiqu të hedhësh hapa pozitivë kundrejt tyre, por mos luaj rol. Dashurinë që ke për njerëzit, tregojua që nuk është me kushte.

Buzëqeshu të gjithëve. Përpiqu të formosh dialogë të singertë me njerëzit. Mundohu të hysh me dashuri në zemrën e tyre. Ndiko te ata me mëshirë dhe mirësjellje. Fitojua zemrat, duke u bërë mirë dhe duke u sjellë modest ndaj tyre. Ja, shiko si Allahu i tregon të Dërguarit të Tij, salallahu alejhi ve selem, edhe neve indirekt, se çfarë rezultatesh pozitive jep afrimi me mëshirë ndaj njerëzve:

“Në sajë të mëshirës së Allahut, u solle butësisht me ta (o Muhammed). Sikur të ishe i ashpër dhe i vrazhdë, ata do të largoheshin prej teje. Prandaj, falua atyre gabimin, kërkoi falje Allahut për ta dhe këshillohu me ata për çështje të ndryshme. Kur të vendosësh për diçka, mbështetu tek Allahu. Vërtet, Allahu i do ata që mbështeten tek Ai.” (Al ‘Imran, 159.)

Vizitoji njerëzit e sëmurë. Ndhimoji të varfrit. Ledhatojua kokën jetimëve. Interesohu për të gjithë një nga një. Përpiqu t'ua fitosh zemrën me dhurata, qofshin edhe të vogla pa vënë re nëse janë të moshuar apo të rinj.

Mos harro, të gjitha këto janë sjellje shumë të rëndësishme që njerëzve dhe ty të sjellin gëzimin, lumturinë dhe qetësinë.

LA TAHZEN MOS U MËRZIT

Mos u mërzit, nëse nuk gjen dot drejtësi në gjykatat e kësaj bote. Gjykatësi Suprem në ahiret është Gjykatësi më i drejtë. Ndërsa engjëjt do të jenë dëshmitarët e tu.

La tahzen / mos u mërzit

Morali i lartë, sjellja fisnike dhe ndershmëria, janë më të mira se pamja e jashtme.

La tahzen / mos u mërzit

Lumturia nuk është e përkohshme dhe mërzia e fatkeqësia nuk janë të përhershme, siç pandehin shumë njerëz.

La tahzen / mos u mërzit

Nëse besimin e ke të fortë, mos u mërzit! Sepse lumturia është si një pemë. Uji, ushqimi, ajri dhe drita e saj, është besimi te Allahu dhe Dita e Gjykimit.

La tahzen / mos u mërzit

Mos harro, buzëqeshja është çelësi i lumturisë. Gëzimi është kopshti i saj, imani është drita dhe besimi është rrethimi i saj.





IMAM AZAMI EBU HANIFE (R.A.)

KAPU FORT PAS DEVOTSHMËRISË!

Imam Azami, Ebu Hanife ishte i njohur për hesh-tjen e gjatë dhe të thellë. Nisur nga ky aspekt, kë-shillat që i ka dhënë janë një reflektim i gjendjes së tij, domethënë i heshtjes së gjatë dhe meditimit të thellë. Andaj këto këshilla të Ebu Hanifes në të njëjtën kohë janë portreti me fjalë i botës së brendshme të tij:


“Dije se, nëse nuk kalon mirë me njerëzit, ata të bëhen armiq. Madje nuk do të të pëlqenin edhe nëse do të ishin nëna apo babai yt. Nëse kalon mirë me njerëz që nuk i ke të afërm, ata mund të të bëhen nënë e baba.”

“Ai që nuk sillet mirë në një vend që duhet të sillet mirë, nuk konsiderohet i mençur.”

“Kur të hysh në Basra, njerëzit të presin dhe të vizitojnë. Pastaj mësoj-në vlerën tënde. Secilin respektojë

sipas gradës së tij. Nderoji njerëzit e ndershëm. Vlerësoji njerëzit e dijes. Shfaq respekt ndaj mje-shtërve. Bëj shaka të këndshme me të rinjtë. Tako-hu nga afër me njerëzit normalë. Shfaq sjellje të mirë ndaj mëkatarëve. Formo shoqëri me njerëz të dobishëm.

Mos shfaq indiferencë ndaj drejtuesve. Mos për-çmo askënd. Mos shfaq mangësi në burrëri dhe mos ia trego sekretin askujt. Mos i beso miqësisë së askujt pa e provuar. Mos u bëj mik me njerëz të





poshtër dhe koprracë. Mos u ushtro me diçka që nuk të pëlqen.

Mos qëndro me të pasionuarit ndaj dëfrimit. Kalo mirë me ta dhe ji i durueshëm. Ji i moralshëm dhe zemërgjerë. Rrobat e tua le të jenë të reja dhe të pastra si zemra jote. Kali yt le të jetë i mirë. Përdor aroma të mira...”

“Ebu Hanife (r.a.), ka thënë: “Nëse nuk kalon mirë me njerëzit, ata të bëhen armiq. Madje nuk do të të pëlqenin edhe nëse do të ishin nëna apo babai yt. Nëse kalon mirë me njerëz që nuk i ke të afërm, ata mund të të bëhen nënë e baba.”

“Ji shumë bujar në dhënien e ushqimit dhe ushqejti të gjithë. Dije se njeriu koprrac dhe dorështrënguar kurrë nuk mund të kalojë në krye dhe nuk mund të bëhet zotëri.”

“Vizitoji edhe ata që të vizitojnë, edhe ata që nuk të vizitojnë.

Ti bëju mirë të gjithëve edhe nëse ata të bëjnë mirë apo të bëjnë keq. Gjithmonë bëj mirë. Fal dhe mbylli sytë ndaj disa gjërave.

Lëre atë gjë që të mundon dhe përpiku t’i përmahesh të vërtetës.”

“Mos u propozoj njerëzve diçka me të cilën nuk janë mësuar! Pëlqeje edhe ti atë gjë që e pëlqejnë ata. Gjithmonë ki qëllim të mirë ndaj tyre dhe ji i drejtë. Mendjemadhësinë lëre në një anë. Mos mashtro edhe nëse të mashtrojnë. Edhe nëse ata të tradhetojnë, ti prapë se prapë mbaje amanetin. Gjithmonë ji besnik!

Kapu fort pas devotshmërisë!”

“Ebu Hanife (r.a.), ka thënë: “Ai që nuk sillet mirë aty ku duhet të sillet mirë, nuk konsiderohet i mençur.”

Zgjuarsia e jashtëzakonshme e Imam Azamit e cila i vë pikën thelbit të të gjitha këshillave me sugjerimin “Kapu fort pas devotshmërisë”, fuqia e madhe e imagjinatës së tij, frymëzimi i tij që i ka bërë të heshtin femohuesit dhe ata që janë zhytur në mendime e besime të devijuara dhe fuqia e jashtëzakonshme e tij për t’u shprehur, gjithmonë ishin të gatshme për të dhënë përpjekjen dhe për t’i shërbyer kapjes pas devotshmërisë, sepse ai pati marrë edukim nga sahabët.

EDUKIMI I SAHABËVE

Allahu i Lartësuar e edukoi vetë Krenarinë e Gjithësisë, të Nderuarin tonë (a.s.) dhe e pajisi atë

me edukatën dhe moralin më të lartë. Pastaj atë ia dhuroi njerëzimit si mësuesi dhe edukatori më i madh.

Resulullahu, paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të, nga një popull që gjendej në errësirat e shirkut, injorancës dhe padrejtësisë, edukoi sahabët e nderuar të cilët shkëlqyen si yje me dritën e besimit, ibadetit dhe sinqeritetit. Këta njerëz të mëdhenj që secili prej tyre ishte hero i besimit, dijes, sinqeritetit, devotshmërisë, asketizmit, besnikërisë, etj., cilësinë e edukimit e morën në formën më të mirë nga i Dërguari i Allahut (a.s.). Ata rendën në të katër anët e botës për të shërbyer, predikuar, luftuar, mësuar dhe edukuar. Në vendet që shkonin, formonin hallka dhe edukuan nxënës të mbushur plot e përplot me dashuri edhe prej robërve që u falnin lirinë, edhe prej të tjerëve. Në këtë mënyrë u edukuan breza të zgjedhur të cilët kujtohen me emrin tabiin dhe pas tyre teba tabiin.

Kështu;

U edukuan shumë dijetarë dhe njerëz të urtë që ecnin me sinqeritet dhe devotshmëri në rrugën e dijes dhe urtësisë, që mund t’i lexonin të fshehtat dhe urtësitë të cilat Allahu Teala i ka vendosur në gjithësi, në Kuran dhe te njeriu dhe që punonin me dijen e ishin të përsosur me urtësinë e tyre. Shkencat islame u mblodhën prej muhadithëve, fakihëve, mufesirëve dhe imamllarëve dhe u formuan medhhebet e besimit dhe jurisprudencës. Në çdo vend dhe qytet u ndërtuan institucionet e dijes dhe urtësisë.

I Dërguari i Allahut (a.s.), disa çështje i la në vizionin dhe përkushtimin e sahabëve që i kishte edukuar vetë siç ndodhi në çështjen e mbledhjes së Kuranit Fisnik dhe çështjen e kalifatit. Prej këtyre brezave që u zhvilluan me edukimin e dashurisë dhe largpamësisë profetike, u gjetën rregullat më efikase dhe u formuan bazat më të forta në fushën e dijes, urtësisë dhe praktikës së Islamit.

“Ebu Hanife (r.a.), ka thënë: “Të gjithë vlerësoji sipas gradës së tyre. Nderoi njerëzit fisnikë. Vlerësoji njerëzit e dijes. Shfaq respekt ndaj mjeshtërvë. Bëj shaka të këndshme me të rinjtë. Takohu nga afër me njerëzit e zakonshëm.”

Ne elhamdulillah i kemi gjetur të gatshme bazat e dëlira dhe të forta të besimit, jurisprudencës dhe moralit me parimet dhe rregullat që i kanë vendosur ata dijetarë. Për shekuj me radhë lutjet e umetit të

Muhamedit dhe sevapet e marra nga ibadetet që kryhen në formë të bukur e të rregullt, u shkruhen si lëmoshë rrjedhëse këtyre figurave të mëdha në defterin e veprave të tyre...

SA FITIM I MADH!

Ja pra, edhe njëri që e ka arritur këtë fitim të madh ishte Abdullah ibn Mes'udi (r.a.)...

Abdullah ibn Mes'udi (r.a.), ndërkohë që ishte një bari devesh në kohën e xhahilijetit, (pas ardhjes së Islamit) arriti pikën kulmore të dijes e urtësisë me pjekurinë shpirtërore ngaqë u edukua me frymëzimin dhe përsëritshmërinë e Kuranit Fisnik duke marrë mësim plot frymëzim e spiritualitet nga i Dërguari i Allahut (a.s.). Ndërsa pasi ndërroi jetë Pejgamberi, hodhi themelet e njëres prej shkollave më të mëdha të jurisprudencës të së ardhmes në Kufe ku ishte vendosur për të predikuar Islamin dhe për t'ua mësuar atë të tjerëve.

“Ebu Hanife (r.a.), ka thënë: “Formo shoqëri me njerëzit e mirë. Mos u shfaq indiferent ndaj drejtuesve. Mos nënçmo askënd. Mos shfaq mangësi në burrëri dhe mos ia trego sekretin askujt!”

Shkolla e Kufes në të njëjtën kohë u bë edhe qendra e kalifatit të Aliut i cili ishte dera e qytetit të dijes.

Me begatinë e të Nderuarit tonë (a.s.) dhe të të sahabëve të nderuar, në këtë shkollë u edukua juristi më i madh i botës, Imam Azami Ebu Hanife. Ai u edukua në mënyrë aq të mirëfilltë saqë Soloni dhe Hamurabi të cilët janë juristë të njohur botërisht, mund të jenë vetëm çirakë të Ebu Hanifes.

Imam Azami (r.a.), i cili lindi dhe u edukua në Kufe, ishte biri i Thabitit, i cili ishte një baba i devotshëm që u takua me Aliun e që mori lutje prej tij për brezin e vet dhe që preokupohej me tregti. Ebu Hanife e mësoi përmendësh Kuranin Fisnik që në moshë të re. Ndërkohë që preokupohej me tregti, frekuentonte edhe hallkat e dijes në xhaminë e Kufes. Ai fitoi një aftësi dhe perceptim të thellë së pari në Kalam dhe pastaj në shkencën e jurisprudencës islame.

Pasi ndërroi jetë hoxha i tij, Hammadi, dha mësim në katedrën e tij deri në fund të jetës së vet. Ai edukoi nxënës dhe i zgjidhi problemet e hallet e njerëzve.

Nga ana tjetër, falë bashkëpunëtorit të tij besnik, me fitimet që siguronte nga aktivitetet e tregtisë bëri dhurime të madhe e bujare ndaj nevojtarëve duke filluar me në krye nxënësit.

Imami i madh krahas këtyre preokupimeve dhe përgjegjësisë të rënda, edhe në çështjen e ibadetit bëri një jetë si një adhurues i përkushtuar. Ai ishte një dijetar i vërtetë edhe në çështjen e shkencës.

Ebu Hanife arriti pikën kulmore në shkencat ekzoterike dhe ishte një gjeni në zgjuarsin dhe largpamësin. Edhe në fushën e përsëritshmërisë përfitoi nga ligjëratat e Xhafer es-Sadik.

“Ebu Hanife (r.a.), ka thënë: “Mos i beso miqësisë së askujt pa e provuar. Mos u bëj mik me njerëz të poshtër dhe koprracë. Mos u ushtro me diçka që nuk të pëlqen. Mos qëndro me mëkatarët.”

Sa bukur e shpreh kjo ngjarje respektin që ai shfaqte ndaj njerëzve të fesë:

Siç tregohet, një ditë Ibrahim ibn Ed'hemi, i cili ishte prej miqve të Zotit, po kalonte nga Imam Azami. Ata që ndodheshin përreth Ebu Hanifes e shikuan në një formë të çuditshme dhe nënvlerësuese Ibrahim ibn Ed'hemin. Imam Azami (r.a.), e pa këtë situatë dhe i thirri Ibrahim ibn Ed'hemit:

“Urdhëroni efendi! Na nderoni me pjesëmarrjen tuaj në kuvendin tonë!”

Ibrahim ibn Ed'hemi dha selam në një mënyrë modeste dhe kaloi.

Ata që gjendeshin aty e pyetën Imam Azamin:

“Në ç'aspekt e meriton ky njeri i mjerë cilësinë efendi dhe fisnikërinë? Si mund t'i thotë “efendi” atij një njeri si ti?”

Nisur nga kjo pyetje, Imam Azami dha këtë përgjigje modeste:

“Ai vazhdimisht është i preokupuar me Allahun, ndërsa ne jemi të preokupuar më aparençës e çështjes...”

Imam Azami, krahas dijes së gjerë që posedonte;

ISHTE IMAM EDHE ME IBADETIN E TIJ

“Ebu Hanife (r.a.), ka thënë: “Kalo mirë me njerëzit dhe ji i durueshëm. Ji i moralshëm dhe zemërgjerë. Rrobat e tua le të jenë të reja dhe të pastra si zemra jote. Kali yt le të jetë i mirë. Përdor aroma të mira...”

Imam Azami sipas transmetimeve ka shkruar dyzet apo pesëdhjetë e pesë herë në haxh përgjatë jetës së tij. Ai e kalonte pothuajse të gjithë natën duke bërë ibadet. Kishte një mallëngjim të madh edhe në lidhje me çështjen e leximit të Kuranit Fisnik. Transmetohet se kishte net kur e bënte hatme Kuranin Fisnik në dy reketë dhe se e bënte hatme disa herë përgjatë Ramazanit.

Kur lexonte Kuran qante me zë të lartë. Një natë kur përgjatë namazit kishte arritur te ajeti:

“*Allahu na ka dhuruar mëshirë dhe na ka ruajtur nga era përcëlluese* (e Zjarrit).” (Tur, 27), kishte ndërjerë keqardhje dhe e kishte përsëritur këtë ajet duke qarë me ngashërim derisa myezini kishte thirrur ezanin e mëngjesit.

Edhe një natë tjetër në namaz e kishte gdhirë duke e përsëritur në të njëjtën mënyrë ajetin:

“Madje, Ora (e Kiametit) do të jetë takimi i tyre dhe Ora do të jetë më e tmerrshme dhe më e hidhët.” (Kamer, 46)

Ibadeti ishte një prehje dhe kënaqësi për të. Kur një çështje e jurisprudencës islame bëhej e vështirë për t’u zgjidhur, kur tekstet dhe mendja nuk ishin të mjaftueshme, thoshte:

“Kjo çështje nuk po zgjidhet për shkak të ndonjë mëkati që ka bërë Ebu Hanife.” Andaj menjëherë bënte istigfar, merrte abdest të ri dhe falte dy rekatë namaz me përkushtim dhe prehje shpirtërore. Kështu çështja zgjidhej menjëherë.

Kur Imam Azami i jepte fetva popullit, vepronte sipas parimeve të lehtësimit dhe lejimit të fesë sonë. Ndërsa për veten e tij zgjidhte devotshmërinë. Shumë shkrime të tij në lidhje me devotshmërinë dhe veranë, domethënë në lidhje me çështjen e largimit nga harami, kanë arritur deri te ne.

Një herë kur po pastronte një papastërti shumë të vogël në rrobën e vet, ata që e panë e pyetën:

“O Imam! Kjo njollë e vogël nuk është një papastërti që përbën pengesë për namazin sipas fetvasë që keni dhënë. Përse mundoheni dhe përpiqeni për ta hequr atë?”

Imam Azami u tha:

“Ajo është fetva, ndërsa kjo është tavka (devotshmëri)!..”

“Një natë kur Ebu Hanife (r.a.), po falte namaz dhe arriti te ajeti: **“Allahu na ka dhuruar mëshirë dhe na ka ruajtur nga era përcëlluese** (e Zjarrit).” (Tur, 27), u emocionua dhe e përsëriti këtë ajet duke qarë me ngashërim deri në ezanin e mëngjesit.”

Imam Azami (r.a.), thoshte duke e konsideruar këtë si një domosdoshmëri e të qenët njeri i dijes së vërtetë:

“Dijetari e ka të nevojshme që ta ngarkojë veten me përgjegjësi më shumë sesa u thotë njerëzve.”

Kështu;

Edhe pse gjendej nën diellin përvëlues, nuk hyri nën hijen e murit të një personi që i kishte borxh atij. Ai e konsideronte si një lloj kamate përfitim nga muri i shtëpisë së borxhliut. Ndërkohë një

veprim të tillë nuk e konsideronte vaxhib për sa i përkiste jurisprudencës.

Përsëri;

Kur dëgjoi se një dele e vjedhur ishte përzier me delet e Kufes, nuk hëngri mish deleje për shtatë vjet radhazi aq sa është jeta e një deleje.

“Ebu Hanife (r.a.), u tha atyre që e pyetën për urtësinë e shfaqjes së respektit ndaj Ibrahim ibn Ed’hemit: “Ai gjithmonë preokupohet me Allahun. Ndërsa ne preokupohemi me aspektin e jashtëm të kësaj çështjeje...”

Ai këtë përpikëri e vazhdoi edhe me testamentin e tij. Andaj e la me testament që të mos varrosej në varrezat Hajzuran, vend i cili ishte bërë varrezë me uzurpim, por të varrosej në një tokë që ishte hallall.

Imam Azami këtë përpikëri e mbartte dhe e ndjente në mënyrë të sinqertë. Kjo sjellje e përpiktë dhe e sinqertë, në të njëjtën kohë të mahniste dhe ishte përhapje e përkryer e një personaliteti të shkëlqyer prej besimtarit.

Kjo histori është një prej shembujve më të bukur në lidhje me këtë:

PËRPIKËRIA QË E MAHNITI ADHURUESIN E ZJARRIT

Transmetohet se;


Imam Azami Ebu Hanife (r.a.), kishte mall te një adhurues zjarri. Ai shkoi te shtëpia e adhuruesit të zjarrit për ta kërkuar mallin. Kur shkoi te dera e shtëpisë, në këpucë iu

ngjiti një papastërti. Ai e shkundi këpucën për ta hequr atë. Por papastërtia shkoi e ra në murin e adhuruesit të zjarrit. Imami nuk dinte çfarë të bënte, sepse nëse do ta gdhendte murin për ta hequr papastërtinë, do të dëmtonte suvanë e murit. Nëse do ta linte, do të kishte shkelur një të drejtë njerëzore duke ndotur murin. Andaj trokiti në derë dhe e pyeti pronarin e murit se çfarë të bënte. Shërbëtorit që e hapi derën i tha:

“Njoftoje zotërinë tënde se Ebu Hanife po e pret te dera!”

Burri doli te dera dhe filloi të kërkonte ndjesë nga Ebu Hanife duke menduar se do t’i kërkonte mallin.

Ndërsa Imam Azami (r.a.), i tha:



“Tani për tani kjo nuk është e rëndësishme.” Kështu që i tregoi për gjendjen e murit dhe e pyeti:

“Më thuaj, si mund ta pastroj këtë mur?”

Adhuresi i zjarrit u emocionua kundrejt kësaj përpikërie e korrektesie dhe i tha:

“Unë së pari po ia filloj punës duke pastruar veten time!” Kështu që u bë mysliman në atë moment.

“Imam Azami, Ebu Hanife nuk merrte fitim prej klientit nëse ai ishte ndonjë i varfër apo ndonjë i dashur i tij. Por ia jepte mallin me çmimin që e kishte marrë. Madje kishte raste kur ia falte klientit një pjesë të fitimit.”

Ebu Hanife (r.a.), i cili përjetoi një devotshmëri kaq të lartë dhe madhështore në jetën e tij personale, e perceptoi shumë mirë edhe përgjegjësinë e dhënies së fetvasë dhe e të qenët imam, domethënë prijës. Sa mësimdhënëse që është edhe kjo ngjarje që ia shtoi atij edhe më shumë përpikërinë në lidhje me këtë çështje:

POR NËSE RRËZOHESH TI!

Një ditë Ebu Hanife pa një fëmijë që po ecte në baltë. Atij i buzëqeshi me mëshirë e butësi dhe i tha:

“Bir! Bëj kujdes, në mënyrë që të mos rrëzohesh!”

Fëmija me sytë që i shkëlqenin nga zgjuarsia dhe largpamësia, u kthye nga Imami dhe i dha këtë përgjigje shumë të urtë që nuk pritet prej një fëmije:

“O Imam! Rënia ime është e lehtë. Nëse rrëzohem, dëmtohem vetëm unë. Andaj bëni kujdes ju, sepse nëse ju rrëshqet këmba dhe rrëzoheni, do t’ju rrëshqasë këmba edhe atyre që ju ndjekin dhe ju vijnë pas. Nëse rrëzohen të gjithë ata, është shumë e vështirë për t’i ngritur të gjithë.”

Imami u mahnit nga fjalët e fëmijës, filloi të qante dhe u bëri këtë paralajmërim nxënësve të tij:

“Nëse ju vjen ndonjë argument më i fortë në ndonjë çështje, mos më pasoni mua në atë çështje. Kjo është shenja e përsosmërisë në Islam. Vetëm në këtë mënyrë del në pah edhe dashuria dhe besnikëria që keni ndaj meje...”

“Imam Azami, Ebu Hanife u jepte dijetarëve nga

fitimi i tij. Ndërsa natën dërgonte ndihma te shtëpitë e të varfërve.”

Ebu Hanife nuk i pranonte dhuratat dhe detyrat që ia jepnin burrat e shtetit. Ndërsa tregtinë që e kishte marrë si profesion nga babai nganjëherë e ushtronte vetë dhe shumë herë e vazhdonte nëpërmjet ortakut të tij. Ai vepronte me rregulla shumë të përpikta në allishverish.

Edhe në dije, edhe në jetë;

NDERSHMËRIA ISHTE CILËSIA E PANDASHME E TIJ

Një ditë një grua e shkretë i kishte sjellë Imam Azamit, Ebu Hanifes një robë mëndafshi për ta shitur. Imam Azami e pyeti se sa e shiste. Gruaja i tha:

“Njëqind dërhëmë!”

Ebu Hanife (r.a.), kundërshtoi dhe i tha:

“Jo, kjo bën më shumë.”

Gruaja që nuk e njihte shumë dijetarin e madh, u habit. Ajo i shtoi edhe njëqind dërhëmë. Imam Azami përsëri nuk pranoi. Gruaja shtoi edhe njëqind dërhëmë. Pastaj shtoi edhe njëqind dërhëmë të tjerë...

Ebu Hanife përsëri i tha:

“Jo, kjo kushton më shumë edhe se katërqind dërhëmë.” Kur grua i dëgjoi këto fjalë, nuk e mbajti dot veten pa i thënë:

“O Imam! A po bëni shaka me mua?”

Nisur nga kjo, Imami thirrri dikë që merrte vesh nga kjo punë. Personi që erdhi e caktoi çmimin pesëqind dërhëmë dhe Imam Azami e

bleu atë me këtë çmim. (Ibn Haxher Hejtemi, Hajratu’l-Hisan, fq. 44.)

“Ebu Hanife (r.a.), kishte një fqinj të varur ndaj alkoolit. Kur ky i ri ra në burg, Imami shkoi te burgu dhe kërkoi të lihej i lirë. Ai i kërkoi ndjesë të riut. I riu u pendua.”

Sa bukur e shfaqti Imam Azami korrektesinë ndaj “të drejtës njerëzore” e cila është domosdoshmëri e moralit të Islamit duke mos shfaqur ndaj asaj gruas mungesë të ndërgjegjes dhe duke mos thënë: “E bleva më çmimin që më dha vetë. Çfarëdo që mund të zhvat prej klientit është qar.”

*“Imam Azami,
Ebu Hanife nuk merrte
fitim prej klientit nëse
ai ishte ndonjë i varfër
apo ndonjë i dashur i tij.
Por ia jepte mallin me
çmimin që e kishte marrë.
Madje kishte raste kur ia
falte klientit një pjesë
të fitimit.”*

“A nuk do të ishte krejt tjetër gjendja e shoqërisë sonë nëse do të arrinim t’i shikonim si fëmijët tanë dhe me vetëdijen e Imam Azamit fëmijët e alkoolizuar që janë lënë në ndërgjegjen e rrugëve, të rinjtë që përdorin drogë dhe të vetmuarit nëpër jetimore?”

Ebu Hanife edhe tregtinë që e vazhdonte nëpërmjet bashkëpunëtorit të tij, e kontrollonte nëse ishte apo jo prej hallallit. Në këtë çështje ishte aq i përpiktë saqë një herë kur e dërgoi ortakun e tij, Hafs ibn Abdurrahmanin për të shitur copë, i tha:

“O Hafs! Malli ka këto e këto mangësi. Për këtë arsye tregoja ato klientit dhe shite kaq lirë!”

Hafsi e shiti mallin me çmimin që i tha Imami, por harroi t’i tregonte klientit për mangësinë që kishte copa.

Kur Ebu Hanife e dëgjoi këtë, e pyeti Hafs ibn Abdurrahmanin:

“A e njeh klientin që ka blerë copën?”

Pasi Hafsi nuk iu kujtonte klienti, Ebu Hanife (r.a.), e shpërndau si lëmshë të gjithë fitimin e marrë nga malli i shitur duke u shqetësuar se mos do t’i njollosej fitimi hallall. Kjo devotshmëri i solli begati të madhe tregtisë së tij materiale dhe shpirtërore.

Imam Azami, Ebu Hanife, ndershmëria e të cilit ishte bërë legjendë në gojën e njerëzve, nëse klienti i tij ishte ndonjë i varfër apo ndonjë i dashur, nuk merrte fitim prej tij. Mallin ia jepte me çmimin që e merrte. Madje kishte raste kur ua falte klientëve një pjesë të fitimit. Ai u jepte dijetarëve prej fitimit të tij dhe natën dërgonte ndihma te shtëpitë e të varfërve.

Ebu Hanife (r.a.), e konsideronte veten përgjegjës jo vetëm ndaj varfërisë materiale, por edhe për të gjetur zgjidhje për gjendjen shpirtërore. Zembrën e tij e kishte shndërruar në një vend ku ata (njerëzit) gjenin prehje.

Sa shembull i bukur është kjo histori e një të riu të varur ndaj alkoolit dhe që ishte fqinj i tij:

NË FAKT, TI MA BËJ HALLALL MUA!

Ky djalë i ri pinte alkool nga mëngjesi deri në mbrëmje. Përgjatë natës ndjehej keq dhe bërtiste me të madhe. Ai ofendonte dhe në këtë mënyrë i shqetësonte fqinjët përreth.

Një natë u ndërpre në britmat e këtij të riu. Imami me një mëshirë të pasqurë pyeti: “Mos vallë i ka ndodhur ndonjë gjë të riut?” Shokët i thanë se i riu ishte futur në burg për shkak të ngatërresës që kishte bërë prej alkoolit.

Ebu Hanife u mërzi shumë për këtë situatë. Andaj shkoi te burgu dhe u kërkoi autoriteteve që ta linin të lirë. Kur autoritetet i thanë se mund ta linin të

lirë vetëm me dorëzani, Imam Azami u bë dorëzanë (qefil) dhe e shpëtoi nga burgu fqinjin e tij të varur ndaj alkoolit.

“Ebu Hanife (r.a.), ka thënë: “Ji shumë bujar në të ushqyerit e të tjerëve. Ushqejti të gjithë. Dije se njeriu koprrac dhe dorështrënguar nuk mund të kalojë në krye dhe të bëhet zotëri.”

Kur i riu e dëgjoi atë që kishte ndodhur, menjëherë shkoi te Imami dhe u pendua me lot në sy. Atij i tha se tashmë ishte penduar dhe se nuk do të pinte më alkool. Pastaj i dha fjalën se do të bëhej një fqinj dhe nxënës i mirëfilltë për të. Imami i madh e pa të riun me mëshirë dhe i tha me një zë të pikëlluar:

“Djalosh! Siç e shikon, ne jemi bërë shkaktarë për humbjen tënde! Nuk u përpoqëm që të të ndihmonim. Në fakt, ti na e bëj hallall ne!”

Sa shembull i bukur për mosngatërrimin e urrejtjes që duhet ta ndjejmë kundrejt mëkatit me dhembshurinë dhe mëshirën që duhet ta ndjejmë ndaj mëkatarit!

“Ebu Hanife (r.a.), ka thënë: “Vizitoji edhe ata që të vizitojnë, edhe ata që nuk të vizitojnë!.. Ti gjithmonë bëju mirë të gjithëve, edhe nëse ata të bëjnë mirë apo keq. Gjithmonë bëj mirë dhe fall!..”

Sa shumë kemi nevojë që ta konceptojmë në mënyrën më të mirë këtë vetëdije të Imam Azamit dhe ta praktikojmë në jetë! A nuk do të ishte krejt tjetër gjendja e shoqërisë sonë nëse do t’i konsideronim si fëmijët tanë të rinjtë e alkoolizuar që janë lënë në dorë të ndërgjegjes së rrugës, që përdorin drogë dhe që janë në humbje?

Për këtë neve na duhet;

PJEKURIA SHPIRTËRORE!

Davud Tai (k.s.), e ka shpjeguar si më poshtë edukatën e pasqurë të Imam Azamit:

“Njëzet vjet kam qëndruar bashkë me Ebu Hanifen. Përgjatë kësaj kohe e vështrova me kujdes. Asnjëherë nuk e kam parë t’i shtrijë këmbët me qëllim për të pushuar as kur ishte vetëm, as kur kishte ndonjë pranë. Atij i thashë:

“Përse nuk i shtrin këmbët kur je vetëm?”

Ai ma ktheu:

“Është më mirë të qëndroj me edukatë para Allahut Teala.”

Sa bukur që e shpreh kjo ngjarje pjekurinë shpirtërore që e kishte arritur Imam Azami falë bisedave fetare që bënte me sejidët e nderuar, ibadetit të sinqertë, devotshmërisë së madhe dhe rregullave sublime të edukatës, domethënë falë dijes dhe vepërave të tij:

Ebu Hanife (r.a.), pa një të ri që po merrte ab-

dest. Atij i tha në një formë të fshehtë që të mos e turpëronte:

“Bir! Mos e bëj këtë e këtë gabim!”

I riu e pyeti i mahnitur:

“O Imam! Nga e dini se i bëj këto gabime?” Ebu Hanife i tha:

“Nga uji që derdhet prej gjymtyrëve të tua!”

Kjo intuitë dhe largpamësi ishte begatia e kthimit të kurrizit që ai i kishte bërë kësaj bote. Ai me këtë intuitë dhe largpamësi u bë një personalitet që e mbrojti dinjitetin e dijes dhe urtësisë përgjatë gjithë jetës.

NUK E BËRI DJEN VEGËL TË PADREJTËSISË...

“Ebu Hanife (r.a.), ka thënë: “Mos u propozoj njerëzve diçka të cilën nuk janë mësuar ta bëjnë. Pëlqejnë edhe ti atë që pëlqejnë ata. Gjithmonë shfaq nijet të mirë ndaj tyre.”

Imam Azami, Ebu Hanife ka jetuar në një vend ku gjendeshin shumë sekte të humbura si harixhitë dhe rafiditë dhe në një periudhë kur po rrezohej shteti Emevi e po formohej shteti Abbasi. Disa politikanë të cilët dëshironin ta forconin pushtetin e tyre me influencën e dijetarëve dhe që synonin t'i përdornin fetvatë e dijetarëve të nderuar si mburojë për veprimet e padrejta, në fillim atij i dërguan shumë dhurata dhe i dhanë shumë privilegje. Imam Azami i refuzoi të gjitha, sepse e dinte se fetvatë e tij do të përdroreshin për keq.

“Ebu Hanife (r.a.), ka thënë: “Lëre mendjemadhësinë mënjane. Mos u nxeh edhe nëse të nxehen. Ti mbaje amanetin edhe nëse të tradhtojnë. Ji besnik dhe kapu fort pas devotshmërisë.”

NJË BURRË I TMERRSHËM

Pasi Imam Azami (r.a.), refuzoi, kalifi Ebu Xhafer Mansuri insistoi. Krahas të gjitha këmbënguljeve, Ebu Hanife i tha:

“Unë nuk mund të bëhem gjykatës i yti.”

Ebu Xhafer Mansuri i tha:

“Do të bëhesh...”

Ebu Hanife përsëri i tha:

“Nuk mund të bëhem!”

Ebu Xhafer Mansuri këtë herë e akuzoi duke i thënë:

“Ti po gënjen!” Atëherë Ebu Hanife (r.a.), i dha këtë përgjigje:

“Nëse më beson kur të them se nuk mund të bëhem, atëherë dije se nuk mund të bëhem. Nëse nuk më beson, domethënë nëse unë gënjej, atëherë nuk mund të bëhet gjykatës një njeri që gënjen. Përfundimisht, në të dyja situatat nuk mund të bëhem gjykatës. Ndërsa alternativë të tretë nuk ka.”

Për shkak të kësaj, Ebu Xhafer Mansuri e futi në burg Ebu Hanifen (r.a.). Ai urdhëroi që të rrihej me kërbaç çdo ditë. Ndërsa nga ana tjetër i dërgonte lajm shpesh herë duke e ftuar që të bëhej gjykatës i Bagdadit, në mënyrë që të përfitonte nga reputacioni i Ebu Hanifes:

“Nëse e pranoni postin e gjykatësit, le të ulet në atë post.”

Ndërsa përgjigja e Imam Azamit ishte kjo:

“Unë më mirë preferoj të qëndroj në burg sesa të jap ndonjë fetva për Ebu Xhafer Mansurin.”

Atë kohë kishte arritur moshën shtatëdhjetë vjeçare. Pasi Ebu Xhafer Mansuri nuk mori ndonjë rezultat çfarëdo që bëri, e nxori nga burgu dhe e mbajti në arrest shtëpie. Pas një kohe imami i madh ia dorëzoi shpirtin të Gjithëmëshirshmit.

Sipas transmetimeve në xhenazen e tij morën pjesë më shumë se një milion njerëz edhe pse kushtet e asaj kohe ishin të vështira. Xhenazja e tij, siç e kishte lënë me fjalë, u varros diku jashtë kufijve të varrezave që i kishte bërë Ebu Xhafer Mansuri duke e uzurpuar tokën.

Kur Ebu Xhaferi e dëgjoi këtë fjalë, tha:

“Kush mund të më falë për Ebu Hanifen edhe kur ishte gjallë, edhe tani që ka ndërruar jetë?”

Ai priti që të shpërndahej i gjithë kallaballëku pas varrimit. Pasi nuk mbeti asnjë, shkoi në hesh-tje në krye të varrit të Imamit. Ai qëndroi në krye

*“Nuk më lëndon
vështirësia e burgut.
Gjithashtu mund t'u
rezistoj edhe kërbaçëve
këtu. Por bëni kujdes dhe
mos ia tregoni nënës sime
këtë gjendje. Brengosjen
e saj nuk mund
ta duroj kurrë.”*

të varrit duke heshtur sikur po i kërkonte ndjesë ngaqë ishte bërë pishman dhe ndjehej i turpëruar e i pikëlluar.

“Ebu Hanife (r.a.), asnjëherë nuk iu bind burrave të shtetit që dëshironin t’ia shfrytëzonin dijen për qëllimet e tyre. Për këtë arsye, u fut në burg dhe u rrah me kërbaç, por prapë se prapë nuk bëri lëshime.”

Edhe vdekja e atij imami të madh ishte një mësim i veçantë personaliteti. Në fakt çdo gjendje e tij ishte e tillë. Edhe kur gjendej në burg, në vend që të shqetësohej për gjendjen e vet, shqetësohej për parimet dhe jurisprudencën e lartë islame.

Ai e kishte llogaritur se një gjendje e tillë do të hapte plagë në zemrën e nënës. Andaj ka thënë:

“Nuk më lëndon vështirësia e burgut. Gjithashtu mund t’u rezistoj edhe kërbaçëve këtu. Por bëni kujdes dhe mos ia tregoni nënës sime këtë gjendje. Brengosjen e saj nuk mund ta duroj kurrë.”

“Ebu Hanife (r.a.), ka thënë: “Nuk më lëndon vështirësia e burgut. Gjithashtu mund t’u rezistoj edhe kërbaçëve këtu. Por bëni kujdes dhe mos ia tregoni nënës sime këtë gjendje. Brengosjen e saj nuk mund ta duroj kurrë.”

Këto fjali janë shumë domethënëse dhe të rra-lla.

PËR GRATË!

Këto shprehje të Imam Azamit tregojnë se mësuesi më influencues që e ka edukuar atë ishte nëna. Nëna ka qenë fuqia më e madhe shpirtërore për atë. Ebu Hanife (r.a.), nga një aspekt e ka arritur pikën kulmore në dije dhe urtësi falë begatisë së të qenët fëmijë i një nëne të bekuar siç përshkruhet në hadithin fisnik:

“*Xheneti është nën këmbët e nënës.*” (Nesai, Xhihad, 6.)

Në fakt;

Nëse i hedhim një sy historisë, do të shohim se pas njerëzve dhe luftëtarëve të mëdhenj gjithmonë gjendet një grua e devotshme.

Kështu ka qenë edhe nëna jonë, Hatixhja për të Dërguarin e Allahut (a.s.).

Për këtë arsye, vitin kur ka ndërruar jetë nëna jonë, Hatixhja (r.anha), Resulullahu (a.s.), e ka quajtur:

“Viti i pikëllimit...”

Mbi të gjitha ka thënë:

“*Mua më janë bërë të dashura tri gjëra nga kjo botë:*

- *Aroma e mirë,*
- *Namazi, i cili është drita e syve të mi dhe*

• *Gruaja e devotshme.*” (Nesai, Isheratu’n-Nisa, 10.)

Sepse, nëse gratë janë të devotshme, bëhen shkak që i gjithë njerëzimi të jetë i devotshëm.

Ja pra, edhe personalitetin e lartë të Imam Azamit e ndërtoi një nënë e tillë e devotshme.

Për këtë arsye, Imami besnik është përpëlitur si një zog me krah të thyer në kushte të vështira, në mënyrë që nëna e tij të mos mërzhitej.

Domethënë;

Cilësia “Azam” që e ka marrë në të qenët imam, nuk është vetëm për shkak të dijes së madhe dhe të thellë, por për shkak të këtyre virtyteve dhe moralit të lartë.

“Imam Azamin e panë duke pastruar nga rroba e vet një papastërti të vogël për të cilën kishte dhënë fetva se nuk ishte pengesë për namazin. Andaj e pyetën për urtësinë e tij veprimi: Imami u tha: “Ajo është fetva, ndërsa kjo është takva (devotshmëri)!..”

Për këtë arsye;

Nxënësit e tij të cilët u edukuan duke u mbujtur me këto virtyte dhe moral të lartë përgjatë mësimit që u jepte ai, e përfaqësuan atë në të gjithë botën islame duke u përhapur në të katër anët e dynjasë. Frymën e tij e shpien në çdo anë.

Domethënë Allahu i Lartësuar e bëri shkak në një formë të veçantë edhe Imam Azamin për përhapjen e dritës sublime të Tij.

Përfundimisht;

Falë sinqeritetit, dëlirësisë dhe devotshmërisë së tij, u edukuan me mijëra dijetarë në rrugën e mrekullueshme që hapi ai. Medhhebi Hanefi që u themelua nga nxënësit e tij, është një prej shkollave të jurisprudencës islame që ka më shumë pasues.

“Imam Azami (r.a.), ka thënë:

“Dijetari ka nevojë që t’i japë përgjegjësi vetes më shumë se ajo që i thotë popullit.”

Allahu i Madhëruar na bëftë të gjithëve që punojnë me dijen brenda rregullave të devotshmërisë, që vazhdojnë t’i shërbejnë Islamit me të gjitha mundësitë dhe që e kalojnë natën me ibadet e ditën me dije e shërbim fetar!

Na bëftë të gjithëve prej grupit të atyre robërve që e kalojnë të gjithë jetën sipas revelatës hyjnore dhe traditës profetike duke i bashkuar krahët e dukshëm e të padukshëm të dijes dhe duke i kuptuar Kuranin e Hadithin Fisnik në përputhje me vullnetin hyjnor!

Amin!..



MBAJTJA E AMANETIT

— Ali Riza Temel —

Një njeri, të cilit mund t'i jepet me gjithë qetësinë e zemrës diçka materiale apo shpirtërore si amanet, është një njeri i sigurt dhe që mund t'i besohet. Amanet, siç quhet arma e njeriut të besueshëm, i thuhet edhe asaj gjëje që i jepet dikujt për ta mbrojtur përkohësisht.

E vetmja gjallesë që e mbart amanetin / përgjegjësinë hyjnore është njeriu. Nisur nga ky aspekt, njeriu është mëkëmbësi i Allahut Teala në tokë. Sundimi dhe autoriteti i njeriut mbi gjallesat e tjera buron nga kjo. Përderisa njerëzit t'i kryejnë përgjegjësitë që kanë, qoftë kundrejt Allahut apo qoftë kundrejt krijesave të tjera dhe përderisa t'i mbajnë me përpikëri amanetet, do të jenë të nderuar te Allahu Teala dhe te robërit e Tij.

Çdo gjë që ka njeriu është në dispozitën e amanetit që i është dhënë përkohësisht. Organet e trupit, pasuria, familja, pozita etj., të gjitha janë amanete.

E kundërta e amanetit është tradhtia. Tradhtia është cilësi e hipokritëve. Ndërsa cilësia e besimtarëve është mbajtja e amaneteve. Allahu Teala thotë në Kuranin Fisnik: “(Besimtarët janë ata) **të cilët u përmbahen amaneteve dhe detyrimeve të marra.**” (Mu'minun, 8)

I Dërguari i Allahut (a.s.), e ka shprehur kështu pandashmërinë e besimit nga amaneti: “Njeriu që nuk mban amanetin, nuk ka besim.” (Ahmed bin Hanbel, Musned, 3/135.)

Mbajtja e amanetit është prej cilësive më të rëndësishme të pejgamberëve. Shpallja, e cila është mesazhi hyjnor, është amaneti më i rëndësishëm. Një amanet i tillë nuk u jepet njerëzve të zakonshëm. Engjëlli që ua çon shpalljen pejgamberëve është Xhebrilu'l-Emin, ndërsa pejgamberi të cilit i është dhënë shpallja është Muhammedu'l-Emin. Njeriu më i besueshëm në Mekë ishte i Dërguari i Allahut

(a.s.). Edhe armiqtë e tij madje i thoshin “Muhamedi i besueshëm”. Edhe pse nuk e donin, gjërat e tyre të vlefshme ia linin amanet atij. Sikur të mos ishte i besueshëm, nuk mund të ishte bindës. Sikur njerëzit të shikonin te ai gënjeshtër apo tradhtinë më të vogël, nuk do të kishte asnjë pasues. Miliarda pasues të tij që kanë ardhur në këtë botë, janë fryt i besnikërisë së tij, sepse gënjeshtria dhe tradhtia nuk janë bindëse përgjithmonë.

I Dërguari i Allahut (a.s.), gjithmonë është sjellë me ndershmëri ndaj miqve dhe armiqve të tij. Në sajë të kësaj, është bërë shembull i besueshmërisë dhe mbajtjes së amanetit. Kur armiqtë e tij e detyruan atë dhe besimtarët e tjerë për të dalë nga Meka, ai la Aliun (r.a.) pas për t’ua kthyer armiqve amanetet e tyre. Si rezultat, amanetet u dorëzuan te të zotët e tyre.

Tani le të japim edhe një shembull tjetër në lidhje me përpikërinë e të Dërguarit të Allahut (a.s.), në çështjen e mbajtjes së amanetit: Hajberi ishte një qendër çifute banimi, i cili gjendej 150 km në veri të Medinetu’l-Munevvere. I Dërguari i Allahut (a.s.), e çliroi atë në vitin e shtatë hixhri. Urve bin Zubejri transmeton se përgjatë luftës, erdhi një skllav i zi nga Hajberi. Ai po kulloste delet e zotërisë së tij. Kur ai pa se njerëzit e Hajberit ishin armatosur, pyeti për shkakun e kësaj armatosjeje. Ata i thanë se do të luftonin me Muhamedin, i cili pohonte se ishte peygamber. Skllavit i lindi një dëshirë e zjarrtë në zemër për ta njohur të Dërguarin e Allahut (a.s.). Për këtë arsye, i vuri përpara delet që po kulloste, shkoi te i Dërguari i Allahut (a.s.) dhe e pyeti: “Për çfarë më fton mua? I Dërguari i Allahut (a.s.), iu përgjigj: *“Të ftoj në Islam, të besosh se nuk ka dot tjetër përveç Allahut, të besosh se unë jam i Dërguari i Allahut dhe të adhurosh vetëm Allahun.”* Nisur nga kjo, skllavi i zi e pyeti: “Çfarë do të fitoj si shpërblim, nëse e them shehadetin dhe i besoj Allahut?” I Dërguari i Allahut (a.s.), iu përgjigj: *“Nëse vdes në këtë gjendje, do të hysh në xhenet.”* Pasi skllavi e pranoi Islamin, tha: “O i Dërguari i Allahut! Delet që po kullos janë amanet. Çfarë të bëj me to?” I Dërguari i Allahut (a.s.), e urdhëroi që t’ua dorëzonte delet të zotëve të tyre. Edhe pse ishin në gjendje lufte, Peygamberi (a.s.), nuk pranoi t’i mbante delet si pasuri e zënë në luftë, sepse delet ishin amanet në dorën e bariut dhe amaneti duhej të mbahej. Në lidhje me këtë çështje, nuk ka dallim ndërmjet mikut dhe armikut. I Dërguari i Allahut (a.s.), i tha: “Nxirri delet nga vendi ku po qëndron ushtria! Allahu do ta çojë amanetin në vendin e tij.” Edhe bariu ashtu veproi. Delet shkuan te të

zotët e tyre. Çifuti e kuptoi se skllavi i tij ishte bërë mysliman. Ky bari ra dëshmor në Hajber. (M. E. Zehre, Hatemu’n-Nebijjin, 2/913-914.)

Mbajtjen e amanetit me përpikëri që i Dërguari i Allahut (a.s.), bënte edhe kundrejt armiqve në këtë botë që tradhtia po bëhet lehtë edhe kundrejt miqve, duhet t’ua tregojmë të gjithëve në çdo mënyrë dhe me zë të lartë.

Le të japim edhe një shembull tjetër, që vërteton se edhe sahabët e nderuar kanë ecur në të njëjtën rrugë me të Dërguarin e Allahut (a.s.) dhe kanë qenë mjaft të ndjeshëm në lidhje me çështjen e amanetit: Në një kohë afër çlirimit të Mekës, një karvan tregtie që u përkiste kurejshëve u nis për rrugë. Një njësi ushtarake nën komandën e Zejd bin Harithes e sulmoi këtë karvan. Ata i morën mallrat e karvanit dhe i kapën robër njerëzit e tij. Ndërmjet këtyre robërve ishte edhe bashkëshorti i vajzës së të Dërguarit të Allahut, Zejnebes, Ebu’l-As bin Rebia. Ebu’l-Asi kërkoi mbrojtjen e bashkëshortes së tij, Zejnebes. Edhe ajo e mori në mbrojtje bashkëshortin e saj. Për këtë arsye, shkoi te i Dërguari i Allahut (a.s.) dhe i kërkoi t’i jepte mallrat e bashkëshortit të saj. Peygamberi i mblodhi ata të njësisë ushtarake që kishin sulmuar karvanin dhe u tha: “Siç e dini, Ebu’l-Asi është dhëndri im. Ju keni marrë mallrat e tij. Këto mallra janë mirësia e Allahut që ua ka dhënë juve pa luftë. Unë



ju kërkoj që të shfaqni mirësinë dhe t'ia jepni ato. Nëse nuk i jepni, kjo është diçka që e dini ju, sepse tashmë ju jeni të zotët e atyre mallrave.” Pasi sahabët e nderuar i dëgjuan këto fjalë, ia dhanë mallrat Ebu'l-Asit. Edhe ai u kthye në Mekë. Ua dorëzoi amanetet të zotëve të tyre në Mekë dhe përpara të gjithë popullit tha: “Dëshmoj se nuk ka zot tjetër përveç Allahut dhe se Muhamedi është rob dhe i Dërguari i Tij.” Përveç të tjerash tha: “Ju betohem se do ta shpallja këtë edhe më parë, por po e shfaq tani ngaqë frikësohesha se do thoshit që jam bërë mysliman për t'ju marrë mallrat tuaja.” Pastaj u kthye në Medine të i Dërguari i Allahut (a.s.), si mysliman. Në këtë mënyrë, u bashkua edhe me bashkëshorten e tij, Zejneben. Pejgamberi e fitoi përsëri dhëndrin e tij me këtë fisnikëri dhe shfaq një sjellje shembullore prej myslimani kundrejt politeistëve mekas.

I Dërguari i Allahut (a.s.), shfaqti të njëjtën fisnikëri edhe për motrën e zënë robëreshë të Adij bin Hatemit, Saffanen. Asaj i bleu një rrobë, një kafshë për udhëtim dhe e dërgoi te vëllai i saj, Adiji i cili ndodhej në Sham. Në sajë të kësaj sjelljeje, edhe Adiji u bë mysliman. Historia e pranimit të Islamit nga ana e tij, është mjaft interesante. Detajet e asaj historie mund të ndiqen në literaturën Islame.

Amanetin e ka marrë përsipër njeriu, por shumë herë nuk e ka mbajtur atë. Njeriu ka shfaqur injorancë dhe ka bërë padrejtësi. Në Kuranin Fisnik thuhet: **“Ne ua ofruam përgjegjësinë qiejve, tokës dhe maleve, por ato nuk pranuan ta marrin përsipër dhe u frikësuan ta pranojnë atë, kurse njeriu e pranoi. Me të vërtetë, njeriu u tregua i padrejtë me veten dhe i paditur** (për pasojat e kësaj përgjegjësie).” (Ahzab, 72) Nga fjala amanet që përmendet në këtë ajet, synohen obligimet e përgjegjësitë fetare dhe të gjitha llojet e tjera të amaneteve ndërmjet njerëzve. Gjallesat e tjera nuk e pranuan amanetin si rezultat i natyrshmërisë së tyre, sepse ato nuk mund të dalin jashtë qëllimit për të cilin janë krijuar. Këtu përfshihen edhe engjëjt. Njeriu është gjallesa e vetme që ka aftësinë për të vepruar në kundërshtim me natyrshmërinë e saj në këtë botë. Sprovimi me amanet bëhet fjalë për njeriun, ngaqë atij i është dhënë aftësia për bindje dhe kundërshtim. Njeriu nuk është i padrejtë dhe injorant, ngaqë ka marrë përsipër amanetin, por ngaqë nuk ia jep hakun këtij amaneti.

Në krye të amaneteve më të rëndësishme vjen udhëheqja, sepse kjo do të thotë të marrësh përsipër edhe përgjegjësinë e të tjerëve përveç përgjegjësisë tënde. I Dërguari i Allahut (a.s.), i pati thënë kështu

Ebu Dherr el-Gifarit, i cili i kërkoj pozitë: *“Ti je i pafuqishëm. Kjo punë është një amanet. Amaneti është poshtërim dhe pishmanllëk Ditën e Kiametit për atë që nuk mund t'ia japë hakun.”* (Muslim, Imare, 16.)

Përveç të tjerash, i Dërguari i Allahut (a.s.), ka thënë: *“Kur udhëheqja t'u jepet atyre që janë të paaftë, priteni Kiametin.”* Në këtë mënyrë, ka treguar se sa e rrezikshme është dhënia e autoritetit ndaj atyre që janë të paaftë e të pabesueshëm dhe se si e shkatërron popullin kjo gjendje. Tragjeditë që sjellë dhënia e amaneteve ndaj atyre që janë të papërgjegjshëm dhe të paaftë janë vërtetuar me fakte historike. Të gjithë po e shikojmë se në çfarë gjendjeje e kanë lëshuar dijen dijetarët e paaftë dhe në çfarë gjendjeje e kanë lëshuar vendin udhëheqësit e papërgjegjshëm. Çdo individ duhet të edukohet, në mënyrë që t'ia japë hakun punës që bën apo që do ta bëjë. Nëse një fëmije, që mund të mbartë një peshë prej dhjetë kilogramësh, i jepet një peshë njëqind kilogramësh, është e sigurt se do të shtypet nga ajo peshë e rëndë. Kështu, vritet fëmija dhe nënçmohet edhe ngarkesa.

Si përfundim, mund të themi se njerëzit duhet t'i edukojmë për t'i mbajtur amanetet, duhet t'i stolisim me vetëdijen e mbajtjes së amanetit dhe amanetet duhet t'ua japim këtyre njerëzve të edukuar. Njëra prej dy cilësive më të rëndësishme që kërkojnë nga udhëheqësit është aftësia për të udhëhequr. Ndërsa e dyta është besnikëria.

Rreshtave tanë le t'u japim fund me këtë hadith fisnik: Ebu Hurejra (r.a.), transmeton se një njeri prej shkretëtire shkoi te i Dërguari i Allahut (a.s.), dhe e pyeti se kur do të bëhej Kiameti. Pas pak, Hz. Pejgamberi i tha: *“Kur të humbasë amaneti, prite Kiametin.”* Pyetësi përsëri tha: *“Si mund të humbasë amaneti, o i Dërguari i Allahut?”* I Nderuari ynë iu përgjigj: *“Nëse punët u jepen të paaftëve, prite Kiametin.”* (Buhari, Ilm, Hadithi nr: 59.)

Ka tre lloj kiameti: Kiameti individual, kiameti shoqëror dhe kiameti kur do të shkatërrohet universi. Kiameti që përmendet në hadith, synon zvarritjen e shoqërisë drejt shkatërrimit për shkak të prishjes së rendit shoqëror, mosfunksionimit të ligjeve dhe kaosit.

Paqen dhe qetësinë shoqërore le të mos e bëjmë kurban për injorancën, fanatizmin partiak dhe interesat personale apo të ndonjë grupimi. Andaj, le t'ua japim amanetet atyre që janë të aftë për t'i kryer.

VËSHIRËSITË DHE SHKAQET E TYRE

— Sadik Dana —

Në ditët e sotme, të gjithë janë në vështirësi. Individët janë në vështirësi, shoqëritë janë në vështirësi, të rinjtë janë në vështirësi, të moshuarit janë të dëshpëruar, të varfrit janë të dëshpëruar, të pasurit janë të dëshpëruar, tregtarët janë të dëshpëruar, industria është e dëshpëruar, nëpunësit e shtetit janë të dëshpëruar, punëtorët janë të dëshpëruar... Kështu që kemi arritur në një gjendje aq kritike, sikur lumturia të jetë shndërruar në një zog dhe të jetë ngritur në qiell.

Elhamdulillah në vendin tonë po shtohet ekonomia dhe si rezultat, të gjithë po përfitojnë sipas kësmetit të tyre. Të gjithë po e marrin, po hanë dhe po veshin atë që dëshirojnë. Së fundi, kanë para edhe për të shëtitur dhe për t'u argëtuar.

“Në vështirësi janë vetëm nëpunësit me rroga të ulëta dhe ata që nuk janë të aftë për të punuar.”

Tashmë po ndërtohen ndërtesa që u ngajnë sarajeve të mbretërve persianë. Por edhe zotëruarit e këtyre ndërtesave janë të dëshpëruar. Të tillë janë edhe ata që banojnë nëpër hyrje modeste, edhe ata që banojnë nëpër kolibe. Të gjithë kanë dalë nëpër rrugë.

Lakmia i ka kapluar të gjithë dhe po djeg çdo vend. Të gjithë i kanë sytë te pasuria dhe lumturia e të tjerëve. (Sot nuk ka ngelur më lumturi). Ai që fiton shumë, lakmon atë që fiton edhe më shumë. Kjo pothuajse e bren atë nga brenda. Asnjë nuk është i kënaqur me të drejtën e tij dhe asnjë nuk e falënderon Zotin (xh.sh.).

Nëse dikush arrin ta marrë nëntëdhjetë e nëntë për qind të asaj që dëshiron, e sheh veten si fatkeq. Të gjithë njerëzit kanë një sy të pangopur. Kraharorët dhe zemrat janë ngushtuar. Askush nuk interesohet për botën shpirtërore.

Kjo është një sëmundje e tillë që edhe mjekët e kohës nuk po i gjejnë dot zgjidhje. Pothuajse të gjithë janë bërë armiq të njëri-tjetrit. Edhe ata

pak njerëz me besim të drejtë që dëshirojnë të bëjnë ndonjë mirësi, nënçmohen nga të tjerët.

O Zot! Sa shumë që kanë ndryshuar zemrat dhe mendimet! Askush nuk përpiqet dhe nuk synon të dalë dhe të shpëtojë nga bataku ku ka rënë.

Murtaja e kësaj kohe janë depresionet dhe sëmundjet shpirtërore, që po i brejnë zemrat.

Veçanërisht në qytetet e mëdha të cilat duken moderne në pamjen e jashtme, në çdo rrugë po dëshmojmë zënka, grindje, dhunim të nderit, vjedhje, plaçkitje dhe së fundi, therje me thika, rrokje të armëve dhe zëra plumbash. Përfundimisht, askush nuk është i kënaqur dhe i lumtur me jetën dhe jetesën e tij. Gjithmonë ka vetëm ankesa. Për këtë arsye, askush nuk guxon t'i pyesë të tjerët për hallet e tyre, sepse përgjigja që do të merret është ankesa.

Të gjithë janë të privuar nga sistemi dhe dashuria familjare. Prindërit nuk arrijnë të interesohen për fëmijët e tyre aq sa duhet. Për shkak se gjendja e tyre etike nuk është produktive, nuk mund të bëhen udhërrëfyes dhe edukatorë të mirëfilltë. Askujt nuk i binden bashkëshortet dhe fëmijët e tyre.

Burrat e kanë humbur prestigjin dhe mendje-hollësinë e tyre. Ata pothuajse janë bërë si kukulla. Të gjitha përpjekjet dhe mundimet janë vënë në shërbim të dëshirave të stomakut dhe të pjesëve të poshtme të trupit. Kënaqësitë shpirtërore, mirësjellja, edukata, turpi dhe cilësitë e tjera të bukura, kanë rënë në heshtje dhe janë zhdukur.

O Zot! Meqë mëshira jote ka përfshirë çdo gjë, na nxirr nga ky batak dhe na udhëzo në rrugë të drejtë! Ki mëshirë për ne! Mos u zemëro dhe mos na gjyko me drejtësinë tënde, por na mëshiro, sepse, ajo që na takon neve të bëjmë, është pohimi i gabimeve tona dhe strehimi te falja Jote.

PUNA MË E MIRË

TË MËSOSH KURANIN DHE T'UA MËSOSH ATË TË TJERËVE

— Semih Jollaçan —

Gjëja më e lartë dhe e ndershme për njeriun është të bëhet mysliman duke iu bindur thirrjes së Allahut dhe të të Dërguarit të Tij. I Dërguari i Allahut, i tha Muadh bin Xhebelit, radijallahu anh:

“A të të tregoj për gjënë më kryesore?”

“Gjëja më kryesore është Islami.”¹

Dikush e pyeti të Dërguarin e Allahut, :

“O i Dërguari i Allahut! Së pari të luftoj dhe pastaj të bëhem mysliman?” I Dërguari i Allahut, iu përgjigj:

“Së pari, bëhu mysliman, pastaj lufto!” Në këtë mënyrë, i Dërguari i Allahut, (a.s.), na ka treguar se Islami vjen në krye të çdo gjëje.

Po, Islami është koka dhe fillimi i çdo gjëje. Nisur nga kjo, ai njeri që nderohet me Islamit, do të thotë se ka nisur rrugën e mirësisë. Pas kësaj nisjeje dhe fillimi, tashmë duhet të fillojë garën e mirësisë ashtu siç shprehet edhe në ajetin fisnik.² Kjo garë do ta shpjerë myslimanin e nderuar me Islam në rrugën për t’u bërë “më i miri” ndërmjet myslimanëve. “Më i mirë” do të thotë të jesh një hap para të tjerëve ndaj kënaqësisë së Allahu Teala dhe të të Dërguarit të Tij. I Dërguari i Allahut, që i inkurajonte besimtarët për të garuar në mirësi, ishte shembull për ata që dëshironin të zinin vend në rreshtat e parë të kësaj gare, duke i njoftuar ata kohë pas kohe se kush ishin më të mirët ndërmjet besimtarëve.

Në një hadith fisnik që tregohet se kush janë besimtarët më të mirë, i Dërguari i Allahut, ka thënë:

“Më i miri prej jush është ai që e mëson Kuranin

dhe ua mëson atë të tjerëve.”³

Ngaqë fjala më e mirë është Kurani Fisnik për shkak se është fjala e Allahut Teala, sigurisht se edhe njeriu më i mirë është ai që e mëson dhe ua mëson të tjerëve fjalën e Allahut. Dijetarët selefë nuk e kanë parë si të barabartë me asgjë mësimin e leximit të Kuranit dhe mësimin e tij të tjerëve.⁴

I Dërguari i Allahut, ka thënë:

“Mësojeni Kuranin! Sa ndërmjetësues i mirë është ai në ditën e kiametit për ata që e lexojnë!”⁵

I Dërguari i Allahut, na përgëzon duke thënë:

“Kush mëson një ajet nga libri i Allahut, ditën e kiametit ai ajet i del përpara duke i buzëqeshur.”⁶

I Dërguari i Allahut, na tregon në këtë mënyrë se sa punë me fitim është mësimi i Kuranit fisnik dhe mësimi i tij të tjerëve:

“Lexojeni Kuranin! Duke e lexuar atë, ju shpërbleheni me dhjetë sevape për çdo shkronjë të tij.”⁷

Nëse mund ta imagjinojmë se sa shkronja ka në një faqe, krejt qartësisht del në pah se sa fitimprurëse është puna që kemi bërë.

I Dërguari i Allahut, (a.s.), i ka thënë kështu Hazreti Aliut, radijallahu anh:

“O Ali! Mësoje Kuranin dhe mësojua atë njerëzve! Për çdo shkronjë të tij, do të kesh dhjetë sevape. Nëse vdes, vdes si dëshmor.”

O Ali! Mësoje Kuranin dhe mësojua atë njerëzve! Kur të vdesësh, njerëzit do t’a vizitojnë varrin tënd siç vizitojnë shtëpinë e Allahut.”⁸

3. Buhari, VI, 108.

4. En-Neshr, I, 3.

5. Ed-Darimi, Fedailu'l-Kuran, I / er-Riaje, fq. 7.

6. El-Itkan, IV, 105.

7. Darimi, Sunen, II, 429.

8. Nihajetu'l-Kavli'l-Mufid, fq. 255.

1. Ibn Maxhe, Fiten, 12.

2. El-Bakara, 148.

Ukbe bin Amri, radijallahu anh, tregon:

“Kur ishim në suffe, i Dërguari i Allahut, doli jashtë dhe pyeti:

“Kush prej jush dëshiron të shkojë çdo ditë deri në But’han, ose deri në Akik pa bërë ndonjë mëkat e pa i shkëputur lidhjet farefisnore dhe të sjellë nga aty dy deve me gunga të mëdha?” Ne i thamë:

“Duam ne, o i Dërguari i Allahut!” Pastaj, i Dërguari i Allahut, tha:

“Atëherë, nëse dikush prej jush shkon në ndonjë xhami dhe mëson apo i lexon dy ajete nga libri i Allahut të Madhëruar, kjo është më e mirë për të se dy deve. Tre ajete janë më mirë për të se tri deve. Katër ajete që mund t’i mësojë, janë më të mira për të se katër deve. Sado që të rritet numri i këtyre ajeteve, është më mirë për të se numri i deve që i takon për çdo ajet.”⁹

Prindërit që u mësojnë Kuranin fëmijëve...

Nëse fëmijët tanë rriten dhe edukohen në mënyrë të mirë, ata janë kapitali i kësaj bote dhe i botës tjetër. Ndërsa fëmijët që u neglizhohet ahireti për hir të dynjasë, bëhen pikëllim dhe turp, si për prindërit ashtu edhe për shoqërinë. Për këtë arsye, prindërit duhet të jenë të përpiktë për mësimin e Kuranit fëmijëve të tyre. Madje, nëse është e nevojshme, së pari Kuranin duhet t’ua mësojnë vetë atyre, sepse i Dërguari i Allahut, ka thënë:

“Atij që u mëson Kuranin fëmijëve të tij, ditën e kiametit do t’i vihet një kurorë në xhenet.”¹⁰

Ndërsa, në një tjetër hadith fisnik, thuhet kështu në lidhje me këtë kurorë:

“Prindërve që ua mësojnë Kuranin fëmijëve të tyre në këtë botë, u vendoset një kurorë e tillë në xhenet, saqë të gjithë e kuptojnë se ata ua kanë mësuar Kuranin fëmijëve të tyre në këtë botë.”¹¹

Enes bin Maliku transmeton se i Dërguari i Allahut, ka thënë:

“Atij që ua mëson Kuranin fëmijëve të tij duke parë shkronjat dhe rreshtat, i falen mëkatet e kaluara dhe të ardhshme. Atë që e bën të njëjtën punë përmendsh, Allahu do ta tubojë të ndritshëm si hëna katërmbëdhjetëshe. Fëmijës së tij i thuhet:

Lexo! Kur fëmija të lexojë një ajet, prindërit lartësohen një gradë. Kjo gjë përsëritet deri në ajetin e fundit që fëmija ka mësuar nga Kurani.”¹²

9. Muslim, Sherhu'n-Nevevi, VI, 87.

10. El-Itkan, IV, 104.

11. Zevaid, 7/165-166.

12. Zevaid, 7/165-166.

Mehri më i bukur...

Një ditë, një robëreshë erdhi te i Dërguari i Allahut, dhe i tha:

“Unë ta kam falur veten time Ty!”

Pastaj qëndroi ashtu për një kohë të gjatë në këmbë.

Një burrë i varfër prej myslimanëve që gjendej aty, tha:

“O i Dërguari i Allahut! A mund ta martosh atë me mua, nëse nuk martoheni ju me të?!” Pejgamberi, (a.s.), e pyeti:

“A ke ndonjë gjë që mund t’ia japësh për meher?”

Burri i varfër tha:

“Nuk kam asgjë përveç kësaj anterie!”

Pejgamberi, i tha:

“Si mund të rrih ti pa anteri, nëse ia jep asaj anterinë tënde? A ke ndonjë gjë tjetër?” Burri i varfër tha:

“Nuk kam asgjë tjetër që mund t’ia jap.”

I Dërguari i Allahut, e pyeti:

“A nuk mund të bësh, qoftë edhe një unazë prej hekuri?”

Burri i tha se nuk mund ta bënte as këtë. I Dërguari i Allahut, e pyeti:

“A di diçka përmendsh nga Kurani?”

Burri i tha:

“Po, di këtë e këtë sure.”

Dhe tha emrat e sureve që i dinte përmendsh. Pastaj, i Dërguari i Allahut, (a.s.), i tha:

“Unë po e martoj atë me ty, në kundërvlerë që t’ia mësosh edhe asaj këto sure që i di përmendsh!”¹³

Sa meher i bukur për nusen dhe për dhëndërrin...

Së fundi, të mësosh Kuranin dhe t’ua mësosh atë të tjerëve, është fitimi më i mirë për dynjanë dhe për ahiretin. Kurani nuk e lë vetëm, as në dynja dhe as në ahiret atë që përpiqet për të. Allahu, me mirësinë e Tij, na bëftë prej atyre që e lexojnë Kuranin e kuptojnë dhe e zbatojnë atë në jetën e tyre. Na bëftë prej atyre që e mësojnë fjalën e Allahut dhe ua mësojnë atë të tjerëve dhe prej atyre që hyjnë ndërmmjet “më të mirëve” prej myslimanëve!

Amin!..

13. Tirmidhi, vëll. 3, fq. 422.



KËNAQËSIA

KUNDREJT DURIMIT NË VUAJTJE

Kënaqësia nuk kërkon mungesë të ndjenjës së dhimbjes dhe paretisë, por që një njeri të mos kundërshtojë ose të mos ndjejë hidhërim karshi dekretit të Allahut. Ky dallim ka humbur tek disa njerëz që e refuzojnë në tërësi idenë e kënaqësisë përballë vështirësive si një gjë e panatyrshme, dhe argumentojnë se ajo që kërkohet nuk është asgjë tjetër përpos durimit. Sepse kënaqësia ndaj pakënaqësisë është kontradiktë në vetvete, sepse njëra është e kundërta e tjetrës.

Megjithatë, qendrimi i saktë është se nuk ekziston asnjë kontradiktë ndërmjet tyre, sepse prezenca e pikëllimit dhe e paretisë së vetes nuk e mohon kënaqësinë, siç është kënaqësia e një pacienti me pirjen e një ilaçi të hidhur, apo kënaqësia e një personi agjërues në një ditë të nxehtë me ndjesinë e urisë dhe etjes, kënaqësia e një luftëtari me vështirësitë dhe mundimet që ai ndesh në rrugën e Allahut, dhe kështu me radhë.

Kënaqësia është një rrugë drejt Allahut që është e shkurtër dhe e shpejtë dhe arrin qëllimin më të lartë. E megjithatë, ajo është e lodhshme. Por nuk është më e lodhshme se sa vështirësia në rrugën e përpjekjes me armë, dhe as nuk ka shtigjet e rrëpirta dhe shkretëtirat që kjo e fundit përmban. Udhë e saj e rrëpirtë nuk është asgjë tjetër përpos një dëshirë e lartësuar, shpirt i kulluar, dhe rehati i vetes përpara gjithçkaje që vjen nga Allahu. Ajo që e bën atë të lehtë për robin është dija e tij rreth dobësisë dhe pafuqishmërisë së vetes së tij

dhe rreth mëshirës, dhembshurisë, dhe mirësisë së Allahut. Kur një njeri i merr në shqyrtim këto dy fakte e megjithatë mënon që ta hedhë veten e tij përpara Allahut në kënaqësi me të gjitha motivimet e dashurisë dhe hareshë së nxjerrë prej saj, vetja e tij nuk është e denjë për Allahun, është e larguar prej Tij, jomeritore e afërsisë dhe miqësisë së Tij, ose është një vete e kapluar nga mundimet dhe sprovat. Sepse shtegu i kënaqësisë është një shteg që e bën një rob të hedhë hapa të mëdhenj madje edhe kur ai është në shtratin e tij, dhe kjo e bën atë të parakalohë një kalorës në shumë vendmbërritje.

Fryti i kënaqësi së është lumturia dhe ëndja me Allahun e Plotfuqishëm. Unë kam parë Shehun e Islamit Ibn Tejmije, Allahu e nderoftë shpirtin e tij, në një ëndërr dhe i përmenda atij një çështje në lidhje me aktet e zemrës, dhe vijova më tutje duke përmendur madhështinë dhe dobinë e saj, gjë që nuk do ta cek këtu. Përgjigja e tij ishte: “Sa për mua, udha ime është që të jem i kënaqur dhe i lumtur me Allahun,” ose diçka me këtë kuptim. Kjo ishte gjendja e tij gjatë jetës, siç është e qartë, dhe siç gjendja e tij e bënte të dukshme.

But al-Uasiti ka thënë: “Vendose kënaqësinë në përdorim sa më mirë që të mundesh, por mos e lër kënaqësinë tënde të vërë ty në përdorim kështu që ti të bëhesh i përlur nga kënaqësia e saj dhe i humbur në të përpara realitetit të asaj që ti sheh.” Ky aluzion i al-Uasitit është një vendkalim tej mase i lodhshëm në sytë e Popullit [sufive], sepse për

ata kërkimi i prehjes dhe qetësisë në gjendjet, të ndaluarit në to për hir të kënaqësisë dhe dashurisë, është një perde e madhe ndërmjet tyre dhe Zotit të tyre teksa kënaqësitë e tyre ua mbulojnë sytë nga të vëzhguarit e të drejtave të objektit të dashurisë dhe adhurimit, dhe ky vendkalim i vështirë nuk kapërcehet përpos nga mjeshttrat e mëdhenj.

Al-Uasiti bënte shpesh thirrje për kujdes kundër kësaj sfide dhe paralajmëroi për të [për natyrën e saj tradhtare]. Ai thoshte: “Bëni kujdes se mos ju ëmbëlsohen aktet tuaja të adhurimit, sepse ky është një helm vdekjeprurës.”

Ky, pra, është kuptimi i fjalëve [të Harauit], “vendosja e kënaqësisë në përdorim” por mos e lër atë të të përdorë ty, domethënë, puna jote nuk duhet të ketë për synim që të arrijë ëmbëlsinë e kënaqësisë, aq sa ajo bëhet motivimi yt i vërtetë. Më saktë, bëje atë një instrument dhe shkak në arritjen e qëllimit dhe objektivit tënd, kështu që ti e përdor atë e jo ta lësh atë të të përdorë ty.

Megjithatë, ky paralajmërim nuk është i kufizuar në stacionin shpirtëror të kënaqësisë, por prek të gjitha gjendjet (hal) dhe vendstacionet (mekam) e zemrës në të cilat zemra gjen paqe. Një njeri nuk duhet të punojë drejt dashurisë thjesht për hir të dashurisë dhe ëndjes dhe haresh që e shoqëron atë, por më saktë e përdor dashurinë për të arritur atë që e kënaq të Dashurisë; të ndalesh të dashuria do të ishte një mangësi e dashurisë.

Dhu al-Nuni ka thënë: “Ka tri shenja të kënaqësisë: të braktisurit e kontrollit përpara dekretit, të mos kesh asnjë hidhërim mbas dekretit, dhe ekstaza e dashurisë kur mundimi është në kulmin e tij të rëndë.”

I thanë Husjenit, birit të Aliut, Allahu qoftë i kënaqur me të dy ata, se Ebu Dherri, Allahu qoftë i kënaqur me atë, thotë: “Skamja është më e dashur për mua se sa bollëku, dhe sëmundja më e dashur për mua se sa shëndeti.” Hyseni tha: “Allahu i dhëntë rahmet Ebu Dherrit. Sa për mua, unë them: “Cilido që ia jep besën mirësisë së zgjedhjes së Allahut për atë, ai nuk dëshiron asgjë tjetër përpos asaj që Allahu ka zgjedhur.”

Fudejl ibn Ijadi i ka thënë Bishr el-Hafit: “Kënaqësia është më e epërme se sa asketizmi [zuhdi] karshi kësaj dynjaje, sepse një njeri që është i kënaqur nuk dëshiron asgjë përmbi atë që i është dhënë.”

Ebu Uthmanin e pyetën në lidhje me thënien e Profetit, paqja qoftë mbi të: “Unë e kërkoh kënaqësinë mbas dekretit hyjnor.” Dhe ai tha: “Është kështu sepse të qenurit i kënaqur përpara gjykimit hyjnor

[rreth një çështjeje që na kaplon] është vetëm qëllim dhe vendosmëri; kënaqësia e vërtetë është ajo që është mbas gjykimit.”

Është thënë: “Kënaqësia do të thotë të shmangësh ankimin për çdo mundim, çfarëdo qoftë ai.”

“Do të thotë të heqësh dorë nga zgjedhja.”

“Do të thotë të mirëpresësh vendimet me ëndje.”

“Do të thotë qetësi e zemrës me vendimet që merren.”

Omer ibn Hatabi i shkroi Ebu Musa el-Esh’ariut, Allahu qoftë i kënaqur me të dy ata: “E gjithë mirësia shtrihet në të qenit i kënaqur. Kështu që, në qoftë se ti mundesh, bëje këtë, përndryshe, bëj durim.”

Ebu Ali el-Dakkaku ka thënë: “Njeriu është si një poçe prej dheu që nuk ka asnjë vlerë në qoftë se i kundërvihet caktimit (kaderit) të të Vërtetit të Plotfuqishëm.”

Ebu Othman el-Hiri ka thënë: “Për dyzet vjet Allahu nuk më ka bërë që të qëndroj në një vend ndaj të cilit unë kam pasur mospëlqim, apo nuk më ka bërë që të lëviz drejt një vendi tjetër që unë e kisha zët.”

Kënaqësia është tre lloje. Kënaqësia e njerëzve të zakonshëm me atë që Allahu ka caktuar si kismet për atë dhe ia ka dhënë atij, kënaqësia e elitës me atë që Allahu ka caktuar dhe vendosur, dhe kënaqësia e elitës së elitës me Atë në këmbim për gjithçka tjetër.



CILAT FIRMA DUHET TË ZGJEDHIM PËR VESHJET TONA?

— Shefika Kaja Meriç —

Islami ka vendosur ligje universale. Feja jonë nuk ka vendosur ligje dhe rregulla të veçanta për individët. Jeta e jetuar sipas ligjeve të Islamit është shpëtim për të gjithë njerëzimin. Ajo na tregon rrugën për të fituar të mira në këtë botë dhe në tjetrën.

Islami ka rregullat e veta rigorozë për femrat dhe meshkujt, rregulla këto që duhen ndjekur. Në fund të fundit besimtar quhet një person i cili i ndjek rregullat e fesë sonë.

Le t'u hedhim një sy këtyre pyetjeve:

Cila duhet të jetë lidhja e një myslimani me modën?

Çfarë duhet të bëjë një mysliman për të qenë në modë?

Cilat duhet të jenë rregullat që duhet të ndjekë një mysliman në veshjen e vet?

Në fakt, përgjigjja e këtyre pyetjeve ka shumë kohë që është dhënë në një mënyrë të prerë, por ne do t'i kujtojmë ato gjëra edhe një herë.

Si fillim të shohim shpjegimin e këtyre dy termave:

Çfarë do të thotë veshje firme dhe modë?

Firma është një term që përdoret për të dalluar produktet e ngjashme të prodhuara nga kompani të ndryshme.

Moda përfshin koncepte si veshje, art, muzikë, teatro, ushqim, arkitekturë etj.

Myslimanët nuk duhet të kenë dëshirë ose fiksion për të ndjekur modën. Në qoftë se keni nevojë për një shembull të cilin do e imitoni, ai duhet të jetë shembulli i të gjitha kohërave dhe që nuk vjetrohët kurrë: shembulli i Pejgamberit tonë të nderuar sallallahu alejhi ve selem. Ne



duhet të duam, të veshim dhe të pëlqejmë gjërat që Ai ka dashur, veshur dhe pëlqyer.

Moda që ndjek një grua myslimane duhet të shkojë paralelisht me rregullat e Islamit. Asnjë modë nuk duhet të dalë nga rregullat që ka vendosur feja jonë. Në pikën ku moda i bie ndesh veshjes islame, gruaja myslimane duhet të ndjekë fenën e vet pa asnjë dyshim.

Në fakt, ajo që quhet modë është një lloj jetese e cila ndiqet nga ne dhe që del nga rregullat morale. Gratë dhe vajzat e reja duhet të jenë shumë të kujdesshme në këto tema. Ne duhet të jemi të kujdesshëm në momentin që përpiqemi të imitojmë njerëzit e famshëm, duhet të shikojmë edhe vlerat njerëzore të atij personi.

Ajeti kuranor i ka përcaktuar rregullat që duhet të ndjekë një femër myslimane:

Thuaju besimtareve që të ulin shikimet e tyre (nga e ndaluara), ta ruajnë nderin e tyre (nga marrëdhëniet e jashtëligjshme) dhe të mos i shfaqin stolitë e tyre 221, përveç atyre që janë të dukshme. Le t'i mbulojnë kraharoret me mbulesat e tyre (të kokës) dhe të mos ua shfaqin stolitë e tyre, përveçse bashkëshortëve të tyre ose baballarëve të tyre, ose vjehërrve të tyre, ose bijve të tyre, ose djemve të bashkëshortëve të tyre, ose vëllezërve apo djemve të vëllezërve të tyre, ose djemve të motrave a grave të tyre, ose atyre që i kanë nën zotërim

(si skllave), ose shërbëtorëve që nuk kanë epsh ndaj femrave apo fëmijëve që nuk i dinë ngacmimet e femrave. Dhe të mos i rrahin këmbët (për tokë), në mënyrë që të mos duken stolitë e tyre të fshehta. Të gjithë ju, o besimtarë, kthehuni tek Allahu të penduar, që të arrini shpëtimin! (en- Nur, 31)

Allahu (xh.sh.), i ka dhënë shumë rëndësi kësaj teme, këtë e shohim nga mënyra e detajuar në të cilën është shpjeguar kjo gjë, sepse në Kuran në përgjithësi gjejmë të dhënat kryesore dhe nuk ka thellime në detaje. Në momentin kur tema është karakteri dhe personaliteti i femrës myslimane shfaqet një shpjegim i detajuar.

Nuk ka rëndësi se çfarë veshim, veshje firme apo jo, ato duhet të jenë të gjitha sipas rregullave të fesë sonë!.. Të gjitha mendimet e tjera janë gjëra tona personale që nuk kanë të bëjnë me fenë islame.

Diçka tjetër të cilën duhet të kemi kujdes është edhe fakti që nganjëherë termi i të veshurit në modë me termin e të veshurit bukur ngatërrohen. Në fillim duhet të marrim parasysh rregullat e fesë sonë dhe pastaj duhet të kujdesemi për të veshur gjërat të cilat na shkojnë. Bukuria apo siguria që fiton një njeri nga veshjet e modës që përdor shuhet në momentin që ajo modë e humb suksesin e vet. Besimtarja duhet të ketë një stil të vetin dhe një qëndrim origjinal.

Veshja e një robe firmato duke e treguar atë, duke i bërë reklamë nuk i shkon një besimtareje. Për më tepër që ky qëndrim tregon krenari dhe arrogancë. Pejgamberi yën i nderuar i ka dënuar ato që krenohen me veshjet e tyre.

Le ta përfundojmë këtë shkrim me ajetet që flasin në lidhje me rregullat që duhen ndjekur në fenë tonë:

“O i Dërguar! Thuaju grave tuaja: ‘Nëse dëshironi jetën e kësaj bote dhe shkëlqimin e saj, ejani, unë do t’ju lë të kënaqeni për ca kohë dhe do t’ju lëshoj si është më mirë.’” (El- Ahzab, 28)

“O gratë e të Dërguarit! Ju nuk jeni si gratë e tjera. Nëse i frikësoheni Allahut, mos flisni me përkëdheli, që të mos ju dëshirojë ai që ka zemër epshore, por flisni drejt dhe në mënyrë të ndershme! (El- Ahzab, 32)

“O Profet, thuaju grave dhe vajzave të tua, si dhe grave të besimtarëve, që të lëshojnë

mbulesën e tyre (të kokës) përreth trupit. Kjo është mënyra më e përshtatshme që ato të njihen e të mos ngacmohen nga të tjerët. Me të vërtetë, Allahu është Falës dhe Mëshirëplotë.” (El- Ahzab, 59)

Duaja jonë:

O Allah! Strehohemi tek Ti për të na mbrojtur nga mëkatet e kësaj kohe të shthurur që na duken të bukur e tërheqës! Përsërisim fjalët e Jusufit (a.s.): “Padyshim egoja të çon në rrugë të gabuar. Vetëm në qoftë se Allahu të mëshiron...”

O Allah, na mbro edhe ne ashtu siç e ke mbrojtur Jusufin (a.s.), nga ai mëkat i keq, por në dukje tërheqës. Na bëj prej atyre që penden me sinqeritet të thellë. Na i fal gabimet e të kaluarës. Mos na ndaj nga Resulallahu dhe shokët e Tij, bëj që gjithmonë të ecim në gjurmët e tyre... Amin.





FËMIJË TË SËMURË PAS BLERJEVE

— Psik. Tuba Sokmen —

Babai i fëmijës së vogël kishte dy muaj që kishte hyrë në burg. Nëna, vëllai dhe motra e vogël kishin mbetur pa askënd. Në fillim fqinjët i kishin ndihmuar shumë; dikush u sillte ushqim, një tjetër kujdesej për vajzën e vogël teksa nëna shkante në punë, por sigurisht që nuk mbahet shtëpia me miell hua. Nuk mundën t'i ndihmonin më. Qiraja dhe fatura nuk u shlye dhe pronari i shtëpisë nuk duroi më.

Nëna e re me tre fëmijë kishte mbetur në mes të rrugëve. As familja e burrit dhe as familja e vet nuk i mori në shtëpi.

Më në fund, shteti i mori në një shtëpi strehimi. Ata ndjeheshin të sigurt në këtë vend ku nuk kishin frikë nga uria dhe i ftohti. Unë po shkoja për të takuar një grua në shtëpitë e strehimit, kur u takova me të... Fëmijët e mëdhenj nuk i shqiteshin fustanit të nënës, ishin lidhur ngushtë me njëri-tjetrin. Teksa fëmijët po shikonin televizion, nëna më shpjegoi për vështirësitë që kishin hasur në jetë. Nga njëra anë shiu godiste xhamat e dritares e nga ana tjetër ishin lotët e gruas.


Fëmija i dytë vrapoi me nxitim tek nëna dhe i tha:

“Mamiiii, unë e kam ngrënë këtë njëherë!.. E kam ngrënë...”

Nëna më shpjegoi që nganjëherë e blinte një nga ky produkt dhe ua ndante fëmijëve të vet. Teksa kjo fjalë e dhimbshme po përsëritej në kokën time vështirimi im u kryqëzua me atë të gruas. Fëmija shkoi me vrap pranë vëllezërve dhe të tre u zhytën në botën e reklamave. Unë po lutesha që të mos dilte më asnjë reklamë ushqimi, por fatkeqësisht një reklamë tjetër me e bukur filloi të shfaqej. Reklamë pas reklame shpirti im plagosej edhe më shumë... Nuk e kisha menduar se vuajtja në sytë e një fëmije mund të më vriste kaq shumë.

Ne ishim njerëz që i konsumonim të gjitha ato produkte që dilnin në reklama. Sa më shumë që e mendoja, aq më keq bëhej zemra ime. Ishte një dhimbje aq e madhe, sa që vendosa të mos e mendoj më, por fjalët dhe shikimin e atij djali nuk do t'i harroja kurrë:

“Unë e kam ngrënë këtë njëherë.”



Nga dashuria e madhe që kemi për fëmijët tanë kërkojmë që t'u blejmë atyre çdo gjë që dëshirojnë. Është shumë e qartë që sistemi kapitalist e ka kuptuar këtë sekret shumë kohë më parë. Bota e reklamave luan me temën e fëmijëve dhe i bën prindërit që t'u blenë atyre çdo gjë që fëmijët dëshirojnë me mendimin për t'u kujdesur sa më mirë për ta. Sigurisht që sistemi nuk ka harruar të gjejë një parullë shumë efikase: "Përdore, hidhe dhe blej një të re."

Ne duam më të mirën dhe më të bukurën për fëmijën tonë dhe këtë gjë e justifikojmë me mëshirën që ka prindi për fëmijën. Nuk e kuptojmë se rritja e fëmijës në një pus shpenzimesh të tepërta nuk vjen nga mëshira, por nga paaftësia jonë për të kontrolluar egon tonë.

Nëna dhe babai e kanë të vështirë të kontrollojnë egon e tyre, prandaj i mësojnë edhe fëmijët me të njëjtën mënyrë jetese. Fatkeqësisht, shpenzimet e panevojshme që bëhen për lojërat, ushqimet dhe nevojat e tjera të fëmijës e ndotin botën e pastër të tij.

Sigurisht që fëmija duhet të ketë lojëra, sepse ato janë shumë të rëndësishme për zhvillimin e tij, por blerja e modelit të fundit të çdo loje nuk e gëzon fëmijën, përkundrazi e mërzit më shumë. Ky veprim ndikon negativisht tek zhvillimi psikologjik i fëmijës. Ai nuk ia di vlerën asnjë gjëje dhe në momentin kur i prishet një lojë kërkon që t'i dhurohet një tjetër. Fëmija fillon të mërzitet shumë shpejt nga lojërat, nuk pranon t'i ndajë ato me të tjerët dhe bëhet egoist. Gjërat e mira që mund të fitojë një fëmijë nga dy lojëra i fiton edhe nga një lojë e vetme, kurse numri i madh i lodrave vetëm e mërzit atë.

Ushqimi është një pikë tjetër për të cilën prindërit duhet të bëjnë kujdes. Ushqimet e shëndetshme ndihmojnë zhvillimin e trurit, por nuk është aspak e nevojshme që për çdo vakt të përgatiten ushqime

me shumicë. Një ose dy lloje ushqimesh janë të mjaftueshme për një vakt. Më shumë ushqime se kaq dëmtojnë trupin dhe anën shpirtërore të fëmijës. Në momentin që fëmija bëhet dëshmitar i hedhjes në kosh të ushqimeve, psikologjia e tij mësohet me shpërdorimin e produkteve.

Moda është një dukuri e cila me reklamimin e gjërave të reja nuk bën gjë tjetër veçse i hap rrugë blerjeve të pakontrolluara. Njerëzit profesionistë të modës na mësojnë se çfarë të veshim dhe falë tyre ne nuk turpërohemi para botës (!).. Rrobat e dala mode ua japim njerëzve në nevojë dhe në këtë mënyrë ndërgjegjja jonë është e pastër. Hapim vend për rroba të reja dhe vazhdojmë me blerje të pakontrolluara.

Mendohet që kinemaja dhe teatri e ndihmojnë zhvillimin e njeriut. Në fakt këto aktivitete u mësojnë fëmijëve vetëm mënyrën se si të sillen në shoqëri, por nuk arrijnë që t'i bëjnë fëmijët më të shoqërueshëm, sepse për të arritur një gjë të tillë janë të nevojshme shumë gjëra. Që fëmija të jetë i shoqërueshëm, duhet të mësohet të ndajë lodrat me shokët e vet, të përshëndesë fqinjët, të mundohet t'i kuptojë njerëzit dhe shumë gjëra të tjera. Njeriu i cili nuk mund të ndajë shtëpinë, ushqimin, ndjenjat me të tjerët nuk bëhet i shoqërueshëm. Cili njeri shkon në kinema për të krijuar shoqëri? Në këto vende fëmija mëson vetëm rregulla të tilla si: qëndrimin në qetësi, pritjen në radhë etj.

Shumë herë ne i kufizojmë dëshirat tona, në mënyrë që të plotësojmë dëshirat e fëmijëve tanë. Në qoftë se kjo sakrificë vjen nga mëshira, do t'u bëjë mirë fëmijëve, por në qoftë se vjen nga egoja jonë, atëherë u bën keq fëmijëve.

Ne si prindër duhet të llogarisim mirë gjërat që ka nevojë fëmija dhe të mos i japim më shumë se aq, sepse nesër të gjitha këto mund të kenë efekte shumë negative.



LUMTURIA NË FAMILJE

— Zahide Topçu —

Lumturia në familje është një temë shumë rëndësishme. Nuk ka rëndësi gjinia, sepse çdo burrë apo grua që është i/e lumtur në familje përhap lumturi në çdo ambient që e rrethon. Ndërsa njeriu që nuk ka lumturi në familje është gjithmonë i mërzhitur dhe i shqetësuar.

Allahu (xh.sh.), i ka krijuar të gjitha gjallesat në çift dhe secili ka nevojë për tjetrin. Edhe njerëzit janë krijuar në çift, dhe partneri është gjithmonë pjesë e pandarë dhe plotësuese e partnerit tjetër.

Mendja e një njeri mund të kuptohet duke vëzhguar gjërat që ai dëshiron të arrijë. Një grua e zgjuar nuk është e dhënë pas rehatisë të kësaj bote dhe pas të mirave që ajo mund të ofrojë, prandaj ajo do të jetë e lumtur edhe në qoftë se jeton në pallate mbretërore, edhe në qoftë se jeton në kasolle. Sado të bukura të jenë të mirat e kësaj bote një ditë do t'u vijë fundi dhe gjithsesi ato kanë të meta, prandaj nuk mund ta kënaqin kurrë zemrën e një njeriu. Gjëja e vetme që të jep qetësi është besimi në Allah dhe nënshtrimi para Tij. Asnjë gjë tjetër nuk mund ta lumturojë shpirtin.

Burrat gjithashtu nuk duhet ta kërkojnë lumturinë tek puna dhe karriera. Të dyja këto sjellin me vete shumë ankth dhe vështirësi.

Lumturia në familje vjen në çastin kur bashkëshortët e dëgjojnë njëri-tjetrin dhe përpiqen të kuptojnë se çfarë janë gjërat që mund ta bëjnë tjetrin të lumtur. Gruaja duhet të kuptojë dëshirat e burrit të vet dhe me aq sa ka mundësi duhet t'i plotësojë ato; kurse burri duhet të gjejë rrugë për të arritur tek zemra e gruas së vet.

Gruaja e mirë është si një lule që përhap aromë të këndshme rreth e rrotull. Gruaja duhet të tregohet e zgjuar dhe ta bëjë për vete burrin dhe familjen e tij. Mënyra më e mirë për ta arritur këtë gjë, është duke qenë e bindur ndaj burrit dhe e kujdesshme me fëmijët. Krenaria dhe kokëfortësia nuk të sjellin asnjë gjë të mirë.

Gruaja e mirë dhe e zgjuar është një thesar i paçmuar. Burri duhet ta dijë vlerën e një gruaje që i njeh Allahun dhe Resulallahun, që e bën më së miri detyrën e vet ndaj fesë, që ka respekt ndaj burrit të vet dhe që e mbështet burrin në punët e tij. Në qoftë se burri nuk ia di vlerën, le të frikësohet se mund të mbesë pa të, sepse gjërat që nuk ua din vlerën, të merren.

Në martesë burri dhe grua duhet të jenë si një mbulesë që fsheh mangësitë dhe problemet e tjetrit. Ata duhet ta mirëkuptojnë njëri-tjetrin dhe të mundohen që t'i falin gabimet. Edhe problemi më i vogël në qoftë se diskutohet shumë, zmadhohet dhe ne jemi dëshmitarë se si janë shkatërruar familje nga një zënkë krejt e vogël. E kundërta ndodh tek familjet e zgjuara, të cilat edhe problemet më të mëdha i zvogëlojnë aq shumë derisa të zhduken krejtësisht.

Fëmijët të cilët rriten në familje në të cilat mbi-zotëron paqja dhe dashuria janë të lumtur. Ata nuk janë njerëz të stresuar dhe nuk kanë mllef apo urrejtje për njerëzit.

Prindërit në fillim duhet të kenë kujdes sjelljet e tyre, sepse në atë mënyrë do të bëhen shembull i mirë për fëmijët e tyre. Fëmija e mëson në familje dashurinë për nënën dhe babanë, mirësjelljen dhe edukatën ndaj njerëzve të tjerë, respektin ndaj më të mëdhenjve dhe mëshirën ndaj më të vegjëlve.

Shtëpitë tona duhet të bëhen çerdhe në të cilat të mësohet feja jonë. Në to duhet të flitet për Allahun dhe të Dërguarin e Tij në çdo moment. Nëna dhe babai, që janë mësuesit më të rëndësishëm, nuk duhet të harrojnë që t'u mësojnë fëmijëve të tyre shembullin më të mirë të njerëzimit.

Shkurtimisht mund të themi se lumturia që ndodhet brenda zemrës duhet të përçohet në familje, kurse lumturia në familje duhet të kalojë edhe në rrugë e kudo. Zemra e myslimanëve duhet të jetë e mbushur me mëshirë, dashuri dhe paqe. Allahu i begatoftë edhe shtëpitë tona me këto të mira. Amin.

KËMISHA PREJ ZJARRI

— Fatma Allada —

Përgjegjësia që njeriu ka marrë mbi supe, domethënë “amaneti” hyjnor, si mëkëmbës i Allahut në tokë, është shumë e rëndë. Kjo përgjegjësi që përfshin të kaluarën, të tashmen dhe të ardhmen e bën njeriun të jetë shumë i ndjeshëm. Kryerja e detyrave në mënyrën e duhur kundrejt vetes, Zotit dhe të gjithë të tjerëve është e lidhur me këtë ndjesi. Njeriu, të cilit i është dhënë amanet çdo gjë që gjendet në qiej dhe në tokë, ka përgjegjësi aq sa ka fuqi dhe mundësi. Kur njeriut i zgjerohet fusha e veprimit, i zgjerohet edhe fusha e përgjegjësisë. Fusha e kësaj përgjegjësie, që zgjatet nga të qenët kryetar i familjes e deri te kryeministria apo presidenca, e obligon njeriun të edukohet, në mënyrë që të arrijë ta mbartë këtë peshë të rëndë. Çështja e parë dhe më e rëndësishmja në lidhje me këtë temë është njohja e fushës së përgjegjësisë. Ata që e kanë këtë vetëdije, përpiqen me mish e me

thua për t'i arrirë aftësitë e nevojshme që do t'u duhen për t'i kryer detyrat e tyre. Nëse ata njerëz që e kanë të gjerë fushën e përgjegjësisë garojnë për ta zgjeruar edhe më shumë atë, në plan të parë nuk bëjnë një punë të mençur. Gjendja e atyre që e mbartin me vështirësi peshën e tyre apo e atyre që nganjëherë edhe nuk mund ta mbartin, por kërkojnë të mbartin edhe peshën e të tjerëve apo luftojnë për pushtet, është shumë e habitshme. Veçanërisht lufta e pamëshirshme që politikanët bëjnë kundër rivalëve të tyre, ka dalë jashtë rregullave njerëzore dhe etike. Edhe lufta i ka disa rregulla të caktuara. Atëherë, përse bëhet kjo luftë e pamëshirshme? Njeriu e kërkon detyrën e rëndësishme apo pushtetin për t'i shërbyer fesë, në mënyrë që të fitojë kënaqësinë e Allahut dhe të robërve të Tij ose për interesat e veta apo të të afërmeve të tij, ose për t'u bërë i famshëm. Nëse nijeti është për të fituar kënaqësinë e Allahut Teala dhe për të marrë lutjet e robërve të Tij, nuk aplikohen rrugë




çnjërëzore apo amorale për atë detyrë, sepse një sjellje e tillë është në kundërshtim me nijetin. Atëherë, na ngelet pas alternativa e interesit dhe e famës. Ata që luftojnë për t'u ngritur dhe për pushtet me këtë njet, nuk mund t'i japin shoqërisë asgjë tjetër përveçse dëmit.

Udhëheqja, veçanërisht udhëheqja e shkallës së lartë është një këmishë prej zjarri. Ajo nuk është një këmishë që mund të vishet për ambicie, pasuri apo famë. I Dërguari i Allahut, salallahu alejhi ve selem, ka thënë në lidhje me këtë çështje: *"Ju do jeni shumë ambiciozë në çështjen e udhëheqjes, por kjo detyrë do të jetë pendim në Ditën e Kiametit (për ata që nuk ia japin hakun)."* Kur Hz. Ebu Dherr el-Gifari i kërkoi një detyrë në udhëheqje të Dërguarit të Allahut (s.a.s.), Hazreti Pejgamberi ia vendosi dorën në sup dhe i tha: *"O Ebu Dherr! Ti je një njeri i dobët, ndërsa ky është një amanet. Në Ditën e Kiametit mund të jetë poshtërim dhe pendim. Kjo nuk përfshin atë që e kryen siç duhet përgjegjësinë e tij."* (Muslim, Ibn Maxhe, 16.)

Ata që arrijnë pozita të caktuara, veçanërisht ata që janë në pozicionin e shefit, kapen nga sëmundja e mburrjes dhe e mendjemadhësisë pa qenë të vetëdijshëm për këtë. Sikur Nemrudi dhe Faraoni të ishin njerëz të thjeshtë, nuk do të tentonin të pohonin se ishin hyjni. Tani, le të flasim rreth një ngjarjeje interesante për psikologjinë e lidërsipit. I Dërguari i Allahut, salallahu alejhi ve selem, e caktoi Mikdad bin Amrin komandant të një njësie të vogël ushtarake për të realizuar një operacion. Kur u kthye, e pyeti: *"O Ebu Ma'bed! Çfarë mendon për udhëheqjen?"* Ai i tha: *"Kur u nisëm për në operacion, nuk mendoja se isha më i lartë se ushtarët që kisha nën urdhra, por në kthim, fillova t'i shikoja ata si robërit e mi."* Pastaj, i

Dërguari i Allahut (s.a.s.), i tha: *"O Ebu Ma'bed! Ja, kështu është udhëheqja. Përveç për ata që Allahu i mbron nga e keqja e pozitës."* Udhëheqja, me të vërtetë është një këmishë prej zjarri, sepse udhëheqja është mbartje e peshës së të gjithë atyre që janë nën urdhra. Kur Hz. Umeri i shkroi një letër valiut të Basrës, Hz. Ebu Musa el-Esh'ariut, i dha këto këshilla: *"Vizitoji të sëmurët! Merr pjesë në ceremonitë mortore! Mbage derën hapur ndaj popullit! Interesohu vetë për nevojat e tyre! Ti thjesht je një prej tyre, vetëm se Allahu Teala të ka dhënë peshën më të rëndë ndër ta. Jam njoftuar se ushqimi e veshmbathja jote dhe e familjes tënde janë të ndryshme nga ajo e popullit dhe se je zhytur në shtirje. Të tërheq vërejtjen që të mos biesh në shkallën e kafshëve! Kur kafshët zhyten në një luginë me bar, nuk mendojnë asgjë përveçse për t'u ngopur. Nëse devijon udhëheqësi, devijojnë edhe të udhëhequrit. Udhëheqësi më i keq është ai njeri që bëhet shkak për devijimin e njerëzve."* Hz. Umeri, i cili i dha këto këshilla valiut, së pari ishte vetë ai që i respektonte më shumë. Abdurrahman bin Auf (r.a.), tregon: *"Një natë më thirri Hz. Umeri dhe më tha: Një karvan po bun në hyrje të Medines dhe kam frikë mos u vidhen mallrat kur t'i zërë gjumi."* Shkova bashkë me të. Kur arritëm, më tha që të flija, ndërsa vetë i bëri rojë karvanit përgjatë gjithë natës. Përsëri, Hz. Umeri e vendosi dorën në plagën e gungës së një deveje dhe tha: *"Kam frikë se do të merrem në llogari edhe për atë që të ka ndodhur ty."* Edhe kjo fjalë e Umerit (r.a.), është shumë e njohur: *"Nëse një ujk ha një dele në buzë të (lumit) Tigër, përgjegjës është Umeri."*



Udhëheqësi duhet të sillet me drejtësi kundrejt atyre që i udhëheq, nuk duhet t'u premtojë gjëra që s'mund t'i realizojë dhe nuk duhet t'i gënjejë. I Dërguari i Allahut (s.a.s.), ka thënë në lidhje me këtë çështje: *"Nëse dikush, të cilin Allahu Teala e ka bërë udhëheqës, vdes duke i mashtruar ata që i udhëheq, Allahu nuk e fut në xhenet."* (Buhari, Ahkam. 8.)

Njerëzit me autoritet dhe pushtetarët nuk duhet t'ua dhurojnë të afërme apo miqve të tyre detyrat e shtetit, por në krye të tyre duhet të sjellin njerëz të specializuar dhe të besueshëm, përndryshe, shkatërrojnë veten, ata që kanë sjellë në detyrë dhe vetë detyrën. I Dërguari i Allahut (s.a.s.), ka thënë: *"Kush sjell në krye të një detyre një të afërm ngaqë e do, edhe pse mund të gjejë dikë më të aftë se ai, nuk do ta ndjejë erën e xhenetit."* (Kenzu'l-Ummal, 6/39.) Udhëheqësi është i obliguar të sillet si një baba i mëshirshëm kundrejt atyre që ka nën udhëheqje. Ata duhet t'i trajtojë si fëmijët e tij. I Dërguari i Allahut, salallahu alejhi ve selem, është sjellë si një baba i drejtë dhe i mëshirshëm kundrejt umetit. Në shtëpinë e nënës sonë, Hz. Aishes ka thënë: *"O Zot! Jepi vështirësi atij që merr përsipër një punë të umetit dhe i vë në vështirësi ata dhe trajtoje me mëshirë atë që merr përsipër një punë të umetit dhe i trajton me mëshirë ata!"* (Muslim, Imare 19.) *"Ai që merr përsipër udhëheqjen e myslimanëve dhe nuk i mbron ata siç mbron veten dhe familjen e tij, nuk do ta ndjejë erën e xhenetit."* (Mexhmau'z-Zevaid 5/211.)

Udhëheqësi duhet të ketë më shumë kujdes ndaj pasurisë së shtetit se sa ndaj pasurisë së vet. Siç nuk duhet të bëjë vetë korrupsion, nuk duhet t'u japë mundësi edhe të tjerëve për këtë.

I Dërguari i Allahut, alejhi's-salatu ve's-selam, ka thënë në lidhje me këtë çështje: *"Nëse dikush që i kemi dhënë një detyrë, fsheh nga ne një gjilpërë apo diçka më të vogël se ajo, ka tradhtuar dhe do ta sjellë atë Ditën e Kiametit."* (Muslim, Imare, 30.)

Si do të shpëtojnë nga mëkatet që kanë bërë, ata të cilët garojnë për kolltuk pa përgjegjshmëri dhe që i kanë bërë popullit padrejtësi të pamagjinueshme për të mos e lënë pushtetin, ndërkohë që udhëheqja është një detyrë kaq e rëndë dhe kërkon kaq shumë përpikëri? Si dhe me ç'fytirë do ta japin llogarinë e popullit ata që ua kanë shkelur të drejtat, i kanë shtypur dhe i kanë skllavëruar njerëzit, ndërkohë që janë të paafhtë të japin edhe llogarinë e tyre? Ata që nuk mendojnë për gjykimin e madh dhe luftojnë për kolltuk, në mënyrë që të arrijnë interesat e kësaj bote provizore, po vrapojnë drejt xhehenimit, ngaqë i kanë verbëruar ambiciet e tyre. Edhe fundi i tyre në këtë botë është shumë mësimdhënës. Përfundimi tragjik i atyre që e humbin pushtetin për shkak të zemërimit të Allahu Teala dhe pastaj, me kryengritjen e popullit që e kanë shtypur, është shumë tmerrues. Historia jonë e afërt është e mbushur me shembuj të tillë. Fundi i atyre që në fillim e shikonin veten si një nga populli, por kur u ulën në kolltuk e shikonin popullin si robër, është më i keq se i robërve. A është mençuri që të poshtërohesh në këtë botë dhe në botën tjetër, ndërkohë që pozitat e kësaj bote mund t'i përdorësh për të fituar Ahiretin e përhershëm, ndërkohë që mund të punosh dhe të ndahesh nga pozita në mënyrë të ndershme duke fituar kënaqësinë e Allahut Teala, duke marrë lutjet e njerëzve dhe duke ua dorëzuar pozitën vullnetarisht atyre që janë të aftë për të? Allahu i Madhëruar na bëftë prej atyre që e llogarisin fitimin dhe dëmin e vërtetë dhe nuk e shkatërrojnë dynjanë e ahiretin e tyre me tiraninë që jep lakmia!



NDRYSHIMET E THELLA NDËRMJET ISLAMIT DHE PERËNDIMIT

— Filiz Konxha —

Në këtë botë ka shumë kultura, filozofi dhe mënyra të ndryshme jetese. Vallë, cila është më e drejtë? Cila është më e bukura? Cila është më e dobishme për njerëzit? Sipas cilës arrihet lumturia? Prej cilës Zoti është i kënaqur?

Këtyre pyetjeve nuk është e lehtë t'u japësh përgjigje. Ato kërkojnë dije të thellë, studime të gjata dhe kërkime serioze.

Në mendje të vjen së pari civilizimi perëndimor me shfaqjen marramendëse dhe suksesin teknik të mrekullueshëm. Ndërkohë, shumë filozofë dhe mendimtarë perëndimorë shprehën se civilizimi perëndimor është i sëmurë mendërisht e shpirtërisht dhe se po e zvarrit njerëzimin në shkatërrim. Kështu që, ata po përpiqen të gjejnë rrugët e shpëtimit.

Me të vërtetë, edhe neve ditë për ditë po na shtohet admirimi ndaj këtij civilizimi të çme-

ndur e depresionues. Parimet njerëzore i përdorin të njëanshme vetëm për interesat e tyre. Të drejtat e të tjerëve nuk i njohin dhe popujt e pambrojtur i shkatërrojnë në mënyrë barbare. Ata kanë arritur kulmin në mendjemadhësi e shtirje dhe kanë marrë një rrugë të shfrenuar në dëshira dhe argëtime. Koncepti i nderit dhe familjes ka rënë nën këmbët e tyre.

Ndërmjet individëve janë shpëputur të gjitha lidhjet e dashurisë e të respektit. Njerëzit janë bërë kurban të alkoolit, drogës e pasionit; kanë devijuar dhe janë bërë hipi.

Mbi të gjitha, nuk e shohin gjendjen e tyre, po mundohen të ngrenë imperializmin kulturor me të gjitha institucionet e tyre fetaro-sociale dhe po përpiqen t'i zvarrisin edhe popujt e tjerë në batakun e tyre. Po ashtu, po mundohen t'i arrijnë synimet e tyre me libra, koleksione,



filma, teatro, institucione arsimore, shkolla private, kurse, bursa, ftesa dhe mësim.

Kemi shkuar te ata, i kemi njohur nga afër, ua kemi parë fytyrën e brendshme dhe ua kemi kuptuar nijetin e fshehtë. Të shkretët, janë shkatërruar nga aspekti shpirtëror. Nëse ne i marrim ata për shembull, nëse mashtrohemi ndaj shfaqjeve ndriçuese dhe, nëse ndjekim kulturat e sëmura të tyre, do të thotë se do të shkatërrohemi.

Tashmë, ne të gjithë si popull duhet ta shikojmë epërsinë dhe përsosmërinë e kulturës sonë, duhet të kapemi fort pas saj, duhet të zhvishemi nga imitimi dhe t'i edukojmë fëmijët tanë si njerëz myslimanë me karakter, me edukatë, me moral të lartë, të dashur, të respektueshëm, të ditur, të urtë, përgjegjës, punëtorë, të frytshëm dhe të singertë. Duhet të jemi shumë të përpiktë dhe të kujdesshëm, në mënyrë që sëmundjet shpirtërore të perëndimit të mos u ngjiten brezave tanë, që të mos shkatërrohen familjet e vatrave tona dhe që populli ynë të mos gjuhëzohet materialisht e shpirtërisht.

Në këtë material kemi zgjedhur një/dy hadithe fisnike të Pejgamberit, salallahu alejhi ve selem, nga shumë prej tyre, me shpresë që të ketë sa më shumë begati dhe në mënyrë që të gjithë të shikojnë shembuj nga mirësitë e pafundme të Islamit dhe epërsitë e pakrahueshme të tij. Pastaj ta bëjmë sa më të qartë ndryshimin ndërmjet kulturës Islame dhe asaj perëndimore, duke krahasuar nënat myslimane me gratë e papërgjegjshme në perëndim, të cilat preferojnë më shumë të mbajnë një

qen sesa të edukojnë një fëmijë.

1. Taberani transmeton nga Abdullah b. Umer se Pejgamberi, salallahu alejhi ve selem, ka thënë:

“Gruaja në shtatzani, në kohën derisa të lindë dhe derisa ta ndajë fëmijën nga gjiri, është si luftëtari që ruan kufijtë në rrugë të Allahut (vazhdimisht merr sevap si ai). Nëse vdes në këtë kohë, asaj i jepet shpërblimi i dëshmorit.”

2. Transmetohet nga Abdurrahman b. Auf (r.a.), se i Dërguari i Allahut, salallahu alejhi ve selem, ka thënë:

“Kur gruaja të ngelë shtatzënë, fiton shpirtërisht shpërblimin e një luftëtari, që ditën agjëron, natën fal namaz dhe i është dorëzuar Zotit me gjithë zemër.

Kur ta kapin dhimbjet e lindjes, asnjë krijesë nuk mund ta kuptojë plotësisht se sa shumë shpërblim merr ajo.

Kur të lindë fëmija, ajo merr sevap sikur ngjall një jetë, sa herë foshnja ta thithë gjirin apo sa herë t'i japë gjë atij.

Kur fëmija të rritet dhe t'i ndërpritet gjiri, atëherë dy engjëj e prekin te shpatullat dhe i thonë:

“ (Tashmë nuk të ka ngelur asnjë mëkat.) Filloje jetën përsëri duke mos pasur asnjë gjynah...”

Shënimet:

Trasmeton: Nuajm, Hiljetu'l-evlija, IV, 298; Hejsemi, Mexhma'u'z-zevaid, IV, 560.



KUJDESI NDAJ TRI GJËRAVE

— Naim Drijaj —

Transmetohet nga Abdullah ibn Amri (r.a), se një ditë Pejgamberi (a.s) kaloi pranë Sa'dit i cili po merrte abdes dhe vuri re se Sa'di po përdorte shumë ujë për të marrë abdest dhe i tha: “Çfarë është ky harxhim i tepërt o Sa'd?!” Sa'di e pyeti: “A ka harxhim të tepërt edhe në abdest?” I Dërguari i Allahut (a.s) i dha përgjigje me këto fjalë që do të na ndriçojnë deri në Ditën e Kiametit: “Po, ky është harxhim i tepërt edhe sikur të jesh duke marrë abdest në buzë të një lumi që rrjedh”.



Një njeri ka ardhur tek Junus ibn Ubejd (Allahu qoftë i kënaqur prej tij)¹ dhe ka kërkuar nga ai që ta këshillojë atë. Ai e ka këshilluar atë me tri porosi:

KUJDESI I RAPORTEVE ME NJERËZIT

Të jesh i dashur me njerëzit, kjo është gjysma e mençurisë.

Nuk është e mundur që njeriu të jetë i dashur për të gjithë. Nuk ka njeri në botë që të gjithë e kanë dashur. Muhamedi (a.s) ka qenë njeriu më i mirë por përsëri ka pasur armiq.

Jahja ibn Meini (Allahu e mëshiroftë) i këshilloi vëllezërit e tij duke u thënë: “Kujdesuni që vëllai mysliman t’i garantojë prej jush këto tri gjëra:

“Nëse nuk mund t’i bëni mirë mos e dëmtoni,

Nëse nuk mund ta gëzoni mos e hidhëroni,

Nëse nuk mund ta lavdëroni mos e kritikoni dhe mos e nënçmoni.”

Arti i ndërveprimit me njerëzit është përmbledhur në tre fjalitë e një ajeti kuranor:

“Trego mëshirë, urdhëro vepra të mira dhe shmangu nga të paditurit!”²

KUJDESI NDAJ KURSIMIT NË SHPENZIME

Mos u bëj shpërdorues sepse kursimi në shpenzime është një e treta e fitimit.

Kursimi është begati. Allahu (xh.sh) thotë: “Hani frutat e tyre kurdo që të prodhojnë dhe jepni atë që është detyrë në ditën e vjeljes së tyre! Por mos e teproni, se Allahu nuk i do ata që e teprojnë!”³

“Hani frutat e tyre”, lidhet ngushtë me konsumin vetjak.

“...ditën e vjeljes së frutave jepeni pjesën që është obligim...” lidhet me atë që u jepet të tjerëve.

“...mos shpërdoroni...” lidhet ngushtë me kursimin për të ardhmen.

Konsumi i kontrolluar, dhënia e caktuar dhe kursimi për të ardhmen është trekëndëshi që mundëson ekuilibër ekonomik për individin dhe për shoqërinë.

Pejgamberi (a.s) ka thënë: “Hani, pini, jepni lëmshë dhe vishuni pa rënë në mendjemadhësi

1. Junus ibn Ubejd Ebû Abdillâh Júnus b. Ubejd b. Dînâr el-Abdî el-Basrî (v. 139/756). *Dijetarë i hadithit nga tabi'inët*. Në terminologjinë islame “tabi'in” quhet: “Muslimani, i cili ka takuar dhe shoqëruar për një kohë sahabët”. Pra ky është brezi i edukuar nga sahabët.

2. El-Araf, 199.

3. El-En'am, 141.

dhe harxhim të tepërt!”⁴

Transmetohet nga Abdullah ibn Amri (r.a), se një ditë Pejgamberi (a.s) kaloi pranë Sa'dit i cili po merrte abdes dhe vuri re se Sa'di po përdorte shumë ujë për të marrë abdest dhe i tha: “Çfarë është ky harxhim i tepërt o Sa'd?!” Sa'di e pyeti: “A ka harxhim të tepërt edhe në abdest?” I Dërguari i Allahut (a.s) i dha përgjigje me këto fjalë që do të na ndriçojnë deri në Ditën e Kiametit: “Po, ky është harxhim i tepërt edhe sikur të jesh duke marrë abdest në buzë të një lumi që rrjedh”.⁵

Të parët tanë kanë thënë: “Miku i njeriut është kursimi, ndërsa armiku i tij është harxhimi i tepërt”.

KUJDESU QË KUR TË PYESËSH TË BËSH PYETJEN E DUHUR SEPSE KJO ËSHTË GJYSMA E DITURISË.

Aliu (r.a) një ditë u tha njerëzve: Pyetni çfarë të doni. Ibul-Keva tha: Çfarë është pjesa e zezë e hënës? Tha: Allahu të vraftë, pse nuk pyet për gjëra që të bëjnë dobi në fe? Në një transmetim tjetër thuhet: me trego se çfarë domethënë: “bartëset e shiut të rëndë (retë)”? Mos të pastë nëna, pyet për të mësuar fenë e jo për fantazi, pyet për gjëra që të interesojnë dhe jo për ato që nuk të interesojnë”.⁶

Dijetarët dhe njerëzit e mençur e kishin traditë që mos t'u jepnin përgjigje atyre që pyesnin për gjëra që nuk kishin dobi e as dëm prej tyre, madje edhe i qortonin ato.⁷

E kanë pyetur njërin nga dijetarët e islamit:

- Si quhej gruaja e Iblisit? Ai është përgjigjur:

- Nuk kam qenë në atë dasmë.

I Dërguari i Allahut (a.s) ka thënë: “...Allahu i madhëruar urren prej jush tri gjëra; thashethemet, pyetjet e tepërta dhe shpërdorimin e pasurisë.”⁸

Sejjar Ebul-Hakemi ka thënë: “E kanë pyetur Llukmanin e urtë se si e kishte arritur gjithë atë urtësi që kishte?” Ai është përgjigjur: “Duke mos pyetur rreth çështjeve që kam njohuri të mjaftueshme dhe duke mos u përfshirë në ato tema që nuk më interesojnë”⁹

4. Nesaiu, 2559, Ibn Maxheh, 3605, Ahmedi, 6656. El-Mishkah, 4381.

5. Ahmedi, 6768. Es-Sahihah, 3292.

6. Shiko: “el-Ibane”, 1/418.

7. Shiko: “el-Ibane”, 1/418.

8. Buhariu, 5975. Muslimi, 593.

9. ibn Ebi Shejbe, Musannef, 13/214-215.

NJERIU

DUHET TË DIJË SE ÇFARË HA

— Xhafer Bekirollu —

Spinaqi: është i ftohtë dhe i lagësht në shkallë të parë. Ushqimi me të është i shijshëm. Ai u bën dobi mushkërive të bardha dhe mëlçisë së zezë. E zbut barkun dhe lufton sëmundjet e shpinës.

Nga Marifetnameja kuptojmë se natyra e një njeriu është e thatë ose e lagësht, e ngrohtë ose e ftohtë. Ushqimet që merr, ia shtojnë thatësinë dhe ftohtësinë ose ngrohtësinë dhe lagështinë. Nisur nga kjo, çdo njeri i vetëdijshëm duhet ta njohë strukturën e tij, duhet t'i dijë veçoritë e rëndësishme të ushqimeve mjekësore që merr dhe të gjitha këto duhet t'i konsumojë duke pasur kujdes për kohën e tyre.

Qepa: është tharëse në shkallën e dytë dhe ngrohëse në shkallën e tretë. Në të njëjtën kohë, është dekompozuese dhe zbutëse. Hap hyrjen e damarëve. Nëse i shtypet fara dhe me vajin e saj lyhet lëkura e sëmurë me lebrozë, e shëron atë. E shkul me kripë lurdhësin. Nëse hahet në mënyrë normale, forcon stomakun dhe hap oreksin. Qepa e zier është e dobishme. Liron rrugët e urinës, zbut natyrën e njeriut dhe lufton erërat helmuese. Nëse lidhet plaga me të, ndalon dhimbjet dhe rrjedhjet.



Veza e pulës: gjysmë e skuqur në vaj, është më e mira. Nëse veza zihet shumë, nuk ka asnjë lloj dobie. Por e verdha e saj ka shumë dobi për nxehtësinë dhe e bardha për të ftohtët. Nëse e lyejmë fytyrën me të bardhën e vezës, e mbron atë kundrejt rrezeve dhe nxehtësisë së diellit. Nëse e përziejmë të verdhën e saj me mjaltë dhe lyejmë me të dëmtimet dhe qukat e fytyrës, i shëron. Veza ka fuqinë e mishit dhe pjesa më e dobishme është e verdha e saj.

Arra: është tharëse në shkallë të parë dhe ngrohëse në shkallë të dytë. Shkakton dhimbje koke. Tretet me vështirësi dhe jep shumë ngrohtësi. Vaji i saj është ndriçues, dekompozues dhe dobësues. Ajo është e dobishme për skuqjet, qukat dhe dridhjet e fytyrës. Është e dobishme për dhimbjet e kokës dhe të kraharorit. Largon rrufën dhe kollën e thatë, që kanë lidhje me të ftohtët. E forcon stomakun dhe qetëson zemrën. Hap bllokimet e mëlçisë së zezë. Është e dobishme për dhimbjet e veshkave dhe të mitrës. I vjen mirë errësimi të syrit dhe kataraktit.

Fiku: i freskët është pak i lagësht dhe i ngrohtë. Ka shumë lëng dhe ushqim. Tretet menjëherë në stomak. Është më i ushqyeshëm se të gjithë frutat e tjerë. Pjesa e tij ndërmjet bërthamës dhe lëkurës i pjek dhe i zbut plagët dhe ulçerën. E ul temperaturën dhe e rregullon ngjyrën që prishet prej sëmundjes. I pjek çibanët dhe u nxjerr qelbin. E heq kollën e vjetër. Është i dobishëm për mushkëritë e bardha dhe kraharorin. Hap bllokimet e mëlçisë së zezë, shpretkën, veshkat dhe fshikëzën e urinës. Është shumë i dobishëm kur hahet me bajame ose me arra. Nuk është mirë që fiku të hahet me ushqime të rënda. Ai që ha tre kokrra fiq para ushqimit, të zier në ujë me uthull, për tre ditë në mëngjes, shpëton nga ethet dhe tëmthi.



Nga këto që thamë më lart, mund të mendojmë se Ibrahim Hakiu këshillon që njeriu duhet të jetë doktori i vetvetes, sepse ai e këshillon lexuesin e tij që së pari të njohë strukturën e trupit të tij, pastaj veçoritë e ushqimeve që i ka marrë si ilaç apo ushqim dhe mënyrën e duhur për përdorim. Ai tregon se duhet të respektohen parimet kryesore të mjekësisë mbrojtëse. Në fund, thotë: “Të gjitha ilaçet dhe ushqimet ndikojnë me lejen e Allahut të Madhëruar. Faktikisht, Musebbibu’l-Esbab është Ai që u jep gjërave forcën e ndikimit. Ai u jep dobi apo u shkakton dëm gjërave.”





Ju ofron:
Kushte bashkëkohore,
ushqim cilësor dhe të kontrolluar,
staf të kualifikuar.

Ju mirëpresim!



Logja Perash, Bulevardi Mehmet Pashë Plaku,
Pranë Xhamisë Perash, Shkodër
+355 67 47 39389

1 Staf arsimor cilësor

2 Kushte arsimore sipas standarteve të larta

3 Aktivitete sociale, kulturore dhe sportive

4 Klasa dhe laboratorë të kompletuar


5 Ambiente familjare në konvikt dhe cilësi në ushqim



CIKLI FILLOR

(djem dhe vajza)

NGA KLASA E 1-RË
DERI NË KLASËN E 5-TË



“Urdhëroji njerëzit e tu
të falin namazin
dhe ji i vazhdueshëm
edhe vetë në të.
Ne nuk kërkojmë
furnizim prej teje,
Ne jemi ata
që të furnizojmë ty.”

(TaHa, 132)

